



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit me Karakter Profesional**

**“Database dhe Web Design”**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Profesional i  
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Ariana Bejleri

2. Prof. Asoc. Valma Prifti

Korrik 2023

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për programin e studimit me karakter profesional në “Database dhe Web Design”  
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Profesional i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Teknologjisë Informacionit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Programi i studimit me karakter profesional në “Database dhe Web Design”
4	Urdhëri/ VKM i licencimit:	Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 699, datë 26.08.2015
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 426, datë 17.12.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendimin e Bordit të Akreditimit (VBA) Nr. 13 datë 30.03.2018
8	Cikli i studimit:	Program profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit:	
18	Numri i studentëve: (2018- 2022)	69 studentë
19	Komente/ të tjera:	

## PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Përshkrim përmbledhës;

Programi i studimit me karakter profesional "Database dhe Web Design" është program i Kolegjit Profesional të Tiranës (KPT). KPT është kolegji profesional i lartë që ofron veprimtari mësimore dhe trajmuese në fusha të ndryshme të arsimit profesional dhe përgatit profesionistë me aftësi praktike.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave numër 699, datë 26/08/2015, programi është hapur dhe licensuar, në një institucion të arsimit të lartë, privat, me statusin kolegji profesional.

Ky program ofrohet nga Departamenti i Teknologjisë Informacionit, si njësi bazë.

Programi realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet: "Diplomë Profesionale" në "Database dhe Web Design".

Akreditimi i parë i programit të studimit DBWD është bërë në vitin 2018 me *Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 13 datë 30/03/2018*.

Ky program, DBWD, ka një staf akademik cilësor, me kombinim të pjesës akademike, asaj të aplikuar dhe sipërmarrëse.

Programi kombinon teorinë dhe praktikën, dhe synon nxitjen e studentëve për përvetësimin dhe aplikimin e dijeve bashkëkohore dhe inovacionit.

Programi përgatit profesionistë në zbatimin e metodologjive në fushën e bazës së të dhënave, trajtime imazhi dhe dizajn web-i; profesionistë në zbatime të teknologjisë së lartë e me një tematikë të gjerë, nga faqet e internetit, krijimi i programeve për biznese dhe individë, puna në studiot e imazhit dhe marketingut, etj.

Programi përgatit studentët me njohuri teorike dhe praktike, të aftë për të dizenuar, krijuar, ndërtuar, programuar dhe mirëmbajtur faqe interneti, baza të dhënash dhe aplikacione të mbështetura në to.

Programi DBWD pajis studentin me aftësitë për t'u specializuar brenda një kohe të shkurtër dhe u krijon mundësinë të integrohen në tregun e punës.

Aktualisht ky program ka të regjistruar: 19 studentë në vitin e parë, 14 studentë në vitin e dytë.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

### **Përshkrim përmbledhës;**

Për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ), nga ASCAL është ngritur Grupi i Vlerësimit të Jashtëm me qëllim akreditimin e Programi i studimit me karakter profesional “Database dhe Web Design”. Anëtarët e GVJ janë zgjedhur në bazë të kompetencave të tyre profesionale, paanshmërisë, mundësisë për të aksesuar, mbledhur dhe përpunuar informacionin e nevojshëm për kryerjen e vlerësimit duke marrë në konsideratë mendimet e tyre.

GVJ përbëhet nga 2 anëtarë dhe është themeluar për qëllim të raportit të vlerësimit të jashtëm të programi i studimit me karakter profesional “Database dhe Web Design”.

Procesi i vlerësimit të jashtëm të cilësisë për Programin e studimit me karakter profesional “Database dhe Web Design” është realizuar nga GVJ në bashkëpunim me ASCAL.

Gjithashtu gjatë procesit është përfshirë edhe një vizitë në institucion.

Aktivitetet e kryera në kuadër të hartimit të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të Programit të studimit me karakter profesional “Database dhe Web Design” nga GVJ janë zhvilluar në bazë të afateve kohore të përcaktuara më parë.

Gjatë kryerjes së procesit, GVJ është udhëhequr nga ruajtja e etikës profesionale dhe zbatimi i kuadrit ligjor mbi aksesin në të dhënat personale dhe konfidencialitetin e tyre.

Procedura e vlerësimit të jashtëm, është parë si një proces dinamik vlerësimi dhe diskutimi për të paraqitur realitetin dhe njëkohësisht të evidentohen dhe adresohen për zgjidhje problematikat e mundshme.

Në hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të Programit të studimit me karakter profesional “Database dhe Web Design” është synuar të jepet një tablo e qartë gjithëpërfshirëse për programin e studimit, duke evidentuar njëkohësisht cilat janë pikat e forta të këtij programi studimi dhe ato që duhen përmirësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtij raporti, GVJ u mbështet në të gjitha dokumentat e nevojshme të prodhuara nga Institucioni në dosjen e vetëvlerësimit të zhvilluar nga Kolegjit Profesional i Tiranës (KPT), në kuadrin e akreditimit të Programi i studimit me karakter profesional “Database dhe Web Design”.

Gjithashtu GVJ u bazua në kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe në dokumenta të veçanta si “Manuali i vlerësimit institucional të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri”, i përgatitur nga ASCAL.

GVJ e ka organizuar punën e tij duke ndarë detyrat për të mundësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse njohjen dhe evidentimin e dokumentave dhe realizimin e raportit.

Më datë 27/06/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 86/26 Prot., datë 29/06/2023, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

KPT kthehu përgjigje me shkresë zyrtare Nr. 65/ 2 Prot., datë 03/07/2023.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.13, datë 30.03.2018 janë:

1. Të shtohet dhe pasurohet në mënyrë të vazhdueshme numri i titujve në fondin e bibliotekës në funksion të realizimit të programeve të studimit.
2. Të shtohet numri i projekteve të përbashkëta ndërkombetare në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave të pedagogëve në mësimdhënie dhe të shkëmbimit të studentëve.
3. Të rritet numri i bashkëpunimeve me institucione, kompani dhe biznese që operojnë në fushën e programit të studimit, për kryerjen e praktikave të studentëve në vitet vijuese.
4. Institucioni të pasurojë laboratorët në funksion të këtij programi me teknologji të reja në përputhje me objektivat formuese të këtij programi.

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Nga vizita në IAL dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion për këtë proces vlerësimi vëmë re se rekomandimi parë është përmbushur plotësisht. KPT ka pasuruar bibliotekën me mbi 80 tituj të rinj. Vëmë re që pjesë e materialeve të bibliotekës janë edhe ciklet e leksioneve, manualët e laboratoreve, në shqip dhe anglisht. KPT ka bërë të mundur aksesin e stafit në librari online me një gamë të gjerë tituj librash.
2. Për plotësimin e rekomandimit të dytë, KPT është pjesë e pesë projekteve si: ne programin Erasmus + për zhvillimin e modulit Jean Monet; Inxhinierizimi i modernizimit të kurrikulës së energjisë së rinovueshme; Ndërlidhësit mes universitetit dhe shoqërisë; MoVET- Mobility in Europe for VET- i përzgjedhur si projekt nga komisioni Europian; Connected through mobility;
3. Vëmë re se KPT ka zgjeruar numrin e bashkëpunetoreve, dhe ka realizuar marrëveshje me më shumë se 100 subjekte.
4. Lidhur me pikën e 4 të rekomandimeve, vëmë re që në KPT laboratorët janë të mirëpajisur me programe të licensuar dhe shoqëruar me manualin e përdorimit. Fale Projekteve Erasmus + CBHE, KPT ka siguruar financime për blerjen e pajisjeve për laboratorët e rinj.

## Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Database dhe Web Design”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes, bazuar te RVB dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që KPT e ushtron aktivitetin bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë. KPT është kolegji profesional i lartë që ofron veprimtari mësimore dhe trajnuese në fusha të ndryshme të arsimit profesional dhe përgatit profesionistë me aftësi praktike. Vizioni i KPT është të jetë lider në ofrimin e arsimit profesional, duke dhënë kontributin e tij për zhvillimin e vendit, duke krijuar profesionistë të aftë në shërbim të shoqërisë dhe ekonomisë sonë duke realizuar veprimtari akademike dhe kërkimore të zbatuara, të integruara për atë që sa nevojitet për nevojat e realizimit sa më cilësor të programeve të studimit me natyrë profesionale.</p> <p>Misioni i KPT është të jetë një ndër ofruesit më të rëndësishëm të arsimit profesional në vend, i cili do të jetë një urë lidhëse midis edukimit akademik dhe trajnimit profesional, duke i ndihmuar studentët në integrimin sa më lehtë në tregun e punës;</p> <p>Programi i studimit Diplomë Profesionale në “Database dhe Web Design” është ndërtuar duke mbajtur parasysh synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar dhe duke ndjekur qasjen drejt teknologjisë dhe inovacionit.</p> <p>(Evidence 3 Statuti, neni 31, neni 6 ; Evidence 3 Statuti KPT, neni 6. ; Evidenca 7 Strategjia 2021 -2025; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Bazuar tek RVB dhe nga pyetjet gjatë vizitës në institucion vumë re që departamenti harton programet e studimit duke pasur si bazë strategjinë e KPT, po ashtu edhe statutin e tij. Për t’u hartuar programi kombinohen lëndë me karakter teorik dhe praktik. Vëmë re që programi i studimit me karakter profesional “Database dhe Web Design” është në linjë me vizionin, misionin e institucionit ashtu siç paraqitet në statutin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Ky program ka në fokus krijimin, zhvillimin, transmetimin e dijeve dhe pajisjen e studentëve me aftësi dhe kompetencat e nevojshme për t’u bërë profesionistë në fushën e Database dhe Web Design. KPT ofron programe të licensuara të studimeve jouniversitare, të larta, me karakter profesional, me jo më pak se 120 kredite. Programi i studimit me karakter profesional “DBWD” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit si dhe me fushën e veprimtarisë akademike dhe profesionale. I hapur që me</p>

	<p>themelimin e KPT, ai plotëson portofolin akademik të KPT në drejtime innovative që kërkohen nga tregu i punës. Programi i studimit gjithashtu është ndërtuar në përputhje me qëllimin dhe misionin e KPT-së të cilat janë detajuar në Strategjinë e Zhvillimit 2021 – 2025. Ai është konceptuar si një urë lidhëse midis edukimit akademik, trajnimit profesional, dhe lehtëson integrimin në tregun e punës. Përmes programit të formimit të vazhduar, studentët aftësohen dhe marrin një bazë të njohurish për të mundësuar transferimin e studimeve në nivele më të larta profesionale. Programi i studimit dhe planet mësimore janë të përshtatura me nevojat e tregut të punës.</p> <p>(Evidenca 7 Strategjia 2015 - 2020; Evidence 5 Rregullorja e programit të studimit; Evidence 3 Statuti KPT, neni 31, 32; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.</p>	<p>GVJ duke u bazuar tek RVB dhe nga pyetjet gjatë vizitës në institucion vumë re që KPT është koleji profesional i lartë që ofron veprimtari mësimore dhe trajmuese në fusha të ndryshme të arsimit profesional dhe përgatit profesionistë me aftësi praktike dhe në kuadër të zbatimit të autonomisë akademike zgjedh lirisht programet e studimit që ofron, përkundrejt plotësimit të standardeve dhe kërkesave ligjore si dhe miraton plane, programe dhe tekste mësimore. Procesi i hapjes, rishikimit dhe mbylljes së programit të studimit janë përcaktuar në Statutin e KPT. Programi i studimit mund të propozohet, hartohet dhe rishikohet me kërkesë të Departamentit dhe/ose Zyrës së Kurrikulave, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme të tij. Propozimi për hapjen e një programi studimi në cdo rast vjen i argumentuar. Vizioni i KPT është të jetë lider në ofrimin e arsimit profesional, duke dhënë kontributin e tij për zhvillimin e vendit, duke krijuar profesionistë të aftë në shërbim të shoqërisë dhe ekonomisë sonë duke realizuar veprimtari akademike dhe kërkimore të zbatuara, të integruara për atë që nevojitet për nevojat e realizimit sa më cilësor të programeve të studimit me natyrë profesionale.</p> <p>Misioni i KPT është të jetë një ndër ofruesit më të rëndësishëm të arsimit profesional në vend, i cili do të jetë një urë lidhëse midis edukimit akademik dhe trajnimit profesional, duke i ndihmuar studentët në integrimin sa më lehtë në tregun e punës; Programi i studimit Diplomë Profesionale në “Database dhe Web Design” është ndërtuar duke mbajtur parasysh synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar dhe duke ndjekur qasjen drejt teknologjisë dhe inovacionit.</p> <p>Synimi i programit është të pajisë studentët me</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohuri të thella tekniko - praktike të nivelit profesional, që kërkohen nga fusha të ndryshme të aplikimeve të programimit për teknik të lartë.</li> <li>- aftësi për zgjidhjen e problemeve të programimit në fusha të ndryshme dhe për t’u përshtatur me lehtësi me evolucionin e vazhdueshëm të teknologjisë.</li> <li>- aftësi për të kuptuar dhe analizuar funksionimin e sistemeve relativisht komplekse, për të administruar faqe interneti, data base, përpunim imazhi, etj.</li> </ul>

	<p>- aftësi për t'u specializuar edhe në mënyrë autonome, mbi bazën e kërkesave të tregut të punës. (Evidenca 3: Statuti, neni 5, neni 6, neni 8, neni 31, 32 ; Evidence 7.1: Strategjia 2015-2020; Evidenca 7: Strategjia 2021-2025; Evidence 4: Rregullorja e KPT; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>GVJ duke u bazuar tek RVB dhe nga pyetjet gjatë vizitës në institucion konstatoi që Programi i studimit mund te propozohet, hartohet dhe rishikohet me kërkesë të Departamentit dhe/ose Zyrës së Kurrikulave, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme të tij. Propozimi për hapjen e një program studimi në cdo rast vjen i argumentuar. Për organizimin e programeve të studimit dhe planeve mësimore, KPT-ja konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve dhe të profesioneve përkatëse, për t'u përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Programi është hapur në vitin 2015. Hapja e Kolegjit Profesional të Tiranës dhe programeve ka qënë bazuar në nevojat e tregut të punës për profesioniste e teknike të lartë në fusha të ndryshme të industrisë dhe shërbimit. Identifikimi dhe skicimi i nevojave të tregut të punës ishte nxitësi i parë për përzgjedhjen e programeve të studimit. Strategjia e kërkimit të tregut të KPT u ndërtua mbi parimin që të investohen në ato programe të cilat mund të ofrohen në cilësinë e duhur. Per te siguruar zhvillimin e metejshem te programit te studimit, ne perputhje me njohurite ne fushen e studimit, kerkesat e tregut te punes, planin strategjik te KPT, Departamenti ka hartuar Planin strategjik per zhvillimin e programit. (PSZHP). Strategjinë e Zhvillimit 2015 – 2020, janë analizat dhe argumentet që mbështesin hapjen e programit, bazuar mbi nevojat e tregut të punës. Zhvillimi i një vizioni strategjik i KPT është parë në një kontekst me mjedisin në të cilin operohet ku arsimi profesional është zgjidhje e mirë për të hyrë në tregun e punës përmes kompetencave profesionale të përvetësuar. Plani mësimor i Programit të studimit, rishikohet në mënyrë periodike, në përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës. Organizimi i panairit të punës në ambientet e KPT, me pjesëmarrjen e shumë kompanive, institucioneve dhe organizatave mundëson krijimin e lidhjeve, bashkëpunimeve, punësim dhe internship. (Evidenca 3: Statuti, neni 31, 32; Evidence 7.1: Strategjia 2015 – 2020; Evidenca 7: Strategjia 2021-2025; Evidenca 4: Rregullorja e Kolegjit Profesional të Tiranës neni 14; Evidenca 5: Rregullorja mësimore e programit të studimit në nenin 13; Evidence 5.6 Strategjia e zhvillimit të programit; Evidence 18/1: Panairi i punës; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ duke u bazuar tek RVB dhe nga pyetjet gjatë vizitës në institucion konstatoi që Programi i studimit të DBWD ofrohet nga njësi bazë, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, që në themelimin e KPT në vitin 2015. Departamenti ka në përbërje të tij personel akademik me tituj dhe grada. Për vitin akademik 2022-2023 ka në përbërje si Personel Akademik Efektiv 9 anëtarë (2 Prof. Dr, 1 MND, 6 MSc). Departamenti</p>



	<p>per vitin akademik 2021-2022 ka pasur në përbërje si Personel Akademik Efektiv 9 anëtarë (2 Prof. Dr, 1 MND, 6 MSc). Departamenti per vitin akademik 2020-2021 ka pasur në përbërje si Personel Akademik Efektiv 11 anëtarë (2 Prof. Dr, 1 MND, 8 MSc). Për këtë program studimi angazhohet edhe Personel Akademik me kohë të pjesshme. GVJ vuri re që stafi akademik i brendshëm ka përvojë, përgatitje, cilësi, kualifikim dhe departamenti ka kapacitetet e duhura në ofrimin e këtij programi. Gjithashtu vumë re që departamenti ka 9 Laboratorë me natyrë ndërdisiplinore që i shërbejnë programeve që ai ofron.</p> <p>(Evidenca 6.1: Tabela e stafit në vite; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ duke u bazuar tek RVB dhe nga pyetjet gjatë vizitës në institucion konstatoi që Programi i studimit të DBËD ofrohet nga njësia bazë, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, që në themelimin e KPT në vitin 2015. Vumë re përputhje e plotë midis fushës së përgjithshme si Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe atë specifike të Programit të studimit të DBWD qe ka si Objektiv përgatitjen e specialisteve ne zbatimin e metodologjive ne fushen e Database, trajtime imazhi dhe Web Design. Kjo përputhshmëri evidentohet në të gjithë programet e ofruara nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit. Në lidhje me kodifikimin sjellim në vëmendje që në përputhje me Udhëzimin e MAS, Nr. 31 datë 15.11.2022 “Për proceduarat e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë”, KPT ka përcjellë rregullisht pranë MAS propozimin për kodifikimin e programeve.</p> <p>(Evidenca 5: Rregullorja mësimore e programit të studimit; Evidenca 8: Shkresa MAS për kodifikimin e programeve; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit DBËD është në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë (Departamenti i Teknologjisë së Informacionit), dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

### Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe</p>	<p>GVJ duke u bazuar tek RVB dhe nga pyetjet gjatë vizitës në institucion konstatoi që ndarja e detyrave dhe përgjegjësi në hartimin,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 9

<p>mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit është e përcaktuar në Statutin e KPT, në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të institucionit, të cilat rregullojnë veprimtarinë e tij. Statuti jep njësitë përbërëse në KPT. Njësitë bazë dhe ato ndihmëse krijohen pas miratimit të tyre në senatin akademik. Njësitë kanë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit mbulon peshën kryesore në lidhje me programin e studimit. Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të trajnimit dhe përfshin fusha të përafërta dhe grupon disiplina mësimore trajnuese të përafërta. Ai nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon, dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, trajnimit, dhe kërkimit të zbatuar në përputhje me dhe për aq sa nevojitet për nevojat e realizimit të programit të studimit me natyrë profesionale. Gjithashtu në aktet rregullatorë janë të përcaktuara qartë roli i përgjegjësit të njësisë bazë, këshilluesit të karrierës dhe funksione të tjera departamentale. Gjithashtu në institucion ka njësi ndihmëse mësimore dhe administrative. Njësi ndihmëse janë laboratorët, biblioteka dhe libraria, të gjitha këto njësi shërbejnë për të realizuar studime praktike dhe shërbime në kuader të zhvillimit të procesit akademik dhe të mësimdhënies. Njësitë administrative të institucionit janë Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, Zyra e Financës, Sekretaria Mësimore, Zyra e Protokollit dhe arkivës, Zyra e IT dhe Projekteve, Zyra e Karrierës Mbështetjes dhe informimit të studentëve dhe Zyra e Kurrikulave. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një strukturë autonome e përhershme në strukturën organizative të institucionit. Njësia vlerëson periodikisht rezultatet dhe efikasitetin e veprimtarive mesimore, e veprimtarive formuese e trajnuese si dhe veprimtarive administrative e financiare të institucionit dhe propozon ndryshime për përmirësimet e nevojshme. Ne fund te cdo semestri ose para sezonit te provimeve, organizohet pyetesori I studenteve per cilesine e mesimdhënies të lendeve të programit të studimit. Zhvillohet monitorim i proceseve akademike lidhur me programin e studimit përmes mbledhjeve të Asamblesë së Personelit Akademik, Senatit Akademik, Rektoratit, Departamentit, dhe grupeve të punës. (Evidenca 9: Mbledhje Rektorati/Departamenti/Asamble; Evidenca 3: Statuti, kreu II, kreu III, kreu IV; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ duke u bazuar tek RVB dhe nga pyetjet gjatë vizitës në institucion konstatoi që KPT bashkëpunon me biznese, industrinë, institucione shtetërore, ente të pavarura. Institucioni bashkëpunon me IAL-të në Shqipëri me synim ndërtimin e projekteve dhe aktivitetete në fushat akademike me interes të përbashkët për shkëmbim stafi akademik, administrativ, shkëmbim studentësh, shkëmbim të materialeve akademike etj. Strategjia 2015- 2020 përcaktonte si Prioritete Strategjike: Marrëdhëniet ndërkombëtare, krijimin e raporteve të ngushta bashkëpunuese me institucionet e ngjashme në rajon dhe më gjerë, dhe bashkëpunimi me bizneset dhe angazhimin e punëdhënësit. KPT është pjesë e Konferencës së Rektorëve si dhe merr pjesë në</p>

	<p>forumet e ndryshme të IAL-ve. KPT ka marrëveshje bashkëpunimi me 4 IAL vendase në Shqipëri të cilat janë: Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Universiteti European i Tiranës dhe Instituti Kanadez i Teknologjisë. KPT ka bashkëpunime në nivel rajonal në Europë, ka lidhur memorandum me Universitetin e Thesalisë, Greqi, bashkëpunim i cili ka për object shkëmbimin dhe zhvillimin profesional të stafit akademik, administrativ, shkëmbim studentësh, bashkëpunim në kërkim, botime etj. Gjithashtu vumë re që ka marrëdhënie bashkëpunimi të vendosura me aktorë dhe institucione vendase për realizimin e praktikave profesionale, krijimin e lidhjeve midis IAL dhe aktorëve të tregut të punës në funksion të punësimit të studentëve. Gjithashtu bashkëpunimi ndihmon për të qenë pranë nevojave të tregut të punës. Keto mund të reflektohen në programin e studimit. Keto marrëveshje realizohen nga Departamenti në bashkëpunimin e Zyrën e Informacionit, Mbështetjes dhe Karrierës. Për këtë program studimi vumë re që ka rreth 30 Marrëveshje.</p> <p>KPT organizon panairin e punës me pjesëmarrjen e shumë kompanive, institucioneve dhe organizatave më të mëdha që operojnë në tregun shqiptar në fusha të ndryshme. Kjo krijon mundësi të reja për bashkëpunim, punësim të studentëve dhe internshipe. Psh. përmendim bashkëpunimin me “Praktika.al”, ëbsite i madh i ofrimit të mundësive të internshipeve dhe praktikave profesionale për studentët dhe të sapodiplomuarit. Këtu ndërmjetësohen aftësitë, kërkesave që studentët dhe ofertat e kompanive të ndryshme. KPT është në 5 projekte të rëndësishme, në kuader të shkëmbimit të eksperiencave, mobilitetit, rritjes së kapaciteteve në nivel institucional duke përfshirë edhe këtë program studimi. Studentët janë pjesë e projekteve, marrin pjesë në trajnime ëorkshop, mobilitete etj. Psh. Projektit në projektin MOVET, studentët, stafi akademik dhe administrativ ishin pjesë e Ëorkshop Design Thinking.</p> <p>(Evidenca 7.1:Strategjia 2015-2020; Evidence 10:Lista e marrëveshjeve IAL-Marreveshjet; Evidence 10.1:Aktiviteti Konferenca e Rektorëve; Evidence 18/1: Panairi i punës; Evidenca 33: Lista e partnerëve /marrëveshjeve të bashkëpunimit; Evidenca 11: Lista e Projekteve; Evidence 11.1: Ëorkshop Online USIA MOVET; Evidence 11.2: MOVET Design Thinking Ëorkshop; Evidence 10.2: MoU_UTH; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e</p>	<p>GVJ duke u bazuar tek RVB dhe nga pyetjet gjatë vizitës në institucion konstatoi që Kolegjit Profesional të Tiranës ka në misionin e tij të jete nje nder ofruesit me te rendesishem te arsimit profesional ne vend i cili do te jete nje ure lidhese midis edukimit akademik dhe trajnimit profesional, duke i ndihmuar studentet ne integrimin sa me te lehte ne tregun e punes. Po ashtu edhe objektivi për të ndërtuar ura të bashkëpunimit me biznesin vendas dhe të huaj, duke mundësuar zhvillimin e praktikave profesionale dhe punësimin eventual të studentëve pas përfundimit të studimeve. Marrëdhëniet mbahen nga Departamenti në bashkëpunimin e Zyrën e Informacionit, Mbështetjes</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 11

<p>praktikës.</p>	<p>dhe Karrierës. Vume re qe janë rreth 30 Marrëveshje të lidhura për këtë program studimi. Ne Rregulloren e praktikave profesionale, vume re qe shpjegohet organizimi i praktikave profesionale. Praktika profesionale e studenteve, organizohet, ndiqet dhe mbikeqyret nga pergjegjesi i Departamentit ne bashkepunim me zyren e Informacionit dhe Mbeshtetjes se studenteve. Studenti ploteson formularin per propozimin e institucionit ku do te kryeje praktiken. Studenteve u vihet ne dispozicion lista e subjekteve publike dhe private me te cilat KPT ka marreveshje bashkepunimi. Ne perputhje me kapacitetet pritese te cdo subjekti departamenti shqyrton kerkesat e studenteve dhe ben miratimin ku do kryhet praktika dhe pedagogun drejtues. Per programin “Database dhe Web design” praktika profesionale zhvillohet ne agjensite kreative ose studio e imazhit dhe marketingut, ne kompani/institute qe merren me sherbime te sondazheve, ne entitete qe merren me mbledhjen dhe perpunimin e te dhenave si INSTAT, AKSHI, etj.</p> <p>Po keshtu ne Strategjinë 2021-2025, vume re qe marrëdhëniet e bashkëpunimit të vendosura me aktorë dhe institucione vendase, kanë si qëllim realizimin e praktikave profesionale, ku studentët mund të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes për integrim në tregun e punës.</p> <p>Zyra USIA në KPT është ngritur në kuadër të projekti Erasmus + CBHE USIA. Ajo do të ndihmojë të përmirësojë kapacitetet e KPT për bashkëprodhimin e njohurive me anë të ngritjes së rrjetit të partnerëve.</p> <p>(Evidenca 3: Statuti, Neni 6; Evidenca 5.1: Rregullorja e praktikave profesionale; Evidence 11.4: Zyra USIA; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ duke u bazuar tek RVB dhe nga pyetjet gjatë vizitës në institucion konstatoi që marrëdhëniet mbahen nga Departamenti në bashkëpunimin e Zyrën e Informacionit, Mbështetjes dhe Karrierës. Në Rregulloren e praktikave profesionale, vume re qe shpjegohet organizimi i praktikave profesionale. Praktika profesionale e studenteve, organizohet, ndiqet dhe mbikeqyret nga pergjegjesi i Departamentit ne bashkepunim me zyren e Informacionit dhe Mbeshtetjes se studenteve. Studenti ploteson formularin per propozimin e institucionit ku do te kryeje praktiken. Studenteve u vihet ne dispozicion lista e subjekteve publike dhe private me te cilat KPT ka marreveshje bashkepunimi. Ne perputhje me kapacitetet pritese te cdo subjekti departamenti shqyrton kerkesat e studenteve dhe ben miratimin ku do kryhet praktika dhe pedagogun drejtues. Për programin “Database dhe Web design” praktika profesionale zhvillohet ne agjensite kreative ose studio e imazhit dhe marketingut, në kompani/institute që merren me sherbime te sondazheve, ne entitete qe merren me mbledhjen dhe perpunimin e te dhënave si INSTAT, AKSHI, etj. Praktika profesionale shërben për aftësimin praktik dhe profesional në vendin e punës dhe që student të njihet me kulturën e punës dhe kulturën e biznesit dhe të gjejë një punëdhënës të mundshëm. Praktika është menduar të jetë në fazën e fundit të studimeve. Vume re qe në fund të çdo viti akademik, praktikat</p>

	<p>vlerësohen nga një komison dhe nga vetë studentët me anë të një formulari. Merret feedback për efektshmërinë e realizimit të tyre. Vlerësohet se ku mund të punohet më tej në përmirësimin e praktikave. Rregullorja e posaçme i nënshtrohet rishikimeve me qëllim përmirësimin e saj. Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve punon edhe për organizimin e praktikave mësimore, si dhe për ura lidhjeje dhe integrimin në tregun e punës për studentët, etj. Departamenti harton raport analitik të përfitimit prej marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p>(Evidence 5.2: Raporti i praktikave; Pyetjet gjatë vizitës në institucion; Evidenca 3: Statuti, Neni 6; Evidenca 5.1: Rregullorja e praktikave profesionale; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>GVJ duke u bazuar tek RVB dhe nga pyetjet gjatë vizitës në institucion konstatoi që Kolegjit Profesional të Tiranës ka në misionin e tij të jete nje nder ofruesit me te rendesishem te arsimit profesional ne vend i cili do te jete nje ure lidhese midis edukimit akademik dhe trajnimit profesional, duke i ndihmuar studentet ne integrimin sa me te lehte ne tregun e punes. Po ashtu edhe objektivi për të ndërtuar ura të bashkëpunimit me biznesin vendas dhe të huaj, duke mundësuar zhvillimin e praktikave profesionale dhe punësimin eventual të studentëve pas përfundimit të studimeve. Praktika profesionale shërben për aftësimin praktik dhe profesional në vendin e punës dhe që student të njihet me kulturën e punës dhe kulturën e biznesit dhe të gjejë një punëdhënës të mundshëm. Praktika është menduar të jetë në fazën e fundit të studimeve. Zhvillimi i praktikave profesionale ka rezultuar efikas dhe është finalizuar dhe me punësim të studentit në subjektin pritës. Marrëdhëniet e bashkëpunimit synojnë krijimin e lidhjeve midis IAL dhe aktorëve të tregut të punës në funksion të punësimit të studentëve. Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve punon edhe për organizimin e praktikave mësimore, si dhe për ura lidhjeje dhe integrimin në tregun e punës për studentët, etj. Vumë re që KPT nëpërmjet Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, edhe pas përfundimit të studimeve për të ndjekur ecurinë e tyre të punësimit, për ata që janë të punësuar dhe për të ofruar mundësi punësimi, këshillim karriere për ata që nuk janë punësuar ende si dhe për t'i asistuar në hyrjen dhe përshtatjen me tregun e punës. Një tjetër pikë te misioni është edhe pajisja e studenteve me aftësi teorike dhe praktike për ti bërë ata të aftë të përballen me sfidat në rritje të tregut të punës, nëpërmjet përshtatjes së programeve të studimit dhe planeve mësimore drejt nevojave reale të industrisë. Gjithashtu nga strategjia 2015-2020 si prioritet strategjik shihet orientimi drejt praktikës profesionale, duke synuar të sigurohet një eksperience praktike dhe duke u mundësuar atyre të avancojnë në punësim. Dhe nje prioritet tjetër është bashkëpunimi me bizneset dhe krijimi i nje raporti optimal, duke synuar punësim të studentëve. Stretgjia 2021-2025 ka një nga pikat krijimin e mundësive</p>

	<p>për akses në tregjet e punës dhe furnizimi i tyre me teknikë dhe profesionistë. Si edhe krijimi dhe forcimi i lidhjes mes arsimit profesional dhe tregut të punës në kuadrin e dinamikave të ekonomisë. KPT krijon mundësi të publikimeve për punësim në faqen e internetit të KPT dhe në rrjetet sociale të KPT, disa shfaqen në ekranin e madh në katin e parë ose dergohen me postë elektronike. KPT organizon panairin e punës me pjesëmarrjen e shumë kompanive, institucioneve dhe organizatave më të mëdha që operojnë në tregun shqiptar në fusha të ndryshme. Kjo krijon mundësi të reja për bashkëpunim, punësim të studentëve dhe internshipe. Psh. përmendim bashkëpunimin me “Praktika.al”, ëbsite i madh i ofrimit të mundësive të internshipeve dhe praktikave profesionale për studentët dhe të sapodiplomuarit. Këtu ndërmjetësohen aftësitë, kërkesave që studentët dhe ofertat e kompanive të ndryshme. Vumë re që në këtë program studimi 65% janë të punësuar. (Evidence 3: Statuti KPT, neni 6; Evidence: 12 Sondazhi Alumni; Evidence 12.1 Thirrje/Njoftime Punësimi; Evidence 18/2: Panairi i punës; Evidenca 33: Lista e partnerëve/marrëveshjeve të bashkëpunimit; Pyetjet gjatë vizitës në institucion; <a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/mundesite-e-punesimit-dhe-intership/">https://kolegjiprofesional.edu.al/mundesite-e-punesimit-dhe-intership/</a>; <a 4"="" href="https://kolegjiprofesional.edu.al/solaron/?fbclid=IéAR3cyvfiÉF7Hi1pUPJySm1cëvjhEoIQ-oYëSqRJkn8aOqNpBSDNExJÉTvjY.)&lt;/a&gt;&lt;/p&gt; &lt;/td&gt; &lt;/tr&gt; &lt;tr&gt; &lt;td&gt;&lt;b&gt;Konkluzione&lt;/b&gt;&lt;/td&gt; &lt;td colspan="> <p>GVJ konstaton se KPT siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, biznese në funksion të realizimit të programit të studimit, për aftësimin profesional të studenteve.</p> </a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

<b>Standardi I.3</b>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që KPT synon sigurimin e cilësisë të programit të studimit. KPT harton politika dhe ngrre struktura përkatëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë si dhe krijon kushtet për ushtirimin e veprimtarisë së jashtme të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë. Në komunikim të vazhdueshëm edhe me studentët, dhe stafin, merr informacione mbi problematikat që shfaqen gjatë procesit mësimor e me gjerë. Sigurimi i Brendshëm i cilesise eshte garantimi i cilesise gjate ushtrimit te veprimtarive akademike, kerkimore, kulturore, shoqerore te personelit akademik dhe të studenteve, si edhe e veprimtarive administrative dhe financiare te KPT. Institucioni i kushton vëmendje të veçantë sigurimit</p>

	<p>të brendshëm të cilësisë, për të garantuar që veprimtaria e tij të jetë në përputhje me ligjin në fuqi, Statutin dhe aktet e tjera të brendshme rregullatore. Objektivat strategjike nepermjet sigurimit të cilësisë, vazhdojnë të jenë në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. Strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë: Strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet drejtuese) të KPT, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e Akteve Rregullatore, të politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Konstatuam që Njësia e SBC ishte gjithashtu një strukturë që realizonte si qëllime kryesore rritjen e vazhdueshme të cilësisë së drejtimit të KPT, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkekohore, si dhe angazhimit të të gjitha niveleve drejtuese dhe organizative; gjithashtu aplikimi i vazhdueshëm i filozofise së KPT, duke zbatuar një program akademik që përkon me misionin dhe objektivat e KPT; rritja e vazhdueshme e cilësisë së studentëve duke u ofruar atyre, dijet, metodat dhe teknikat me bashkëkohore të mësimdhënies dhe duke nxitur të qenit proaktiv e kritik në dhënien e opinioneve mbi çështje aktuale. Objektivat e SBC janë të lidhura me monitorimin e vazhdueshëm të drejtimit të institucionit, ndjekjen e vazhdueshme të gjendjes së programit të lëndëve, ndjekjen e nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës dhe kualifikimin, monitorimin e procesit mësimor, ndjekjen e ecurisë së kërkimit shkencor, përfshirjen e studentëve, bashkëpunimin me institucione të tjera akademike dhe shtrirjen e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në të gjitha hallkat e institucionit. Vume re që ka evidence të takimeve të NJSBC.</p> <p>(Evidence 13.1 Rregullorja NJSBC; Evidence 3: Statuti KPT neni 11; Evidence 3: Statuti KPT neni 11; Evidenca 13.2 Raporti NJSBC; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që KPT harton politika dhe ngre struktura përkatëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë si dhe krijon kushtet për ushtirimin e veprimtarisë së jashtme të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë.</p> <p>Në komunikim të vazhdueshëm edhe me studentët, dhe stafin, merr informacione mbi problematikat që shfaqen gjatë procesit mësimor e me gjerë. Sigurimi i Brendshëm i cilësisë është garantimi i cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqerore të personelit akademik dhe të studenteve, si edhe e veprimtarive administrative dhe financiare të KPT. NJSBC është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të institucionit dhe ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Kjo njësi përbëhet nga pedagogë dhe përfaqësues nga njësiti ndihmës, një anëtar - ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues nga studentët. Objektivat e SBC janë të lidhura me monitorimin e vazhdueshëm të drejtimit të institucionit, ndjekjen e vazhdueshme të gjendjes së programit të lëndëve, ndjekjen e</p>

	<p>nivelit te cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës dhe kualifikimin, monitorimin e procesit mësimor, ndjekjen e ecurisë së kërkimit shkencor, përfshirjen e studentëve, bashkëpunimin me institucione të tjera akademike dhe shtrirjen e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në të gjitha hallkat e institucionit. Gjatë Covid 19, KPT ka synuar dhe ka bërë përpjekjet të mira me synimin për të qenë sa më pranë studentëve, duke i mbajtur në rrjedhën normale të programeve mësimore. Ajo mori masat për zhvillimin e mësimimit në mënyrë alternative dhe të punës në distancë e më pas hibride, duke shfrytëzuar përparësitë e teknologjisë. Vendimmarrjet ishin të shpejta dhe efikase dhe duhet të kishte parasysh tejkalimin e situates dhe pasojat e saj. Cilësia në mësimdhënie në burime njerëzore dhe infrastrukturore gjithashtu. Përforcimi i lidhjeve me bizneset, promovimi i studentëve dhe ndjekja e karrierës së tyre në punë. Zgjerimi i ndërkombëtarizimit dhe pasurimi i portofolit të projekteve vumë re që ishin gjithashtu ndër pikat e zbatimit të përpjekjeve për ruajtjen e cilësisë.</p> <p>(Evidence 3: Statuti, Neni 16; Evidence 13 - Vendim i ngritjes së NJSBC; Evidenca 13.1 Rregullorja NJSBC; Evidenca 13.2 Raporti NJSBC; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që KPT harton politika dhe ngre struktura përkatëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë si dhe krijon kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së jashtme të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë.</p> <p>NJSBC është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të institucionit dhe ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Kjo njësi përbëhet nga pedagogë dhe përfaqësues nga njësitë ndihmës, një anëtar si ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues nga studentët. Objektivat e SBC janë të lidhura me monitorimin e vazhdueshëm të drejtimit të institucionit, ndjekjen e vazhdueshme të gjendjes së programit të lëndëve, ndjekjen e nivelit te cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës dhe kualifikimin, monitorimin e procesit mësimor, ndjekjen e ecurisë së kërkimit shkencor, përfshirjen e studentëve, bashkëpunimin me institucione të tjera akademike dhe shtrirjen e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në të gjitha hallkat e institucionit. Në procesin e sigurimit të cilësisë përfshihet personeli akademik, ndihmës, dhe monitorimi nga ana e strukturave drejtuese, NJSBC-së, marrja e mendimit të studentëve, sondazhe, fokus grupe. gjithashtu Vumë re që është i rëndësishëm bashkëpunimi me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore. Vumë re që KPT ka pasur në mënyrë periodike vlerësime të jashtme, akreditimin e parë dhe periodik institucional dhe të programeve të studimit. Gjithashtu edhe vizita monitoruese nga MAS lidhur me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore etj. KPT dhe mjetet në dispozicion përmbushin kriteret e përdorimit, funksionimit të sigurisë. Ato vlerësohen rregullisht nga autoritete të licencuara. Ambientet laboratorike janë pajisur me rregullat përkatëse të sigurimit teknik. Gjithashtu në KPT është ngritur dhe</p>




	<p>Këshilli i Sigurisë bazuar në legjislacionin e “Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë”. Stafit është trajnuar për dhënien e ndihmës së shpejtë dhe mbrojtjen nga zjarri. Mjeku i Ndërrmarrjes mban kartelat personale për stafit e institucionit.</p> <p>(Evidence 6.3 Mjeku i Ndërrmarrjes; Evidence 3 Statuti KPT neni 11; Evidence 14 - Inspektimet ISHP ISHTI; Evidenca 6.2 Veprimtari të Stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që KPT në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjesi edhe cilësisë së programeve përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe ose intervista të studentëve, të atyre të diplomuar të personelit akademik dhe gjithashtu të bashkëpunëtorëve dhe partnerëve.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik kryhet përmes praktikës së leksioneve të hapura. Në këto leksione zhvillohet një temë e planifikuar mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë ku marrin pjesë kolegët. Në fund të semestrit realizohet vlerësimi i studentëve. Ai ruan anonimatit e tyre. Gjithashtu realizohen focus grupe me studentët. Një tjetër element që përdoret për vlerësimin është përmes opinioneve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit. Në raste të veçanta kur evidentohet nevoja për përmirësimin e cilësisë vumë re që përdorej vlerësimi i Përgjegjësit të Departamentit ose një grup ad hoc, i ngritur me urdhër të Rektorit që bën vlerësim të cilësisë. Një tjetër element që përdoret për vlerësimin është përmes rezultateve të raporteve të NJSBC. Personelit akademik dhe autoriteteve drejtuese u dërgohen rezultatet e përpunuara.</p> <p>KPT në përputhje me natyrën e institucionit, realizon kërkim shkencor të aplikuar. NJSBC kontribuon në përmirësimin e procesit mësimor, të kurrikulave, syllabuseve, dhe në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Objektivat e NJSBC janë të lidhura me monitorimin e vazhdueshëm të drejtimit të institucionit, ndjekjen e vazhdueshme të gjendjes së programit të lëndeve, nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës dhe kualifikimin, monitorimin e procesit mësimor, ndjekjen e ecurisë së kërkimit shkencor, përfshirjen e studentëve, bashkëpunimin me institucione të tjera akademike dhe shtrirjen e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në të gjitha hallkat e institucionit. Cdo fillim viti ajo miraton një plan pune mbi mbikëqyrjen dhe vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative në KPT dhe vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike, të institucionit dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Përfundimet nga raportet diskutohen në cdo njësi me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>(Evidence 13.2 Raporti NJSBC; Evidence 15 Formularet e vlerësimit Studente, Evidencë 16 Fokus Grupe, Evidencë 17 Tutoriatet/këshillim akademik; Evidence 6.4 Anketa e Stafit; Evidence 9: Mbledhje e Asamblesë së Personelit; Evidence 11.3: USIA</p>




	roundtable; Evidence 19: Politika e kërkimit të aplikuar në KPT; Evidence 19/1: Kërkimi i aplikuar; Evidence 49: Prezantimet në Departament; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstatoi se KPT harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit DBWD.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X




## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit DBWD është hartuar në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit DBWD është i organizuar duke përfshirë njohuri të formimit të përgjithshëm metodologjik dhe kulturor, si edhe njohuri dhe aftësi specifike të fushës. Programi është organizuar duke harmonizuar lëndë bazë me përmbajtje teorike si disiplina të formimit të përgjithshëm, sic janë fizika, matematika etj., gjithashtu lëndë të formimit karakterizues të programit, disiplina integruese dhe të zgjedhura dhe veprimtari të karakterit formues, sipas legjislacionit. Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në pesë kategori, nga A-E. Programi i studimit dhe plani mësimor publikohen cdo fillim viti akademik në faqen zyrtare të Kolegjit Profesional të Tiranës. Lëndët dhe modulet e programit kanë kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), sipas Kartës së Bolonjës. Lëndët e këtij programi kanë 4, 5, ose 6 ECTS. Tema e diplomës ose provimi i formimit ka 7 ECTS. Praktika profesionale ka 10 ECTS. Programi i studimit DBWD zgjat dy vite akademike, me nga dy semestra cdo vit. Totali i krediteve të programit të studimit DBWD është 120 ECTS.</p> <p>(Evidenca 5.3. Plani mësimor, Evidence 5. Rregullore e programit të studimit, neni 3, neni 6; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>

**Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvilloni njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.

GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit DBWD ka si synim të pajisë studentët me

- njohuri të thella tekniko - praktike të nivelit profesional, që kërkohen nga fusha të ndryshme të aplikimeve të programimit për teknik të lartë.
- aftësi për zgjidhjen e problemeve të programimit në fusha të ndryshme dhe për t'u përshtatur me lehtësi me evolucionin e vazhdueshëm të teknologjisë.

- aftësi për të kuptuar dhe analizuar funksionimin e sistemeve relativisht komplekse, për të administruar faqe interneti, data base, përpunim imazhi, etj.

- aftësi për t'u specializuar edhe në mënyrë autonome, mbi bazën e kërkesave të tregut të punës.

Për organizimin e programeve të studimit dhe planeve mësimore, KPT-ja konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve dhe të profesioneve përkatëse, për t'iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Programi është hapur në vitin 2015 dhe ka qënë bazuar në nevojat e tregut të punës për profesionistë e teknikë të lartë në fusha të ndryshme të industrisë dhe shërbimit. Identifikimi dhe skicimi i nevojave të tregut të punës ishte nxitësi i parë për përzgjedhjen e programeve të studimit. Programi i studimit DBWD është hartuar në përputhje me qëllimin dhe misionin e KPT me njohuri dhe kompetenca profesionale në fushën përkatëse. Cdo lende ka kreditet perkatëse në syllabusin e saj dhe ka një ndarje të ketyre krediteve në orë leksione, ushtrime dhe laboratore. Studentët ndjekin secilën lëndë në ambientet e sallave të leksioneve dhe seminareve dhe në laboratorët e KPT. Gjithashtu ka raste kur shkohet në biznese dhe industri si edhe realizohen vizita në terren. Në këto raste aplikohen në praktikë njohuritë dhe aftësitë e fituara përmes laboratorëve apo praktikave. Gjithashtu organizohen edhe tavolina të rumbullakta. Vumë re shembuj të disa praktikave në terren me studentët.


(Evidenca 5.3. Plani mësimor; Evidenca 5.5. Syllabus; Evidenca 11.3 USIA; Evidence 18. Vizita/praktika në terren; Evidence 20. KPT HUB; Evidence 21. Trajnime student; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)

**Kriteri 3.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.

GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit DBWD ka si synim të pajisë studentët me njohuri të thella tekniko - praktike. Aftësi për zgjidhjen e problemeve të programimit në fusha të ndryshme. Aftësi për të kuptuar dhe analizuar funksionimin e sistemeve. Për organizimin e programeve të studimit dhe planeve mësimore, KPT-ja konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve dhe të profesioneve përkatëse, për t'iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Programi i studimit DBWD është hartuar në përputhje me qëllimin dhe misionin e KPT me njohuri dhe kompetenca profesionale në fushën përkatëse. Ky është program me karakter profesional 2-vjecar i organizuar në lëndë ku

	<p>përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale në profilin e DBWD. Disiplinat mësimore dhe veprimtarite e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori nga A-E. Në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm /baze, në kategorinë B disiplina të formimit karakterizues të programit, në kategorinë C bëjnë pjesë disiplina të ngjashme dhe/ose integruese, ose disiplina me zgjedhje, në kategorinë D veprimtari plotësuese për gjuhë të huaja, aftësim kompjuterik dhe praktika profesionale dhe në kategorinë E përfshihen detyrimet përmbyllëse si punimi i diplomës ose provimi i përgjithshëm përfundimtar.</p> <p>(Evidence 4. Rregullorja KPT, neni 34, Evidence 5. Rregullorja e programit të studimit, neni 5, 6; Evidence 46. Broshura KPT; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/ modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit DBWD është hartuar në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit DBWD është i organizuar duke përfshirë njohuri të formimit të përgjithshëm metodologjik dhe kulturor, si edhe njohuri dhe aftësi specifike të fushës. Programi i studimit DBWD është organizuar duke harmonizuar lëndë bazë me përmbajtje teorike si disiplina të formimit të përgjithshëm, siç janë fizika, matematika etj., gjithashtu lëndë të formimit karakterizues të programit, disiplina integruese dhe të zgjedhura dhe veprimtari të karakterit formues, sipas legjislacionit. Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në pesë kategori, nga A-E. Programi i studimit dhe plani mësimor publikohen çdo fillim viti akademik në faqen zyrtare të Kolegjit Profesional të Tiranës. Lëndët dhe modulet e programit kanë kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), sipas Kartës së Bolonjës. Pra, programi ka të përcaktuar qartë të gjithë elementët përbërës të strukture duke përfshirë ndarjen sipas lëndëve bazë, lëndëve karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe lëndëve plotësuese duke përmbyllur kriteret e vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Lëndët e këtij programi kanë 4, 5, ose 6 ECTS. Tema e diplomës ose provimi i formimit ka 7 ECTS. Praktika profesionale ka 10 ECTS. Programi i studimit DBWD zgjat dy vite akademike, me nga dy semestra çdo vit. Totali i krediteve të programit të studimit DBWD është 120 ECTS. Zyra e Karrierës dhe departamenti përcaktojnë pedagogët mbikëqyrës për drejtimit të studentëve gjatë praktikave profesionale. Ato zhvillohen në 6 javë në kompani dhe institucione të ndryshme e përkthyer në 10 kredite. Studentët kur mbarojnë praktikën bëjnë mbrojtjen para komisionit që miraton departamenti</p> <p>(Evidence 5.3. Plani mësimor, Evidence 5. Rregullore e programit të studimit, neni 3, neni 6; Pyetjet gjatë vizitës në institucion; Evidence 2. Statuti KPT, KREU V; Evidence 5. Rregullorja e Praktikës</p>

	profesionale, Evidenca 5.4. Dosja e praktikës; Evidence 4. Rregullorja KPT, neni 34)
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që KPT është IAL jo publike, me statusin Kolegj profesional i lartë. Pranimi i studenteve realizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me aktet rregullatorë të KPT. Autoritetet drejtuese të KPT marrin në konsideratë kapacitetet në infrastrukturë, burime njerëzore. Gjithashtu kërkesat e tregut kanë ndikimin e tyre në këtë proces. Pranojnë të gjithë ata kandidatë të cilët përmbushin kriteret e pranimit si dhe kriteret e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë (MAS). Kuotat dhe kriteret e pranimit shqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga Senati Akademik. Ato vendosen në portalin U Albania si dhe bëhen publike në faqen e internetit të KPT. Vumë re nga vizita në institucion dhe dokumentat përkatëse që bazuar në Statutin dhe Rregulloren e KPT është përgatitur edhe Strategjia e re 2022–2027 në të cilën janë parimet e pranimit të studentëve të rinj, bazuar në kriteret e detyrueshme ligjore, kapacitetet e KPT në infrastrukturë, burime njerëzore, analizave të tregut, ecurisë së programeve, punësimit të studentëve si dhe prirjet dinamike të zhvillimit të tregut të punës. GVJ vuri re që ka Politikën e Komunikimit shërben për të siguruar që në institucion aplikohen metodat e duhura të komunikimit dhe komunikimi është efektiv. Përmes kësaj politike publikut i sigurohet një informacion i kuptueshëm. Kemi disa forma komunikimi, përmes organizimit të eventeve, aktiviteteve të cilat promovojnë KPT dhe programin. Turne për vetë promovim me nxënësit e shkollave të mesme të vendit për promovimin e programeve të studimit. Reklamim në mediane dhe atë vizive. Ditët e hapura për publikun. Panairët. Promovimi nga pale të treta përmes logjistikës së tyre. Përgatitje e shpërndarje e materialeve informuese, sqaruese, ndërgjegjësuese si fletëpalosje, postera, broshura, etj. Komunikim nëpërmjet faqes zyrtare të KPT dhe rrjeteve sociale.</p> <p>(Evidence 4. Rregullorja KPT; Evidence 7 Strategjia 2021 – 2025; Evidence3:StatutiKPT,neni6,neni8,neni45; (<a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/programet-e-studimit-ne-kpt/">https://kolegjiprofesional.edu.al/programet-e-studimit-ne-kpt/</a>); Evidence23.Vendimet SA; Evidence24. Politika e Komunikimit; Evidence. 24.1–Turet;</p> <p>(<a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/regjistrimi/">https://kolegjiprofesional.edu.al/regjistrimi/</a>). Pyetjet gjatë vizitës në institucion;</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>NA</p>




<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që me daljen e akteve përkatëse nënligjore, KPT ka ndërmarrë procesin e kodifikimit të programeve të studimit që ofron, propozime të cilat janë dërguar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit përkatësisht  (Evidence 8. Shkresa MAS për kodifikimin e programeve).			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konstator se Programi i studimit DBWD organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që Departamenti i Teknologjisë së Informacionit është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit DBWD. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit si pjesë e strukturës është njësia bazë mësimore e kërkimore. Organigrama e KPT është e bazuar në funksione dhe segmente sipas parashikimeve të statutit në KPT, e cila nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, të trajnimit dhe të kërkimit.  Departamenti sipas statutit ka në përbërje të tij të paktën pesë anëtarë të punësuar me kohë të plotë si personel mësimdhënës nga të cilët të paktën dy pedagogë me tituj ose grada shkencore.  Departamenti ka në përbërje të tij personel akademik me tituj dhe grada. Për vitin akademik 2022-2023 ka në përbërje si Personel Akademik Efektiv 9 anëtarë (2 Prof. Dr, 1 MND, 6 MSc).  Departamenti për vitin akademik 2021-2022 ka pasur në përbërje si Personel Akademik Efektiv 9 anëtarë (2 Prof. Dr, 1 MND, 6 MSc).  Departamenti për vitin akademik 2020-2021 ka pasur në përbërje si Personel Akademik Efektiv 11 anëtarë (2 Prof. Dr, 1 MND, 8 MSc).  Për këtë program studimi angazhohet edhe Personel Akademik me kohë të pjesshme. GVJ vuri re që stafi akademik i brendshëm ka përvojë, përgatitje, cilësi, kualifikim dhe departamenti ka kapacitetet e duhura në ofrimin e këtij programi. Gjithashtu vumë re që departamenti ka 9 Laboratorë me natyrë ndërdisiplinore që i shërbejnë programeve që ai ofron. Vumë re që Departamenti vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPT është akredituar së pari me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.66, date 21.09.2017 "Për akreditimin e parë të

	<p>institucionit të arsimit të lartë” dhe ndërkohë është në process për akreditimin periodik institucional.</p> <p>Gjithashtu vumë re që me Urdhër të Rektorit të KPT, është ngritur GVB i cili ishte përbërë nga anëtarë PAE të departamentit dhe një përfaqësues i studentëve nga programit të studimit.</p> <p>(Evidence 3. Statuti, Neni 14; Evidence 6.1. Të dhënat e stafit në vite; Evidence 3.1. Organigrama; Evidence 2. Urdhri nr. 5/6 datë 10.11.2022; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që përvec stafit akademik për realizimin e praktikave mësimore në programin e studimit DBWD, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit ka mbështetje gjithashtu nga sekretaria mësimore. Gjithashtu stafi administrativ mbështet departamentin në këtë proces. KPT ka në focus primar laboratorët ku studentët zhvillojnë praktikat e lendeve perkatese. Vumë re që KPT investon vazhdimisht në permiresimin e laboratoreve. Se fundmi duke u bere pjese e projekteve te Bashkimit European USIA dhe ENGINE ka rritur kapacitetet e laboratoreve duke i zhvilluar me teknologjine bashkohore. Ka hapësira sipas nevojës se studenteve duke synuar nje post per cdo student. Vumë re që Departamenti i Teknologjisë së Informacionit ka 9 laboratore që i përdor për praktikat mësimore nga 11 Laboratorë që janë në total. Këto përdoren sipas lëndëve psh: Laboratori i Teknologjisë së Informacionit, Laboratori i Elektronikës, Laboratori i Instalimeve Elektrike, laboratori më i ri Smart LAB i krijuar në kuadër të projektit Erasmus + CBHE USIA. Gjithashtu KPT HUB është klubi i inovacionit në KPT i cili bashkon studentet dhe pedagogët të cilët luajnë rolin e mentoreve për ndërtimin e projekteve në fusha të ndryshme të teknologjisë. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit si njësi bazë për programin e studimit DBWD përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi gjatë procesit të realizimit të praktikave mësimore për çdo lëndë sipas disiplinave përkatëse.</p> <p>(Evidenca 20 KPT HUB; Evidence 22 Laboratorët; Pyetjet gjatë vizitës në institucion; Evidenca 5.2 Raporti i praktikave; Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që Departamenti i Teknologjisë së Informacionit është njësi bazë për programin e studimit DBWD. Në këtë rast vumë re që për ecurinë dhe zhvillimin e programit është përgjegjës drejtuesi i departamentit. Ai shqyrton dhe miraton planet mësimore dhe programet e studimit dhe propozon hapjen e programeve të reja të studimit. Praktika profesionale e studenteve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga përgjegjësi i Departamentit, në bashkëpunim me zyrën e Informacionit dhe Mbështetjes së Studenteve. Përgjegjësi i Departamentit cakton pedagogët si pedagog koordinatör, përgjegjës për ndjekjen e studentëve në praktikat profesionale. Gjatë kryerjes së praktikës, pedagogu</p>



	mbikëqyrës ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me personelin mbikëqyrës të studentit të caktuar nga subjekti pritës. (Evidenca 41. Emaillet njoftuese nga koordinatore; Pyetjet gjatë vizitës në institucion; Evidenca 3. Statuti, neni 27; Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale; Evidenca 5.2 Raporti i praktikave)			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konstaton se Departamenti i Teknologjisë së Informacionit përgjegjës për programin e studimit, përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që të gjitha njësitet, pjesë e KPT sigurojnë informacionin dhe strukturën e nevojshme për ofrimin dhe manaxhimin e programit të studimit DBWD. Departamenti dhe çdo anëtar i personelit akademik dhe administrativ, ka akses tek Informacioni lidhur me organizimin, strukturën përmbajtjen e programit të studimit, aktet rregullatore të IAL, kurrikulen, planin mësimor, silabuset, rregulloren etj. KPT përbëhet nga njësi bazë, njësi ndihmëse dhe njësi administrative. Programin e studimit DBWD e ofron Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, i cili është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të trajnimit. Njësi ndihmëse mësimore janë laboratorët, bibliotekat dhe libraria. Laboratorët dhe ofcinat mbulojnë lëndë sipas fushave. Biblioteka bën ruajtjen, përdorimin, pasurimin, shpërndarjen dhe huazimin e pasurisë bibliografike të institucionit. Libraria tregon pasurinë bibliografike akademike që përdoret në mësimdhënie si edhe materialet e tjera didaktike të përgatitura nga personeli akademik. Studentët e programit të studimit DBWD marrin informacionin e nevojshëm lidhur me programin e studimit dhe lëndët e tij. Në faqen e internetit të KPT ka të dhëna për programin e studimit. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit. Njësitë administrative përfshijnë, zyrën e burimeve njerëzore dhe kontratave, zyrën e financës, sekretarinë mësimore, zyrën e protokollit dhe arkivës, zyrën e IT dhe projekteve, zyrën e karrierës, mbështetjes dhe informimit të studenteve, zyrën e kurrikulave. Veprimtaria e njësive administrative, organizimi, përbërja dhe funksionimi përcaktohet në rregulloren e brendshme të KPT. (Evidenca 3: Statuti, Neni 13, Neni 14.; Evidenca 4: Rregullorja

	KPT; Evidence 5.6: Strategjia e Zhvillimit të programit të studimit; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve në kredite, orët në auditor/ jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që Programi i studimit dhe plani mësimor publikohen cdo fillim viti akademik në faqen zyrtare të Kolegjit Profesional të Tiranës. Lëndët dhe modulet e programit kanë kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS), sipas Kartës së Bolonjës. Programi i studimit DBWD ka të përcaktuar të gjithë elementët përbërës të strukture duke përfshirë ndarjen sipas lëndëve bazë, lëndëve karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe lëndëve plotësuese duke përbushur kriteret e vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Lëndët e këtij programi kanë 4, 5, ose 6 ECTS. Tema e diplomës ose provimi i formimit ka 7 ECTS. Praktika profesionale ka 10 ECTS. Programi i studimit DBWD zgjat dy vite akademike, me nga dy semestra cdo vit. Totali i krediteve të programit të studimit DBWD është 120 ECTS. Programi jep informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, në disiplinën përkatëse, kreditet që ka, orët në auditor, orët jashtë auditorit. Në planin mësimor lëndët kanë leksione, ushtrime dhe laboratore të përcaktuara sipas ngarkesës së krediteve. Rregullorja e programit të studimit jep informacion lidhur me kreditet dhe punën e studentit. Një kredit është 25 orë mësimore pune e studentit, dhe përfshin edhe orët mësimore në auditor po ashtu edhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit.</p> <p>(Evidenca 5.3 Plani mësimor DBËD; Evidenca 4: Rregullorja KPT; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që Rregullorja e Programit të Studimit përmban kriteret e pranimit në këtë program studimi. Për tu pranuar në këtë program studimi, kandidati/student duhet të ketë përfunduar me sukses provimet e Matures Shtetërore dhe të zotërojë një diplomë të shkollës së mesme të përgjithshme me kohëzgjatje tre vjet, ose sipas sistemit të vjetër me kohëzgjatje katër vjet, ose edhe shkollë të mesme profesionale me kohëzgjatje pesë vjet. Programi i studimit pranon kandidatë në varësi të kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike dhe sipas kriterëve specifike që mund të përcaktohen paraprakisht nga institucioni. Në fillim të vitit akademik organizohen ditët orientuese, ku mbahen takime dhe leksione për shpjegimin e sistemit të studimeve, të rregulloreve dhe të procedurave administrative për studentët e rinj. Kandidati mund të ketë edhe ndonjë diplomë tjetër studimi të ndjekur në një institucion jashtë vendit që njihet dhe është e vlefshme, ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara në përputhje me legjislacionin ekzistues. Gjithashtu në këtë program studimi pranohen edhe kandidatë/student të cilët kanë një diplomë profesionale të marrë në një institucion të arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit dhe kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi. Në rastet kur studenti kërkon transferimin e krediteve, procesi i njohjes dhe vlerësimit të programit të studimit bëhet nga KPT, në nivel</p>

	<p>departamenti. Informacionet pasi miratohen nga Seanti Akademik, publikohen në faqen e internetit dhe në rrjetet sociale të KPT. Edhe rregullorja e KPT, jep informacion për pranimin e studentëve, lidhur me transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e lëndëve.b</p> <p>(Evidence 4 Rregullorja KPT, neni 24, 31, Evidence 5 Rregullorja e Programit të Studimit, neni 2; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që Programi i studimit dhe plani mësimor publikohen cdo fillim viti akademik në faqen zyrtare të Kolegjit Profesional të Tiranës. Lëndët dhe modulet e programit kanë kredite, sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS), sipas Kartës së Bolonjës. Programi i studimit DBWD ka të përcaktuar të gjithë elementët përbërës të strukture duke përfshirë ndarjen sipas lëndëve bazë, lëndëve karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe lëndëve plotësuese duke përmbushur kriteret e vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL". Lëndët e këtij programi kanë 4, 5, ose 6 ECTS. Tema e diplomës ose provimi i formimit ka 7 ECTS. Praktika profesionale ka 10 ECTS. Programi i studimit DBWD zgjat dy vite akademike, me nga dy semestra cdo vit. Totali i krediteve të programit të studimit DBWD është 120 ECTS. Programi jep informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, në disiplinën përkatëse, kreditet që ka, orët në auditor, orët jashtë auditorit. Në planin mësimor lëndët kanë leksione, ushtrime dhe laboratore të përcaktuara sipas ngarkesës së krediteve. Rregullorja e programit të studimit jep informacion lidhur me kreditet dhe punën e studentit. Një kredit është 25 orë mësimore pune e studentit, dhe përfshin edhe orët mësimore në auditor po ashtu edhe orët mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit. Programi i studimit organizohet në lëndë, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Këto të dhëna detajohen edhe në kurrikulën dhe rregulloren e programit të studimit, të cilat i vihen në dispozicion studentit. Programi e studimit DBWD kombinon teorinë me praktikën në laboratorë, në subjekte pritëse dhe vizita në terren dhe synojnë të formojnë specialistë të fushave përkatëse, të aftë për të përmbushur kërkesat dinamike të tregut të punës. Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë organizuar në 5 kategori nga A-E. Në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë, në kategorinë B disiplina të formimit karakterizues të programit, në kategorinë C bëjnë pjesë disiplina të ngjashme dhe/ose integruese, ose disiplina me zgjedhje, në kategorinë D veprimtari plotësuese për gjuhë të huaja, aftësi kompjuterike dhe praktika profesionale dhe në kategorinë E përfshihen detyrimet përmblylëse si punimi i diplomës ose provimi i përgjithshëm përfundimtar. Syllabuset e çdo lënde hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe miratohen përpara fillimit të semestrit nga drejtuesi i departamentit. Ato janë hartuar në përputhje me kriteret ligjore dhe sipas planit mësimor duke u</p>

	<p>organizuar në leksione, ushtrime dhe laboratore. Vumë re që syllabuset e lëndëve plotësohen sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni, ku jepet informacion i detajuar mbi objektivat e lëndës, temat, kontrollit të dijeve dhe format e vlerësimit, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar.</p> <p>(Evidenca 5.3 Plani mësimor DBËD; Evidence 4. Rregullorja KPT, neni 34; Evidenca 5. Rregullorja e Programit të Studimit; Evidenca 5.5 Syllabus; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit DBWD, plani mesimor, disiplinat mesimore dhe veprimtarite formuese që ofrohen në këtë program si edhe kreditet për secilën prej tyre janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe rishikohen në mënyrë periodike në përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme të vendit. Propozimi për ndryshime në çdo rast vjen i argumentuar. Ai shqyrtohet në departament dhe pastaj dërgohet për miratim në mbledhjen e Rektoratit e më pas në Senat. Vumë re që syllabuset e çdo lënde hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe miratohen përpara fillimit të semestrit nga drejtuesi i departamentit me ndryshimet përkatëse sipas njohurive të reja dhe informacionit që merret nga pjesëmarrja në evente, studimet e tregut, kontaktet me biznesin, bëjnë përditësimin me trendet ekonomike, sociale, kërkesat e tregut të punës. Ato janë hartuar në përputhje me kriteret ligjore dhe sipas planit mësimor duke u organizuar në leksione, ushtrime dhe laboratore. Vumë re që syllabuset e lëndëve plotësohen sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni, ku jepet informacion i detajuar mbi objektivat e lëndës, temat, kontrollit të dijeve dhe format e vlerësimit, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar. Sipas rregullores së brendshme dhe akteve nënligjore në fuqi duke u bazuar në tregun e punës dhe zhvillimin e teknologjisë, departamenti bën përditësimet e kurrikulës, syllabusve, literaturës, infrastrukturës.</p> <p>(Evidenca 7 Strategjia 2021-2025 Kerkimi i tregut; Evidenca 5.5 Syllabus; Evidenca 5: Rregullorja e programit të studimit; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se Programi i studimit DBËD përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore për secilën lëndë, për praktikat, seminarët, laboratorët, etj., dhe është në përmirësim të vazhdueshëm.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi II.4**

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të**

**të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që KPT e ka pjese te misionit qe te jete nje ure lidhese midis edukimit akademik dhe trajtimit profesional, duke i ndihmuar studentet ne integrim sa me te thjeshte ne tregun e punes. Gjithashtu ne strategjine tek objektivat e veprimtarise ndervepruese dhe bashkepunimit, nje pike lidhet me krijimin e mundesise per akses ne tregun e punes, dhe furnizimi i tij me teknike dhe profesioniste te pergatitur profesionalisht. Disiplinat mësimore dhe veprimtarite e tjera formuese që ofrohen ne kete program studimi jane te organizuara në 5 kategori nga A-E. Në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit te pergjithshem/ baze, ne kategorine B disiplina te formimit karakterizues te programit, ne kategorine C bëjnë pjesë disiplina të ngjashme dhe/ ose integruese, ose disiplina me zgjedhje, në kategorinë D veprimtari plotësuese për gjuhë të huaja, aftesim kompjuterik dhe praktika profesionale dhe ne kategorine E përfshihen detyrimet përmbyllëse si punimi i diplomës ose provimi i pergjithshëm përfundimtar. Syllabuset e çdo lënde hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe miratohen përpara fillimit të semestrit nga drejtuesi i departamentit. Ato janë hartuar në përputhje me kriteret ligjore dhe sipas planit mësimor duke u organizuar në leksione, ushtrime dhe laboratore. Vumë re që syllabuset e lëndëve plotësohen sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni, ku jepet informacion i detajuar mbi objektivat e lëndës, temat, kontrollit të dijeve dhe format e vlerësimit, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar. Programi e studimit DBWD kombinon teorinë me praktikën në laboratorë, në subjekte pritëse dhe vizita në terren dhe synojnë të formojnë specialistë të fushave përkatëse, të aftë për të përmbushur kërkesat dinamike të tregut të punës. Programi kombinon teorinë dhe praktikën, dhe synon nxitjen e studentëve për përvetësimin dhe aplikimin e dijeve bashkëkohore dhe inovacionit. Programi përgatit profesionistë në zbatimin e metodologjive në fushën e bazës së të dhënave, trajtime imazhi dhe dizanj Web-i; profesionistë në zbatime të teknologjisë së lartë e me një tematikë të gjerë, nga faqet e internetit, krijimi i programeve për biznese dhe individë, puna në studiot e imazhit dhe marketingut, etj. Programi përgatit studentët me njohuri teorike dhe praktike, të aftë për të dizenuar, krijuar, ndërtuar, programuar dhe mirëmbajtur faqe interneti, baza të dhënash dhe aplikacione të mbështetura në to.</p> <p>(Evidence 5: Rregullorja e Programit të Studimit, neni 6; (Evidenca 5.3: Plani Mesimor i programit DBED; Evidenca 7: Strategjia 2021-2025 Kerkimi i tregut; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit DBWD ka të përcaktuar të gjithë elementët përbërës të strukture duke përfshirë ndarjen sipas lëndëve</p>

<p>mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>bazë, lëndëve karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe lëndëve plotësuese duke përbushur kriteret e vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Lëndët e këtij programi kanë 4, 5, ose 6 ECTS. Tema e diplomës ose provimi i formimit ka 7 ECTS. Praktika profesionale ka 10 ECTS. Programi i studimit DBWD zgjat dy vite akademike, me nga dy semestra cdo vit. Totali i krediteve të programit të studimit DBWD është 120 ECTS. Programi jep informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, në disiplinën përkatëse, kreditet që ka, orët në auditor, orët jashtë auditorit. Në planin mësimor lëndët kanë leksione, ushtrime dhe laboratore të përcaktuara sipas ngarkesës së krediteve. Programi kombinon teorinë dhe praktikën, dhe synon nxitjen e studentëve për përvetësimin dhe aplikimin e dijeve bashkëkohore dhe inovacionit. Programi përgatit profesionistë në zbatimin e metodologjive në fushën e bazës së të dhënave, trajtime imazhi dhe dizanj ëeb-i; profesionistë në zbatime të teknologjisë së lartë e me një tematikë të gjerë, nga faqet e internetit, krijimi i programeve për biznese dhe individë, puna në studiot e imazhit dhe marketingut, etj. Programi përgatit studentët me njohuri teorike dhe praktike, të aftë për të dizenuar, krijuar, ndërtuar, programuar dhe mirëmbajtur faqe interneti, baza të dhënash dhe aplikacione të mbështetura në to. Vumë re që ruhet një raport proporcional ndërmjet aktiviteteve teorike dhe aktiviteteve praktike dhe shpërndarja e lëndëve është bërë e tillë që lëndët, njohuritë, aftësitë dhe shprehjet që fitohen të jenë në vijimësi të njëra-tjetrës. Gjatë një viti akademik, organizimi i veprimtarisë mësimore shtrihet në 2 semestra me kohëzgjatje 15 javë. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestrat e kohëzgjatjes së programit është e balancuar dhe mundëson arritjen e rezultateve të pritshme.</p> <p>(Evidence 5: Rregullorja e Programit të Studimit; Evidenca 5.3: Plani Mesimor i programit DBËD; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/ aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/ punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi i studimit DBWD ka të përcaktuar të gjithë elementët përbërës të strukture duke përfshirë ndarjen sipas lëndëve bazë, lëndëve karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/ integruese dhe lëndëve plotësuese duke përbushur kriteret e vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Lëndët e këtij programi kanë 4, 5, ose 6 ECTS. Tema e diplomës ose provimi i formimit ka 7 ECTS. Praktika profesionale ka 10 ECTS. Programi i studimit DBWD zgjat dy vite akademike, me nga dy semestra cdo vit. Totali i krediteve të programit të studimit DBWD është 120 ECTS. Programi jep informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, në disiplinën përkatëse, kreditet që ka, orët në auditor, orët jashtë auditorit. Në planin mësimor lëndët kanë leksione, ushtrime dhe laboratore të përcaktuara sipas ngarkesës së krediteve. Programi kombinon teorinë dhe praktikën, dhe synon nxitjen e studentëve për përvetësimin dhe aplikimin e dijeve bashkëkohore dhe inovacionit.</p>

	<p>Plotësimin të objektivave i shërben raporti i balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike. Vumë re që fillimisht vitin e parë, semestrin e parë, zhvillohen lëndët e formimit bazë të kategorisë A të cilat zënë afërsisht 15 % të ngarkesës totale të krediteve. Formimi teknik i profilizuar me lëndët karakterizuese në kategorinë B zë afërsisht 50% të ngarkesës totale të krediteve. Kategoria C zë afërsisht 20%, D zë afërsisht 10% dhe E 5%. Këto synojnë formimin në një fushë më të gjerë teknike, aftësive komunikuese e prezantuese si dhe aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës. 15 lëndë kanë laboratorë në formën e praktikës që zhvillon aftësitë praktike të studentëve.</p> <p>Vumë re që është synuar që praktika të jetë sa më e pranishme në kurrikulën e programit të studimit. Theksi është vënë te ana praktika e lëndë që realizohet kryesisht në ambientet e vetë IAL ose me vizita në institucionet dhe praktika në terren si praktikë profesionale. Praktika profesionale si lëndë shtrihet në 6 javë dhe shërben jo vetëm për aftësimin praktik dhe profesional në terren dhe në vendin e punës të studentit, po që ai të njihet dhe me kulturën e punës dhe kulturën e korporatës në terren, si dhe të gjejë te subjekti pritës një punëdhënës të mundshëm. Praktika është në fazën në fund të studimeve.</p> <p>(Evidenca 5.3: Plani Mesimor i Programit DBËD, Evidenca 5.5: Syllabuset; Evidence 18: Vizita/praktika në terren; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që Programi kombinon teorinë dhe praktikën, dhe synon nxitjen e studentëve për përvetësimin dhe aplikimin e dijeve bashkëkohore dhe inovacionit. Plotësimin të objektivave i shërben raporti i balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike. Vumë re që fillimisht vitin e parë, semestrin e parë, zhvillohen lëndët e formimit bazë të kategorisë A të cilat zënë afërsisht 15 % të ngarkesës totale të krediteve. Formimi teknik i profilizuar me lëndët karakterizuese në kategorinë B zë afërsisht 50% të ngarkesës totale të krediteve. Kategoria C zë afërsisht 20%, D zë afërsisht 10% dhe E 5%. Këto synojnë formimin në një fushë më të gjerë teknike, aftësive komunikuese e prezantuese si dhe aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës. 15 lëndë kanë laboratorë në formën e praktikës që zhvillon aftësitë praktike të studentëve. Vumë re që cdo ambient laboratorik/oficinë ishte i pajisur me rregullat përkatëse të sigurimit Teknik. Në KPT ishte ngritur dhe Këshilli i Sigurisë. Vumë re që është synuar që praktika të jetë sa më e pranishme në kurrikulën e programit të studimit. Theksi është vënë te ana praktika e lëndë që realizohet kryesisht në ambientet e vetë IAL ose me vizita në institucionet dhe praktika në terren si praktikë profesionale. Praktika profesionale si lëndë shtrihet në 6 javë dhe shërben jo vetëm për aftësimin praktik dhe profesional në terren dhe në vendin e punës të studentit, po që ai të njihet dhe me kulturën e punës dhe kulturën e korporatës në terren, si dhe të gjejë te subjekti pritës një punëdhënës të mundshëm. Praktika është në fazën në fund të studimeve. Kurrikula e programit të studimit garanton mundësinë e transferimit</p>

	<p>gjatë studimeve ose në përfundim të ciklit të studimeve, krahas mundësisë për punësim pas përfundimit të studimeve. Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta mund të transferohen në studimet e ciklit të parë që referohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve.</p> <p>(Evidenca 5.3: Plani Mësimor i Programit DBËD; Evidenca 5.5 Syllabuset; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>Vumë re që syllabuset e çdo lënde janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe rishikohen në mënyrë periodike në përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme të vendit. Propozimi për ndryshime në cdo rast vjen i argumentuar nga titullari i lëndës. Ai shqyrtohet në departament dhe pastaj dërgohet për miratim në mbledhjen e Rektoratit e më pas në Senat. Syllabuset e çdo lënde hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe miratohen përpara fillimit të semestrit nga drejtuesi i departamentit me ndryshimet përkatëse sipas njohurive të reja dhe informacionit që merret nga pjesëmarrja në evente, studimet e tregut, kontaktet me biznesin, bëjnë përditësimin me trendet ekonomike, sociale, kërkesat e tregut të punës. Ato janë hartuar në përputhje me kriteret ligjore dhe sipas planit mësimor duke u organizuar në leksione, ushtrime dhe laboratore. Vumë re që syllabuset e lëndëve plotësohen sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni, ku jepet informacion i detajuar mbi objektivat e lëndës, temat, kontrollit të dijeve dhe format e vlerësimit, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar. Sipas rregullores së brendshme dhe akteve nënligjore në fuqi duke u bazuar në tregun e punës dhe zhvillimin e teknologjisë, departamenti bën përditësimet e kurrikulës, syllabusve, literaturës, infrastrukturës. Krijimi dhe frekuentimi i bibliotekës on line, eksperiencat dhe bashkëpunimet ndërkombëtare, si dhe mobilitetet e stafit akademik në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, ku KPT është pjesëmarrës, kanë ndikuar në pasurimin dhe përmirësimin e syllabuseve dhe përditësimin e gjerë të literaturës.</p> <p>(Evidence 5: Rregullorja e Programit të Studimit, neni 6; Evidenca 5.5 Syllabuset; Evidenca 5.3: Plani Mesimor i programit DBËD; Evidenca 7: Strategjia 2021-2025 Kerkimi i tregut; Pyetjet gjatë vizitës në institucion; Evidence 11: Lista e Projekteve, Evidence 11.1: Ëorkshop Online USIA MOVET, Evidence 11.2: MOVET Design Thinking Ëorkshop, Evidence 11.3: USIA roundtable/USIA).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që është synuar që praktika të jetë sa më e pranishme në kurrikulën e programit të studimit. Praktika e lëndëve realizohet kryesisht në ambientet e vetë IAL ose me vizita në institucionet dhe praktika në terren si praktikë profesionale. Praktika profesionale si lëndë shtrihet në 6 javë dhe shërben jo vetëm për aftësimin praktik dhe profesional në terren dhe në vendin e punës të studentit, po që ai të njihet</p>




<p>profesionit.</p>	<p>dhe me kulturën e punës dhe kulturën e korporatës në terren, si dhe të gjejë te subjekti pritisë një punëdhënës të mundshëm. Praktika është në fazën në fund të studimeve dhe për këtë institucioni bashkëpunon me bizneset dhe industrinë, me institucione shtetërore ose ente të pavarura, ku realizohet praktika aftësuese në terren dhe ofrohen mundësi punësimi. Bashkëpunimi si më sipër me punëdhënësit e ardhshëm të studentëve, vlerësimet mbi rezultatet e bashkëpunimit me operatorët privatë dhe sistemit të tutorazhit garantojnë një formim praktik të përshtatshëm të studentëve në përputhje me kërkesat e profesionit të tyre në fushën e DBWD. Zyra USIA është ngritur në kuadër të projektit Erasmus + CBHE, Usia, dhe shërben si një sistem mbështetës për zgjerimin e rrjetëzimit të KPT dhe mundësive më të mira për studentët për të marrë një formim praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p> <p>(Evidence 5: Rregullorja e Programit të Studimit, neni 6; Evidenca 5.5 Syllabus; Evidenca 5.3: Plani Mesimor; 11.3: USIA roundtable/USIA; Evidencë 11.4: Zyra USIA; Evidenca 11.2: MOVET Desing thinking ëorkshop; Pyetjet gjatë vizitës në institucion; Evidenca 31. Takimi me biznese)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që Programi kombinon teorinë dhe praktikën, dhe synon nxitjen e studentëve për përvetësimin dhe aplikimin e dijeve bashkëkohore dhe inovacionit. Programi i studimit “DBWD” synon që të formojë teknikë të lartë në fushën e DBWD, që të jenë në gjendje të konceptojnë, dizenojnë, zhvillojnë, ndërtojnë, dhe mirëmbajnë sisteme Database dhe faqe ëeb në të gjitha fushat e biznesit. Njohuritë e fituara në lëndët Web Developing, Web Design, Bazat e informatikës, Database, Hyrje në Teknologjinë e Informacionit, Përpunim Imazhi, etj, japin dije, aftësi dhe kompetencat e synuara në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK. Plotësimi të objektivave i shërben raporti i balancuar midis pjesës të formimit teorik përkundërt atij praktik. Vumë re që fillimisht vitin e parë, semestrin e parë, zhvillohen lëndët e formimit bazë të kategorisë A të cilat zënë afërsisht 15 % të ngarkesës totale të krediteve. Formimi teknik i profilizuar me lëndët karakterizuese në kategorinë B zë afërsisht 50% të ngarkesës totale të krediteve. Kategoria C zë afërsisht 20%, D zë afërsisht 10% dhe E 5%. Këto synojnë formimin në një fushë më të gjerë teknike, aftësive komunikuese e prezantuese si dhe aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës. 15 lëndë kanë laboratorë në formën e praktikës që zhvillon aftësitë praktike të studentëve. Vumë re që cdo ambient laboratorik/oficinë ishte i pajisur me rregullat përkatëse të sigurimit Teknik. Në KPT ishte ngritur dhe Këshilli i Sigurisë. Vumë re që është synuar që praktika të jetë sa më e pranishme në kurrikulën e programit të studimit. Theksi është vënë te ana praktika e lëndë që realizohet kryesisht në ambientet e vetë IAL ose me vizita në institucionet dhe praktika në terren si praktikë profesionale. Praktika profesionale si lëndë shtrihet në 6 javë dhe shërben jo vetëm për aftësimin praktik dhe profesional në terren dhe në vendin e punës të studentit, po që ai të njihet</p>

	<p>dhe me kulturën e punës dhe kulturën e korporatës në terren, si dhe të gjejë te subjekti pritës një punëdhënës të mundshëm. Praktika është në fazën në fund të studimeve. Kurrikula e programit të studimit garanton mundësinë e transferimit gjatë studimeve ose në përfundim të ciklit të studimeve, krahas mundësisë për punësim pas përfundimit të studimeve. Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta mund të transferohen në studimet e ciklit të parë që referohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve. Shkalla e punësimit është edhe një nga treguesit e cilësisë së programit të studimit. KPT ndjek punësimin e studentëve si një tregues i performancës së programit të studimit në treg. Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve merrret me organizimin e praktikave mësimore, për të krijuar lidhjeje të forta dhe lehtësim për tu futur në tregun e punës për studentët.</p> <p>(Evidence 5: Rregullorja e Programit të Studimit, neni 6; Evidenca 5.3: Plani Mesimor i programit DBËD; Evidenca 5.3 Plani mesimor; Pyetjet gjatë vizitës në institucion; Evidenca 5.5 Syllabuset; Evidenca 7: Strategjia 2021-2025 Kerkimi i tregut; Pyetjet gjatë vizitës në institucion; Evidence 11: Lista e Projekteve, Evidence 11.1: Ëorkshop Online USIA MOVET, Evidence 11.2: MOVET Design Thinking Ëorkshop, Evidence 11.3: USIA roundtable/ USIA)</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës..</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i programit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë	GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që syllabuset e çdo lënde janë në përditësim të vazhdueshëm dhe rishikohen në mënyrë periodike në përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme të vendit. Propozimi për ndryshime në cdo rast vjen i argumentuar nga titullari i lëndës. Ai shqyrtohet në department dhe pastaj dërgohet për miratim në mbledhjen e Rektoratit e më pas në Senat. Syllabuset e çdo lënde hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe miratohen përpara fillimit të semestrit nga drejtuesi i departamentit me ndryshimet përkatëse sipas njohurive të reja dhe informacionit që merret nga pjesëmarrja në evente,

nga tregu i punës.	<p>studimet e tregut, kontaktet me biznesin, mendimi i studenteve, trendet ekonomike, sociale, etj. Sipas rregullores së brendshme dhe akteve nënligore në fuqi duke u bazuar në tregun e punës dhe zhvillimin e teknologjisë, departamenti bën përditësimet e kurrikulës, syllabusve, literaturës, infrastrukturës. Vumë re që përdorëshin metoda të ndryshme vlerësimi si sondazhe e intervista me studentët, gjithashtu edhe me të diplomuar, diskutime me personelin akademik, me bashkëpunëtorët dhe partnerët. Në fund të semestrit realizohet vlerësimi i studentëve. Ai ruan anonimatit e tyre. Gjithashtu realizohen fokus grupe me studentët për të marrë mendimin e tyre lidhur me programin dhe lëndët. Përfundimet e nxjerra e vlerësimet ndihmojnë në përmirësimin e mësimdhënies.</p> <p>(Evidence 7: Strategjia e Zhvillimit 2021- 2025; Evidence 11.3: USIA roundtable; Evidence 15: Formularet e vlerësimit Studente, Evidencë 16: Fokus Grupe, Evidencë 17: Tutoriatet/ këshillim akademik; Evidence 9: Mbledhje e Asamblesë së Personelit; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që syllabuset e çdo lënde hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe miratohen përpara fillimit të semestrit nga drejtuesi i departamentit me ndryshimet përkatëse sipas njohurive të reja dhe informacionit që merret nga pjesëmarrja në evente, studimet e tregut, kontaktet me biznesin, mendimi i studenteve, trendet ekonomike, sociale, etj. Sipas rregullores së brendshme dhe akteve nënligore në fuqi duke u bazuar në tregun e punës dhe zhvillimin e teknologjisë, departamenti bën përditësimet e kurrikulës, syllabusve, literaturës, infrastrukturës. Vumë re që përdorëshin metoda të ndryshme vlerësimi si sondazhe e intervista me studentët, gjithashtu edhe me të diplomuar, diskutime me personelin akademik, me bashkëpunëtorët dhe partnerët. Në fund të semestrit realizohet vlerësimi i studentëve. Ai ruan anonimatit e tyre. Gjithashtu realizohen fokus grupe me studentët për të marrë mendimin e tyre lidhur me programin dhe lëndët. Përfundimet e nxjerra e vlerësimet ndihmojnë në përmirësimin e mësimdhënies.</p> <p>Vumë re që investohet për të siguruar një ambient sa më miqësor me studentët. Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrjen e organeve drejtuese të tij ku kanë të drejtë të përfaqësohen, organizimin e lirë të tyre, dhe shprehjen mendimit të tyre. Një element i rëndësishëm i cilësisë së tërësisë së aktivitetit të institucionit është edhe cilësia e jetës studentore. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentore në nivel njësie kryesore, në nivel institucioni të arsimit të lartë si dhe në nivel kombëtar. Këshillat e studentëve janë organizma të pavarura të studentëve të KPT të cilat nuk mund të organizohen me struktura politike dhe jopolitike jashtë institucionit. Këshilli i studentëve shpreh mendime dhe propozime për probleme me interes të përgjithshëm të Kolegjit, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën</p>




	<p>për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. Këshilli i studentëve zgjidhet çdo 2 vjet nga votat e studentëve, ne perputhje me nje rregullore të vecantë të propozuar nga vetë studentët dhe të miratuar nga Senati Akademik, e cila i bashkëlidhet rregullores së institucionit dhe mbështetet në legjislacionin në fuqi. Në faqen e internetit të KPT vendoset Inormacioni për Këshillin e Studentëve.</p> <p>((Evidence 7: Strategjia e Zhvillimit 2021- 2025; Evidence 3: Statuti KPT, Neni 46; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p> <p>(<a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/keshilli-i-studenteve/">https://kolegjiprofesional.edu.al/keshilli-i-studenteve/</a>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë dhe institucione publike e private.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që programi dhe syllabuset e çdo lënde janë në përditësim të vazhdueshëm dhe rishikohen në mënyrë periodike në përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme të vendit. Propozimi për ndryshime në çdo rast vjen i argumentuar nga titullari i lëndës. Ai shqyrtohet në department dhe pastaj dërgohet për miratim në mbledhjen e Rektoratit e më pas në Senat.</p> <p>Syllabuset e çdo lënde hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe miratohen përpara fillimit të semestrit nga drejtuesi i departamentit me ndryshimet përkatëse sipas njohurive të reja dhe informacionit që merret nga pjesëmarrja në evente, studimet e tregut, kontaktet me biznesin, kompani, rrjete profesionistësh, mendimi i studenteve, trendet ekonomike, sociale, etj. Sipas rregullores së brendshme dhe akteve nënligore në fuqi duke u bazuar në tregun e punës dhe zhvillimin e teknologjisë, departamenti bën përditësimet e kurrikulës, syllabusve, literaturës, infrastrukturës. Programet e studimit dhe syllabuset shikohen në përputhje me kuadër ligjor dhe nënligjor në fuqi, aktet rregullatore të KPT, dinamikat e teknologjisë, nevojat e tregut të punës, përmasa e ndërkombëtarizimit përfshirë vlerësimin e punësimit të studentëve si një nga indikatorët matës të performancës së programit. Vumë re që janë organizuar evente mbi problematikat të ndryshme me stafin, studentë të KPT, kërkues apo partnerë në sektorët e tjerë, institucione publike ose private, me të cilët KPT punon në kuadër të projektit Erasmus + CBHE USIA që financohet nga Bashkimi Europian. Në teresi, për organizimin e programeve të studimit dhe të planeve mësimore, KPT, konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve përkatëse, të organizuar në grupe konsultuese me përfaqësuesit e tregut të punës në nivel departamenti, për tui përgjigjur sa më mirë edhe në kohë kërkesave të kohës. KPT bashkëpunon me emra të njohur të biznesit e industrisë, me institucione shtetërore dhe me ente të pavarura në bashkëpunim me të cilët, përveç të tjerash, realizohet edhe pasurimi/ përmirësimi kurrikulave/programit te studimit.</p> <p>(Evidenca 11.3: USIA Roundtable USIA; Evidenca 16 Fokus grupe; Evidenca 31 Takimi me biznese; Evidenca 5.6 Strategjia e zhvillimit</p>

	të programit të studimit; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se KPT përmes aktivizimit të studentëve në vendimmarrje, anketimit të tyre, trajnimeve të stafit dhe studenteve, si dhe bashkëpunimeve, nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X




### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që format e mësimdhënies dhe transmetimit të njohurive që paraqiten edhe reflektohen edhe në planin mësimor për këtë program janë, leksionet, ushtrimet, laboratorit/praktika dhe praktika profesionale. Leksionet janë një nga format baze për trajtimin e pjesës teorike të lëndëve. Ndjekja e leksioneve nga studentët është e detyrueshme në masën mbi 60% të orëve. Ushtrimet realizojnë shqyrtimin dhe përvetësimin e pjesës teorike, ilustruar me rastet përkatëse. Gjatë ushtrimeve synohet një pjesëmarrje e lartë e studenteve. Pjesëmarrja është e detyruar në masën 50% për ushtrimet për çdo lëndë. Oret laboratorike që janë në formën e Praktikës realizohen në laboratorët e KPT. Për rastin e laboratoreve frekuentimi është i detyruar në masën 75%. Praktika profesionale zhvillohet për një periudhë 6 javore pranë bizneseve, kompanive apo institucioneve me të cilat KPT ka marrëveshje bashkëpunimi. Frekuentimi për rastin e praktikave mësimore është i detyruar në masën 75%. Gjithashtu kemi edhe punimin e diplomës ose provimin e përgjithshëm përfundimtar. Kjo mënyrë vlerësimi përfundimtar, synon kontrollin e dijeve, ose përgatitjen e një teme diplome me një rast studimor. Shpesh zhvillohen konsultime lidhur me lëndët. Një formë tjetër që përdoret është tutoriati, që përkujdeset për mbarëvajtjen e procesit mësimor në tërësi. Tutoriati dhe keshillimi akademik zhvillohen gjatë gjithë vitit akademik, në semestrin e parë dhe të dytë, sipas orarit të shpallur për çdo semester. Në rastin e mbrojtjes së diplomave, për studentet zhvillohen seancat metodologjike brenda fashës orare të tutoriatit. Në seancat metodologjike jepet keshillim për temën e diplomës dhe përgatitjen e saj. Këshillimi akademik nënkupton që çdo pedagog ofron keshillim akademik për lëndën e tij.</p> <p>(Evidenca 5.3 Plani mësimor; Evidenca 17: Tutoriatet; Evidenca 17/1: Rregulloret Tutoriati; Evidenca 4: Rregullorja KPT, Kreu VI, Kreu V: Praktika, Evidenca 5.1: Rregullorja e praktikave profesionale; Evidenca 5: Rregullorja e Programit të Studimit; Evidenca 5.5: Syllabus; Evidenca 22: Laboratorët; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që personeli akademik merr parasysh natyrën specifike të programit të studimit dhe ka përdorur metoda të larmishme të mësimdhënies. Personeli akademik angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta, pa diskriminim, për gjithë studentët në arritjen e qëllimeve të tyre akademike dhe rritjen e tyre profesionale.</p>

<p>alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nisur nga natyra e programit profesional të studimit, një rëndësi e veçantë i është kushtuar punës në laborator/praktikës si dhe ushtimeve duke ndërthurur me leksionet. Për zhvillimin e orëve laboratorike studentët zhvillonin punën në laboratorët e godinës. Në kompjutera instaloheshin programet përkatëse që ju duheshin atyre si edhe plot pajisje të tjera sipas lëndëve. NJSBC-ja harton pyetësorin përkatës për vlerësimin e studentit lidhur me zhvillimin e procesit mësimor rezultatet e të cilit kanë qenë objekt diskutimi dhe përmirësimi konkret në format e mësimdhënies. Gjatë pyetjeve vumë re që në periudhën e pandemisë, kishte rritje përdorimi i materialeve në formë elektronike dhe përdorimit të mesimit online dhe të kombinuar. Për tu ardhur në ndihmë disa lëndëve specifike, leksionet janë zhvilluar në ambient virtual, duke i mundësuar lektorit praninë në klasë në mbështetje të kamerave me rezolucion të lartë për transmetimet në “streaming” ndërsa studentët ndiqnin nga distanca. Në përpjekje për të ruajtur cilësinë e zhvillimit të mesimit dhe angazhimin e studentëve fokus i veçantë iu kushtua zhvillimit dhe monitorimit të mesimit online, përmes platformës TEAMS, duke bërë trajnimin e pedagogëve për përdorimin e saj. Zyra IT e KPT bëri të mundur zhvillimin e mesimit online, komunikimin, takimet, mbledhjet e stafit etj, duke përdorur Microsoft Teams, një platformë interaktive, e unifikuar, pa lejuar përdorim platformash alternative. Platforma mundëson vendosjen e materialeve, krijimin e klasave, takime online, komunikimin me studentët, vlerësimin nëpërmjet detyrave, raporteve, etj. KPT vendosi shpesh udhëzime për mësimin, mirëqenien për studentët, në një seksion të posaçëm “Mësimi online” në faqen e internetit të KPT.</p> <p>(Evidence 25: Mësimi Online - ZYRA IT video tutorial / manual, Evidence 11.5: Thirrje për pjesëmarrje në projekte; <a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/meso-online/">https://kolegjiprofesional.edu.al/meso-online/</a>; Evidenca 6.6: Raporti i cilësisë së studenteve; Evidenca 5.3: Plan i mesimit; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që ka staf akademik të specializuar në fushat përkatëse ku ata janë të angazhuar në mësimdhënie dhe janë kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Staf i akademik përdor mënyra, metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me këtë program studimi, sipas temave dhe profileve. Klasat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një proces efektiv të mësimnxënies. Për realizimin e programit “Database dhe Web Design”, janë laboratorë, klasa, zyra të mjaftueshme, dhe lehtësira të tjera me pajisje elektronike dhe teknologji të informacionit. Staf i akademik përdor metodologji efektive të mësimdhënies bazuar në TIK, me anë të kompjuterave në klasë. Gjithashtu kompjuterat e vendosur në laboratorë përmbajnë të gjithë programet dhe paketat e nevojshme sipas lëndëve specifike të këtij programi studimi. Një formë e ndarjes së përvojës dhe praktikës në mësimdhënie janë edhe orët e hapura. Personeli konsiderohet një aset thelbësor në suksesin e KPT. Organizohen trajnime të stafit nga KPT ose</p>

	<p>me palë të treta. KPT mbështet punimet praktike, artikujt shkencorë projektet që stafi akademik ndjek. Institucioni suporton stafin akademik në rritjen e mëtejshme profesionale për të ndjekur seminare, mbledhje, forume që i aftësojnë ata në rritjen e kapaciteteve, në metoda të mësimdhënies si dhe formimit të tyre akademik. Stafi akademik përfiton nga projektet e KPT që synojnë rritjet e kapaciteteve, kërkimin etj. Ne kuader te projekteve ka aktivitete te perbashketa brenda dhe jashte vendit si psh. Joint Staff training në kuadër të projekti MoVet në Dolo, Venezia, Itali, Athine, Greqi, Design Thinking Workshop në Tiranë, vizitë studimore në Ghent, Belgjikë, në kuadër të projektit Engine, etj. KPT realizon zhvillimin e një ankete, me anë të një pyetësori me qëllim të marrë informacion, qëndrimin e stafit në lidhje me disa elementë të caktuar të procesit akademik, për evidentuar nevojat për ndryshim ose përmirësim. Të dhënat shërbejnë për të marre masa nga organet dhe autoritetet përkatëse.</p> <p>(Evidence 6.4 Anketa e Stafit; Evidence 25 Mësimi Online - ZYRA IT video tutorial / manual; Evidence 6.2 Veprimtari të Stafit në kuadër të projekteve, trajnime; Evidenca 6.5 - NASA Hackathon / konkurse, Evidence 48 – Angazhimi i stafit; Evidence 6.2 Veprimtari të Stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që ka staf akademik të specializuar në fushat përkatëse ku ata janë të angazhuar në mësimdhënie dhe janë kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Stafi akademik përdor mënyra, metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me këtë program studimi, sipas temave dhe profileve. Klasat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një proces efektiv të mësimnxënies. Për realizimin e programit “Database dhe Web Design”, janë labororë, klasa, zyra të mjaftueshme, dhe lehtësira të tjera me pajisje elektronike dhe teknologji të informacionit. Stafi akademik përdor metodologji efektive të mësimdhënies bazuar në TIK, me anë të kompjuterave në klasë. Gjithashtu kompjuterat e vendosur në labororë përmbajnë të gjithë programet dhe paketat e nevojshme sipas lëndëve specifike të këtij programi studimi. Personeli përzgjidhet duke krijuar një kombinim të eksperiencës akademike, punës së tyre, titujve apo gradave shkencore etj. Në programin e studimit stafi është i përbërë nga pedagogë të kualifikuar, me eksperiencë akademike dhe profesionale. Ata përdorin metoda interaktive me studentët gjatë zhvillimit të lëndëve me qëllim bashkëpunimin dhe shtimin e njohurive me koncepte të reja për të nxitur interesin e studentëve.</p> <p>(Evidence 6.4 Anketa e Stafit; RVB, Evidence 48 – Angazhimi i stafit; Evidence 6.2 Veprimtari të Stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në</p>



<p>ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>institucion që institucioni vlerëson dhe përmirëson periodikisht format dhe metodat e mësimdhënies. Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies, përzgjedh personelin akademik dhe garanton shpërndarjen e ngarkesës mësimore në mënyrë që mësimi të zhvillohet nga personeli me kualifikimin e duhur. Miratohen syllabuset, bëhet vlerësimi i mësimdhënies, duke ndjekur zhvillimin e orëve të mësimet nga personeli akademik, ose duke inkurajuar studentët të raportojnë problemet që mund të hasin në mbledhjet e hapura me ta. KPT në kuadër të mbarëvajtjes e cilësisë së programeve realizon edhe sondazhe të diplomuarve. Elementët e programit të studimit, plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese, janë informues dhe plotësojnë të gjithë kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Një nga format e përdorura është përmes Formularit të Vlerësimit të Studentit, i cili është një nga mjetet kryesore që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies dhe për të siguruar një cilësi sa më të lartë në teresinë e procesit mësimor. Ky pyetësor vumë re që zhvillohet para fillimit të provimit final të lëndës. Rezultatet e dala nga pyetësorët përdoren si një kontribut për përmirësimin e mëtejshme. Staf i akademik i programit të studimit "Database dhe Web Design" ofron metoda pedagogjike shumë të larmishme dhe të ndryshueshme përveç mësimdhënies së zakonshme siç janë leksionet dhe seminarat, studentët marrin pjesë në punë laboratorike, dorëzojnë detyra ose prezantime. Vumë re që ka një larmishmëri të metodologjisë së mësimdhënies, dhe metoda mjaft ndërvepruese. Gjatë leksioneve dhe seminareve, studentët vumë re që janë të lirë për pyetje dhe komente. Nga ana tjetër, prezantimet e studentëve janë të organizuara në formën e diskutimeve duke i bërë klasat më tërheqëse dhe ndërvepruese. Staf i angazhohet edhe në molilitete Erasmus + ose konferenca nga ky përveç të tjerave mund të merren dhe përvehtësohen edhe mënyra të shumëllojshme mësimdhënie, përmes shembujve të praktikave të mira. Një metodë ndihmëse online në mësimdhënie dhe mësimnxënie mund të përmendim platformën Microsoft Teams.</p> <p>(Evidence 15: Formularët e vlerësimit Studente, Evidencë 16: Fokus Grupe, Evidencë 17: Tutoriatet/ këshillim; Evidenca 13.2: Raporti NJSBC; Evidenca 12: Sondazhi alumni; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që institucioni vlerëson dhe përmirëson periodikisht format dhe metodat e mësimdhënies. Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies, përzgjedh personelin akademik dhe garanton shpërndarjen e ngarkesës mësimore në mënyrë që mësimi të zhvillohet nga personeli me kualifikimin e duhur. Miratohen syllabuset, bëhet vlerësimi i mësimdhënies. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik kryhet përmes: praktikës së leksioneve të hapura, vlerësimit të studentëve që kryhet në fund të semestrit, vlerësimin e përgjegjësive të departamentit ose grupit ad/hoc nga rektori, për raste të</p>

<p>eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>vecanta, rezultateve të raporteve të NJSBC. Gjithashtu nga pyetjet në institucion vumë re që për stafin e ri të marrë, kishte herë pas here orë monitorimi gjatë leksioneve nga departamenti, me njoftim paraprak të tyre, duke ruajtur pozicionin dhe lirinë e pedagogëve por edhe për të kontrolluar cilësinë. Një nga format e përdorura është përmes Formularit të Vlerësimit të Studentit, i cili është një nga mjetet kryesore që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies dhe për të siguruar një cilesi sa më të lartë në teresinë e procesit mesimor. Ky pyetësor vumë re që zhvillohet para fillimit të provimit final të lëndës. Rezultatet e dala nga pyetësorët përdoren si një kontribut për përmirësimin të mëtejshme. KPT realizon edhe sondazhe të të diplomuarve. Stafi akademik i programit të studimit “Database dhe Web Design” ofron metoda pedagogjike shumë të larmishme dhe të ndryshueshme përveç mësimdhënies së zakonshme siç janë leksionet dhe seminarët, studentët marrin pjesë në punë laboratorike, dorëzojnë detyra ose prezantime. Vumë re që ka një larmishmëri të metodologjisë së mësimdhënies, dhe metoda mjaft ndërvepruese. Gjatë leksioneve dhe seminareve, studentët vumë re që janë të lirë për pyetje dhe komente. Nga ana tjetër, prezantimet e studentëve janë të organizuara në formën e diskutimeve duke i bërë klasat më tërheqëse dhe ndërvepruese. Stafi angazhohet edhe në molilitete Erasmus + ose konferenca nga ky përveç të tjerave mund të merren dhe përvehtësohen edhe mënyra të shumëllojshme mësimdhënie, përmes shembujve të praktikave të mira. Një metodë ndihmëse online në mësimdhënie dhe mësimnxënie mund të përmendim platformën Microsoft Teams. Vumë re që KPT i ka kushtuar vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë i cili garanton cilësinë e veprimtarisë së institucionit. Kjo kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin, aktet e tjera rregullatore, vizionin, misionin dhe objektivat e institucionit. NJSBC-ja është njësi autonome operative e përhershme në strukturën organizative të KPT që vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, formuese e trajnuese, si dhe të veprimtarisë administrative e financiare të KPT si dhe propozon ndryshime për përmirësimin e nevojshme. Mënyra e funksionimit të NJSBC-së rregullohet me rregullore të veçantë dhe nga kjo njësi nxirren cdo vit raporte lidhur me plotësimin e standardeve të cilësisë, (Evidenca 13 Vendimi i ngritjes së NJSBC; Evidence 13.1, Rregullore NJSBC, Evidence 13.2 Raporti NJSBC; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se KPT zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale të zhvilluara nga personel akademik kompetent.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

**Standardi III.2**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale përcaktohen në Rregulloren e KPT. Në këtë rregullore janë parashikuar elementet e procesit të vlerësimit, menyra e kontrollit dhe e vlerësimit të dijeve, frekuentimi i procesit mesimor, provimet. Studentet njihen me rregulloren si një e drejtë dhe detyrim i tyre. Informacionet ishin të publikuara dhe studentët mund t'i aksesonin ato në çdo moment. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit vlerësohet gjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të: provimit përfundimtar (60%), kolokiume/ projekte/ laboratore (30%), aktivizimi në ushtrime (10%). Kombinimi dhe pesha e këtyre komponentëve mund të ndryshohet në lëndë të caktuara, për t'iu përshtatur më mirë natyrës së lëndës. Propozimi bëhet nga pedagogu i lëndës dhe përcaktohet në syllabusin e saj si edhe me miratim të përgjegjës të Departamentit. Për kriteret dhe mënyrën e testimit të njohurive, studentët e rinj njihen që gjatë javës së orientimit si dhe nga pedagogët e lëndës. Frekuentimi i procesit mesimor për leksione dhe ushtrime është i detyruar 60%. Për labororet pjesëmarrja është e detyrueshme 80%. Përsa i takon provimit, tezat e provimit formulohen nga titullari i lëndës dhe aprovohen nga Përgjegjësi i Departamentit. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, dhe pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Kur ka shlyer detyrimet e pjesëmarrjes në atë lëndë dhe detyrimet financiare ndaj institucionit, studenti fiton të drejtën për të hyrë në provimin përfundimtar të një lënde. Listën emërore e provimit plotësohet nga Sekretaria Mësimore, nënshkruhet dhe i vihet në dispozicion Pedagogut para hyrjes në provim. Vlerësimi i studentit bëhet me pikë dhe shënohet në fletën e provimit. Vlerësimet mbyllet brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të tyre. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi sqarohet me pedagogun e lëndës, mund t'i drejtohet Përgjegjës të Departamentit. Përmes një komisioni shqyrtohet kërkesa për rivlerësimin. Studentët vlerësohen në provim nga titullari i lëndës dhe nga asistenti i tij, nëse ka të tillë, të cilët kanë zhvilluar lëndën. (Evidenca 4: Rregullorja KPT, nenet 42-50; Evidencë 5; Rregullorja e Programit të Studimit; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive,</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale përcaktohen në Rregulloren e KPT. Në këtë rregullore janë parashikuar elementet e procesit të vlerësimit, menyra e kontrollit dhe e vlerësimit të dijeve,</p>

dijeve dhe aftësiwe profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.

frekuentimi i procesit mesimor, provimet. Studentet njihen me rregulloren si një e drejtë dhe detyrim i tyre. Informacionet ishin të publikuara dhe studentët mund t'i aksesonin ato në çdo moment. Studentët pajisen me Manualin e Studentit, Manualin Classter për studentët, me rregulloren përkatëse të programi të Studimit që përmbajnë informacion përfshirë këtu edhe metodat e vlerësimit të njohurive të tyre. Gjithashtu ky informacion gjendet në Classter si dhe fizikisht në ambientet e shkollës. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit vlerësohet gjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të: provimit përfundimtar (60%), kolokiume/ projekte/ laboratore (30%), aktivizimi në ushtrime (10%). Kombinimi dhe pesha e këtyre komponentëve mund të ndryshohet në lëndë të caktuara, për t'iu përshtatur më mirë natyrës së lëndës. Propozimi bëhet nga pedagogu i lëndës dhe përcaktohet në syllabusin e saj si edhe me miratim të përgjegjësit të Departamentit. Për kriteret dhe mënyrën e testimit të njohurive, studentët e rinj njihen që gjatë javës së orientimit si dhe nga pedagogët e lëndës. Frekuentimi i procesit mësimor për leksione dhe ushtrime është i detyruar 60%. Për labororet pjesëmarrja është e detyrueshme 80%. Përsa i takon provimit, tezat e provimit formulohen nga titullari i lëndës dhe aprovohen nga Përgjegjësi i Departamentit. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, dhe pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Kur ka shlyer detyrimet e pjesëmarrjes në atë lëndë dhe detyrimet financiare ndaj institucionit, studenti fiton të drejtën për të hyrë në provimin përfundimtar të një lënde. Listën emërore e provimit plotësohet nga Sekretaria Mësimore, nënshkruhet dhe i vihet në dispozicion Pedagogut para hyrjes në provim. Vlerësimi i studentit bëhet me pikë dhe shënohet në fletën e provimit. Vlerësimet mbyllen brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të tyre. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi sqarohet me pedagogun e lëndës, mund t'i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit. Përmes një komisioni shqyrtohet kërkesa për rivlerësimin. Studentët vlerësohen në provim nga titullari i lëndës dhe nga asistenti i tij, nëse ka të tillë, të cilët kanë zhvilluar lëndën. (Evidence 5.5: Syllabus; Evidence 27: Manualin e Studentit, Evidence 28: Manuali Classter; Evidence 30: Java e Orientimit; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)

**Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.

GVJ konstaton se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit vlerësohet gjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të: provimit përfundimtar (60%), kolokiume/ projekte/ laboratore (30%), aktivizimi në ushtrime (10%). Kombinimi dhe pesha e këtyre komponentëve mund të ndryshohet në lëndë të caktuara, për t'iu përshtatur më mirë natyrës së lëndës. Propozimi bëhet nga pedagogu i lëndës dhe përcaktohet në syllabusin e saj si edhe me miratim të përgjegjësit të Departamentit. Për kriteret dhe mënyrën e testimit të njohurive, studentët e rinj njihen që gjatë javës së orientimit si dhe nga pedagogët e lëndës. Lidhur me praktikën


	<p>profesionale, në përfundim të praktikës, studenti përgatit një raport përfundimtar në formë relacioni për punën që është bërë, informacionet që ka marrë në subjektin pritis që mbrohet para një komisioni. Vumë re që përmes kësaj mënyre merret një vlerësim sa më objektiv i studentit dhe kjo nxit studentët që të mësojnë në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studenteve. Në rastin e provimeve të bartura, studenti i nënshtrohet vlerësimit mbi bazën e programit të lëndës të vitit akademik aktual. Nëse numri i krediteve ka ndryshuar studenti përfiton kreditet që lënda ka në momentin kur merr provimin. Vlerësimet mbyllet brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të tyre. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi sqarohet me pedagogun e lëndës, mund t'i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit. Përmes një komisioni shqyrtohet kërkesa për rivlerësimin. Studentët vlerësohen në provim nga titullari i lëndës dhe nga asistenti i tij, nëse ka të tillë, të cilët kanë zhvilluar lëndën. (Evidence 5: Rregullorja e Programit të Studimit, neni 8; Evidence 4: Rregullorja KPT, Evidence 27: Manualin e Studentit; Evidence 5.1: Rregullorja e praktikave profesionale; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet duke u bazuar në rregulloren e KPT, rregulloren e programit të studimit dhe në mënyrën e vlerësimit të lëndëve të praqitur në syllabuse.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit vlerësohet gjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të: provimit përfundimtar (60%), kolokiume/projekte/laboratore (30%), aktivizimi në ushtrime (10%). Kombinimi dhe pesha e këtyre komponentëve mund të ndryshohet në lëndë të caktuara, për t'iu përshtatur më mirë natyrës së lëndës. Propozimi bëhet nga pedagogu i lëndës dhe përcaktohet në syllabusin e saj si edhe me miratim të përgjegjësit të Departamentit. Për kriteret dhe mënyrën e testimit të njohurive, studentët e rinj njihen që gjatë</p>

	<p>javës së orientimit si dhe nga pedagogët e lëndës. Lidhur me praktikën profesionale, në përfundim të praktikës, studenti përgatit një raport përfundimtar në formë relacioni për punën që është bërë, informacionet që ka marrë në subjektin pritis që mbrohet para një komisioni. Vumë re që përmes kësaj mënyre merret një vlerësim sa më objektiv i studentit dhe kjo nxit studentët që të mësojnë në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studenteve. Në rastin e provimeve të bartura, studenti i nënshtrohet vlerësimit mbi bazën e programit të lëndës të vitit akademik aktual. Nëse numri i krediteve ka ndryshuar studenti përfiton kreditet që lënda ka në momentin kur merr provimin. Vlerësimet mbyllen brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të tyre. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi sqarohet me pedagogun e lëndës, mund t'i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit. Përmes një komisioni shqyrtohet kërkesa për rivlerësimin. Studentët vlerësohen në provim nga titullari i lëndës dhe nga asistenti i tij, nëse ka të tillë, të cilët kanë zhvilluar lëndën. (Evidence 5: Rregullorja e Programit të Studimit, neni 8; Evidence 4: Rregullorja KPT; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ konstaton se provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studenteve. Në rastin e provimeve të bartura, studenti i nënshtrohet vlerësimit mbi bazën e programit të lëndës të vitit akademik aktual. Nëse numri i krediteve ka ndryshuar studenti përfiton kreditet që lënda ka në momentin kur merr provimin. Vlerësimet mbyllen brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të tyre. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi sqarohet me pedagogun e lëndës, mund t'i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit. Përmes një komisioni shqyrtohet kërkesa për rivlerësimin. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Gjatë mësimdhënies online dhe pandemisë vumë re që ishte përdorur teknologjia. Fokus i veçantë ishte kushtuar zhvillimit të mësimin online dhe monitorimit, nëpërmjet platformës TEAMS. Platforma Microsoft Teams u përdor për zhvillimin e mësimin online komunikim, takime të stafit online, dhënien e detyrave online dhe vlerësimin e tyre, raporteve etj. Zyra IT vumë re që kishte bërë të mundur përdorimin e kësaj platforme. dhe suport për aksesin në platformë për stafin akademik dhe studentet në raste</p>




	vështirësish. (Evidenca 4 Rregullorja KPT; Evidence 25 Mësimi Online - ZYRA IT video tutorial / manual; Evidenca 5: Rregullorja e Programit të Studimit; Evidenca 27: Manuali i studentit; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studenteve. Në rastin e provimeve të bartura, studenti i nënshtrohet vlerësimit mbi bazën e programit të lëndës të vitit akademik aktual. Nëse numri i krediteve ka ndryshuar studenti përfiton kreditet që lënda ka në momentin kur merr provimin. Vlerësimet mbyllen brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të tyre. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi sqarohet me pedagogun e lëndës, mund t'i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit. Përmes një komisioni shqyrtohet kërkesa për rivlerësimin. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të: provimit përfundimtar (60%), kolokiume/projekte/laboratore (30%), aktivizimi në ushtrime (10%). Kombinimi dhe pesha e këtyre komponentëve mund të ndryshohet në lëndë të caktuara, për t'iu përshtatur më mirë natyrës së lëndës. Propozimi bëhet nga pedagogu i lëndës dhe përcaktohet ne syllabusin e saj si edhe me miratim të përgjegjësit të Departamentit. (Evidence 4: Rregullorja KPT, Evidence 5: Rregullorja e Programit të Studimit; Evidence 5.5: Syllabus; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).
<b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	GVJ konstaton se nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të: provimit përfundimtar (60%), kolokiume/projekte/laboratore (30%), aktivizimi në ushtrime (10%). Kombinimi dhe pesha e këtyre komponentëve mund të ndryshohet në lëndë të caktuara, për t'iu përshtatur më mirë natyrës së lëndës. Propozimi bëhet nga pedagogu i lëndës dhe përcaktohet ne syllabusin e saj si edhe me miratim të përgjegjësit të Departamentit. Për kriteret dhe mënyrën e testimit të njohurive, studentët e rinj njihen që gjatë javës së orientimit si dhe nga pedagogët e lëndës. Lidhur me praktikën profesionale, në përfundim të praktikës, studenti përgatit një raport përfundimtar ne forme relacioni për punën që është bërë, informacionet që ka marrë në subjektin pritës që mbrohet para një komisioni. Vumë re që përmes kësaj mënyre merret një vlerësim sa më objektiv i studentit duke pasur mundësi për këshilla gjatë gjithë vitit dhe kjo nxit studentët që të mësojnë në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa

	<p>pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studenteve. Testimet kanë komente përkatëse sipas gabimeve. Stafi akademik ofron mbështetje për këshillime dhe mundësi për përmirësime rezultatesh në të ardhmen si dhe realizon seanca sqaruese, pasi rezultatet të jenë bërë publike nga njësia e sekretarisë mësimore. (Evidence 4: Rregullorja KPT, Evidence 5: Rregullorja e Programit të Studimit; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësité përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ konstaton se provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studenteve. Gjatë procesit të provimeve mbikëqyren studentët duke monitoruar procesin e testeve. Monitorimi garanton një proces cilësor, të qetë dhe të rregullt duke shmangur kopjimin dhe prishjen e rregullit.</p> <p>Stafi akademik vlerëson edhe detyrat, relacionet e laboratorëve dhe të praktikës së studentëve duke evidentuar dhe ndaluar ripërdorimin e informacionit dhe plagjiaturat. Vumë re gjatë pyetjeve që gjatë procesit të provimit studentët lënë në në disa banka përpara çantat, materialet e leksioneve, ushtrimeve, librat, dhe cdo material tjetër që kanë që nuk lejohet. Nuk lejohet përdorimi i telefonat, dhe ata duhet të fiken. Plagjiatura e provuar në paraqitjen e detyrës së kursit, punës së laboratorit dhe të diplomës ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare në disiplinën ose veprimtarinë formuese përkatëse, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese.</p> <p>Kopjimi si edhe cdo komunikim me të tjerët gjatë orës së provimit dënohet me ndërprerjen e provimit për studentin që shkel rregullin, dhe studenti vlerësohet me notën 4 (katër) në lëndën në fjalë.</p> <p>Në rast përsëritjeje të plagjiaturës ose kopjimit, emri i studentit shënohet në regjistrin e Këshillit të Etikës dhe studenti paralajmërohet për përjashtim nga Institucioni. Herën e tretë të përsëritjes së kopjimit ose të plagjiaturës studenti përjashtohet nga Institucioni dhe humbet cdo të drejtë financiare që mund t'i takojë në bazë të kontratës së lidhur me KPT. KPT ka miratuar Kodin e Etikës dhe të Integritetit. Kodi i etikës përcakton se rregullave për sjelljen e personelit akademik dhe joakademik ka për qëllim të vendosë rregulla të sjelljes edhe për studentët sipas standarteve të vendosura. Një nga detyrimet e studenteve është edhe të mos kopjojnë në provime dhe të mos kopjojnë informacion të publikuar pa përcaktimin e burimit.</p> <p>(Evidence 47: Kodi i Etikës dhe Integritetit; Evidence 4: Rregullorja KPT, neni 50; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>







<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të: provimit përfundimtar (60%), kolokiume/ projekte/ labore (30%), aktivizimi në ushtrime (10%). Kombinimi dhe pesha e këtyre komponentëve mund të ndryshohet në lëndë të caktuara, për t'iu përshtatur më mirë natyrës së lëndës. Propozimi bëhet nga pedagogu i lëndës dhe përcaktohet në syllabusin e saj si edhe me miratim të përgjegjësit të Departamentit. Për kriteret dhe mënyrën e testimit të njohurive, studentët e rinj njihen që gjatë javës së orientimit si dhe nga pedagogët e lëndës. Lidhur me praktikën profesionale, në përfundim të praktikës, studenti përgatit një raport përfundimtar në formë relacioni për punën që është bërë, informacionet që ka marrë në subjektin pritis që mbrohet para një komisioni. Vumë re që përmes kësaj mënyre merret një vlerësim sa më objektiv i studentit duke pasur mundësi për këshilla gjatë gjithë vitit dhe kjo nxit studentët që të mësojnë në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studenteve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Testimet kanë komente përkatëse sipas gabimeve. Staf i akademik ofron mbështetje për këshillime dhe mundësi për përmirësime rezultatesh në të ardhmen si dhe realizon seanca sqaruese, pasi rezultatet të jenë bërë publike nga njësia e sekretarisë mësimore. Vumë re që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën e studentëve. Kur student nuk merr pjesë në provimin përfundimtar të lëndës, Sekretaria Mësimore në procesverbalin përfundimtar të lëndës bën shënimin "Nuk u paraqit". (Evidence 5: Rregullorja e Programit të Studimit, neni 8; Evidenca 4 Rregullorja KPT, neni 42-50; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studenteve. Në rastin e provimeve të bartura, studenti i nënshtrohet vlerësimit mbi bazën e programit të lëndës të vitit akademik aktual. Nëse numri i krediteve ka ndryshuar studenti përfiton kreditet që lënda ka në momentin kur merr provimin. Vlerësimet mbyllet brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të provimeve dhe dorëzohen. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi sqarohet me pedagogun e lëndës, mund t'i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit me një kërkesë me shkrim, ku parashtrohet arsyet mbi të cilat ai bazon</p>




	<p>ankesën. Me marrjen e ankeses, Pergjegjesi i Departamentit, ose Rektori per rastin kur Pergjegjesi i Departamentit qellon te jete pedagogu i lendes, ngre nje komision te perbere nga tre pedagoge, ku ben pjese edhe pedagogu i lendes. Përmes ketij komisioni shqyrtohet kërkesa për rivlerësimin e komponentit te ankimuar.</p> <p>(Evidence 5: Rregullorja e Programit të Studimit, neni 8, pika 6; Evidenca 4: Rregullorja KPT, neni 49; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>GVJ konstaton se vlerësimet mbyllen brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të provimeve dhe dorezohen. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi sqarohet me pedagogun e lëndës, mund t'i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit me një kërkesë me shkrim, ku parashtrohet arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankeses, Pergjegjesi i Departamentit, ose Rektori per rastin kur Pergjegjesi i Departamentit qellon te jete pedagogu i lendes, ngre nje komision te perbere nga tre pedagoge, ku ben pjese edhe pedagogu i lendes. Përmes ketij komisioni shqyrtohet kërkesa për rivlerësimin e komponentit te ankimuar. Vumë re që vendimi që merret nga komisioni, me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar si vlerësim. Vlerësimi mund të jetë i njëjti, më shumë ose më pak se nota e vlerësimit fillestar.</p> <p>(Evidence 5: Rregullorja e Programit të Studimit; Evidenca 4: Rregullorja KPT; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstatoi se KPT siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p>X</p>

<p><b>Standardi III.4</b></p> <p><b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi profesional i studimeve i ofron studentëve njohuri bazë teorike, praktike dhe profesionale. Përfitimi i këtyre aftësive është në fokus të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke punuar me studentët raste studimi, detyra në klasë, detyra në shtëpi ose detyra kursi në mënyrë individuale dhe në grup. Theks i veçantë vihet tek praktika e vazhdueshme në labororet e ofruara nga shkolla si edhe praktikës që zhvillohet në kompani në semestrin e fundit, aktiviteti i të cilave përputhet me natyrën e programit të</p>

	<p>studimit. Praktika në laboratorët e Programit të studimit “Database dhe Web Design” dhe pranë kompanive i jep mundësi studentit të avancojë njohuritë dhe aftësitë profesionale dhe të zhvillojë aftësitë individuale. KPT Hub ishte klubi i inovacionit i cili bashkon studentet me pedagoget për projekte në fushën e teknologjisë. Vumë re që aty studentet vënë në jetë idetë e tyre për ndërtimin e një pajisjeje, sistemi, programim apo të gjitha bashkë. Për të përgatitur më mirë studentët për tregun shqiptar dhe atë të huaj KPT organizon vazhdimisht trajnime me palë të treta në lidhje me dosjen e karrierës, mobilitetin, etj.</p> <p>(Evidence 5: Rregullorja e Programit të Studimit, Evidence 5.6: Strategjia e zhvillimit të programit; Evidenca 22: Laboratorët; Evidenca 20: KPT HUB; Evidenca 26: Trajnimi Polytech EU Masterclass; Evidenca 21: Trajnime student; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi profesional i studimeve i ofron studentëve njohuri bazë teorike, praktike dhe profesionale. Përfitimi i këtyre aftësive është në fokus të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke punuar me studentët raste studimi, detyra në klasë, detyra në shtëpi ose detyra kursi në mënyrë individuale dhe në grup. Theks i veçantë vihet tek praktika e vazhdueshme në laboratorët e ofruara nga shkolla si edhe praktikës që zhvillohet në kompani në semestrin e fundit, aktiviteti i të cilave përputhet me natyrën e programit të studimit. Praktika në laboratorët e Programit të studimit “Database dhe Web Design” dhe pranë kompanive i jep mundësi studentit të avancojë njohuritë dhe aftësitë profesionale dhe të zhvillojë aftësitë individuale. Lëndët e programit të parashikuara në kurrikula lidhen ngushtë me profesionin dhe bëjnë diferencën midis profileve të cilat ndihmojnë studentët për tu aftësuar në fushën specifike të aplikuar.</p> <p>Studenti pajiset me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme teorike dhe praktike për zgjidhjen e problemeve të programimit dhe për t’u përshtatur zhvillimit të vazhdueshëm të teknologjisë. Ata marrin aftësi teknike dhe praktike për faqe internet, sistemet, përpunim imazhi, data base, etj. Vumë re programin Connect IT, që bën të mundur kontributin e drejtpërdrejtë të studentëve në dixhitalizimin e bizneseve. Studentët me prirje dhe pasion IT, programim dhe Database e Web design mund të bëhen pjesë e këtij projekti me sukses të aprovuar në shtete Europiane për të zgjidhur sfidat e ndryshme që biznesi shqiptar has në përditshmërinë e tij. KPT Hub ishte klubi i inovacionit i cili bashkon studentet me pedagoget për projekte në fushën e teknologjisë. Vumë re që aty studentet vënë në jetë idetë e tyre për ndërtimin e një pajisjeje, sistemi, programim apo të gjitha bashkë. Për të përgatitur më mirë studentët për tregun shqiptar dhe atë të huaj KPT organizon vazhdimisht trajnime me palë të treta në lidhje me dosjen e karrierës, mobilitetin, etj.</p> <p>(Evidence 5.3: Plani mësimor; Evidence 5.3: Plani mësimor;</p>




	Evidenca 39: Connect IT; Evidenca 20: KPT HUB; Evidenca 21 Trajnime student; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga takimet me studentet në institucion, konstatojmë se në përfundim të leksioneve, secili pedagog zhvillon një seancë përmbyllëse, si një diskutim tërësor dhe përsëritje e të gjithë temave të realizuara gjatë lëndës. Studentët kanë mundësinë të bëjnë pyetje në lidhje me paqartësi të ndryshme që kanë për lëndën, si edhe pedagogu orienton drejt pjesëve më të rëndësishme për të përsëritur për provime, si dhe shikohen elemente që mund të permiresohen te lenda. Krahas orëve mësimore, lektorët vënë në dispozicioni orarin e pritjes ku i mundëson studentit takime individuale ose në grup për konsultime. Në fund të çdo semestri, rishikohet kompetencat dhe aftësitë që studenti ka përfituar gjatë lëndëve specifike nga pedagogët dhe titullaret e lëndës dhe diskutohen nqs do të bëhen ndryshime.  (Evidenca 17.1: Rregullore tutoriati; Evidenca 4: Rregullorja KPT; Evidenca 5.2: Raporti i praktikave; Evidenca 17: Tutoriatet keshillimi akademik; Evidenca 36: Raporti vjetor; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Nga kontrolli i syllabuseve të lëndëve GVJ konstatohet që pedagogët mbështeten në literature shqip dhe anglisht për ti ofruar studentëve një program lënde sa më të detajuar dhe inovativ. Nga kontaktet me studentet konstatohet që gjatë zbatimit të syllabusit, pedagogët analizojnë pikat e forta dhe të dobëta të programit, si edhe nivelin e ndjekshmërisë të studentët. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve. Për realizimin e programit profesional të studimit, lëndët si Database, Web design, ëeb developing etj. pra lëndët me karakter teknik, zhvillohen pjesërisht ose plotësisht në laboratore për ti dhënë studentit njohuritë praktike. KPT ka lidhur disa marrëveshje me institucione shpirtare dhe te huaja. Institucioni bashkëpunon me IAL-të me synim ndërtimin e projekteve dhe aktivitetete në fushat akademike me interes të përbashkët, shkëmbim dhe zhvillimin profesional të stafit akademik dhe administrativ, shkëmbim studentësh, bashkëpunim në kërkim, botime etj. Marreveshjet me universitete të huaja krijojnë mundësi edhe për mobilitetin e studentëve dhe te stafit akademik. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash dhe synon të gërshetojë njohuritë teorike me aftësitë praktike, të cilat realizohen në laboratorët e KPT. Puna në laborator realizohet në grupe të vogla 10-12 studentë, ku çdo student ka postin e tij të dedikuar të punës. Për tema apo çështje të caktuara, studentët organizohen të punojnë në skuadra me grupe me 2-3 anëtarë. Vumë re që në syllabusin e çdo lënde jepet nje përmbledhje dhe rezultatet e te nxenit, e cila është ne formen e nje abstrakti qe jep idene e pergjithshme te kursit. Objektivat e lendes jane synimet qe lenda tenton te arrije ne përfundim te saj, te




	<p>cilat ndahen ne njohuri, aftesi dhe kompetenca qe studenti priret ti pervesoje ne perfundim te lendes. KPT ka marrëveshje bashkëpunimi me disa IAL brenda vendit si: Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Universiteti European i Tiranës, gjithashtu ka marreveshje me “Kolegjin universitar Instituti kanadez i teknologjise”. KPT ka edhe bashkëpunime në nivel rajonal në Europë. KPT ka lidhur memorandumimin e bashkëpunimit me Universitetin e Thesalisë, The University of Thesali, School of lifelong learning, Greqi.</p> <p>(Evidenca 5.5 Syllabus; Evidence 10: Lista e marrëveshjeve IAL Marreveshjet; Evidenca 11.3: USIA roundtable/ USIA; Evidence 10.2: MoU_Uth; Evidence 11: Lista e Projekteve; Evidence 22: Laboratorët; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se Departamenti zhvillon ore të hapura mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë, ndarjen e ekspertizave te ndryshme dhe ecurine e trajnimeve dhe projekteve ku pjesetaret e stafit kanë qenë pjesë. Për të përgatitur më mirë studentët për tregun shqiptar dhe atë të huaj KPT organizon vazhdimisht trajnime me palë të treta në lidhje me dosjen e karrieres, mobilitetin, etj. Studenti prezantohet me fusha të ndryshme të industrisë apo teknologjisë. Organizohen takime të ndryshme dhe vizita në kompani, industri apo biznese. KPT angazhon studentët si pjesë e ëorkshopeve në kuadër të projekteve të ndryshme. Një nga këto është dhe Ëorkshopi Design Thinking për përgatitjen e strategjisë së ndërkombëtarizimit në institucion.</p> <p>(Evidence 30: Takime me biznese; Evidence 49: Prezantimet në Departament; Evidenca 11.2 MOVET Desing thinking ëorkshop; Evidenca 11.3: USIA Roundtable USIA; Evidenca 16: Fokus grupe; Evidenca 48: Angazhime te stafit; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se programi i studimit DBËD, i ofruar nga nga Departamenti i Teknologjise se informacionit në KPT, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, kurrikulat dhe syllabuset jane sipas kërkesave të kohës dhe teknologjive më të fundit, duke mundësuar zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek studentët.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi III.5**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton	GVJ konstatoi se detyrimet përmbyllëse që ka studenti janë të

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë


E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 53

<p>procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.</p>	<p>paraqitura në disa rregullore. Ka përcaktime në Rregulloren e KPT, Rregulloren e programit të studimit, Rregulloren e praktikave. Studentët njihen paraprakisht me detyrimet nëpërmjet takimeve orientuese, email-eve, njoftimeve etj. Rregulloret janë publike dhe njoftimet janë të dukshme dhe të aksesueshme në mënyrë që studenti të përgatitet. Ai mund të ketë punët e laboratorit për të dorëzuar, mbrojtjen e praktikës profesionale, ku në këto raste ka plotësime formularësh, dorëzohet një relacion në ëord, ose prezantim në poëer point, etj. Detyrimet si shtrirje kohore janë javët e fundit cdo semestër, përpara sezonit të provimeve. Praktikrat profesionale vlerësohen me nota, njëlloj si detyrimet e tjera. Studenti që ka shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit si dhe detyrimet financiare ndaj KPT, fiton të drejtën e mbrojtjes së diplomës. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentit. Mbrojtja bëhet përmes paraqitjes së një punimi diplome ose dhënies së një Provimi të Përgjithshëm Përfundimtar sipas vendimit të Rektorit për cdo vit akademik. Për studentet që diplomohen me temë diplome, student nuk mund të mbroje temën e diplomes pa marrë miratimin e udheheqesit si garantues të cilesisë së saj akademike. Në cdo rast student nuk mund ta mbroje temën e diplomes pa shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit. Provimi i përgjithshëm përfundimtar si rregull zhvillohet me shkrim. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj KPT dhe ka mbrojtur punimin e diplomës, pajiset nga institucioni brenda 6 muajsh me diplomën përkatëse të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve në KPT.</p> <p>(Evidence 4: Rregullorja KPT, kreu IX; Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët njihen paraprakisht me detyrimet nëpërmjet takimeve orientuese, email-eve, njoftimeve etj. Rregulloret janë publike dhe njoftimet janë të dukshme dhe të aksesueshme në mënyrë që studenti të përgatitet. Ai mund të ketë punët e laboratorit për të dorëzuar, mbrojtjen e praktikës profesionale, ku në këto raste ka plotësime formularësh, dorëzohet një relacion në ëord, ose prezantim në poëer point, etj. Detyrimet si shtrirje kohore janë javët e fundit cdo semestër, përpara sezonit të provimeve. Praktikrat profesionale vlerësohen me nota, njëlloj si detyrimet e tjera dhe procesi ndiqet dhe monitorohet nga Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentit në bashkëpunim me departamentin. Studenti që ka shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit si dhe detyrimet financiare ndaj KPT, fiton të drejtën e mbrojtjes së diplomës. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentit. Mbrojtja bëhet përmes paraqitjes së një punimi diplome ose dhënies së një Provimi të Përgjithshëm Përfundimtar sipas vendimit të Rektorit për cdo vit akademik. Për studentët që diplomohen me temë diplome,</p>





	<p>nuk mund të mbrohet tema e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqesit si garantues të cilësisë së saj akademike.</p> <p>Mbështetja gjatë organizimit të praktikave është nëpërmjet Stafit Akademik, Sekretarisë Mësimore dhe Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentit të cilët të gjithë ju vijnë në ndihmë studentëve për tu njoftuar dhe për të ndihmuar me udhëzime, instruksione apo me materialet që mund të duhen për të mbyllur detyrimet përmbyllëse si për laboratorët ashtu edhe praktiken profesionale.</p> <p>(Evidence 5.1: Rregullorja e praktikave profesionale; Evidence 5.2: Raporti i praktikave; Evidence 4: Rregullorja KPT, kreu IX; Evidenca 5: Rregullorja e programit të studimit; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Diplomimi bëhet me provim formimi, projekt formimi ose përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për një temë të caktuar studimi. Gjatë përgatitjes së procesit të zhvillimit të provimit përfundimtar Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, bazohet në rregulloren e programit të studimit “Database dhe Web Design”, shqyrtojnë programin, planin mësimor dhe syllabuset më të përshtatshme sipas lendeve karakterizuese dhe baze të programit. Evidentohen kategoritë e lëndëve bazë që duhet të përmbajë provimi përfundimtar, të cilat i përshtatet më shumë dhe karakterizojnë profilin dhe fushën e programit të studimit. Në bashkëpunim me stafin akademik, i cili është përgjegjës për dhenien e këtyre lëndëve hartohet dhe miratohet përmbajtja e pyetjeve të provimit. Vëmë re nga pyetjet gjatë vizitës në institucion që Provimi përfundimtar ndërtohej nga shtatë pjesë me grup pyetje, nga një grup për secilën nga shtatë lëndë të programit që zgjidhen. Gjatë hartimit të tezës së provimit pikët e caktuara të pyetjeve përcaktojnë edhe peshën e secilës nga lëndet si përqindje krahasuar me totalin. Provimi zhvillohet me shkrim dhe korrigjohet nga komisioni i provimit i miratuar nga Rektori i KPT. Brenda pesë ditëve komisioni i provimit afishon në vend të dukshëm pikët dhe notat e kandidatëve. Provimi në këtë program vlerësohet me gjashtë kredite.</p> <p>(Evidence 4: Rregullorja KPT, kreu IX; Evidence 50: Programi dhe Modeli i tezeve PPP; Evidenca 5: Rregullorja e programit të studimit; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai</p>	<p>GVJ konstatoi se studenti që ka shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit si dhe detyrimet financiare ndaj KPT, fiton të drejtën e mbrojtjes së diplomës. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentit. Diplomimi bëhet me provim formimi, projekt formimi ose përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për një temë të caktuar studimi, sipas vendimit të Rektorit për çdo vit akademik. Për studentët që diplomohen me temë diplome, nuk mund të mbrohet tema e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqesit si garantues të cilësisë së saj akademike.</p>

<p>garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në rast se do të punohej me diplomë udhëheqësi ju vjen në ndihmë studentëve për tu njoftuar dhe për ti ndihmuar me udhëzime, instruksione apo me materialet që mund ti duhen për të punuar me diplomën. Bashkë me udhëheqësin përcaktohet tema e diplomës. Më pas punohet me ngritjen e një strukture të diplomes sipas kapitujve përkatës. Udhëheqësi bën kontrolle të vazhdueshme dhe udhëzon studentin për të përmiresuar materialin.</p> <p>Në përputhje me rregulloren e KPT, deri më tani procesi i diplomimit është realizuar nëpërmjet provimit përfundimtar, ndaj Institucioni nuk ka staf të përfshirë si udhëheqës diplome.</p> <p>(Evidence 5.1: Rregullorja e praktikave profesionale; Evidence 5.2: Raporti i praktikave; Evidence 4: Rregullorja KPT, kreu IX; Evidenca 5: Rregullorja e programit të studimit; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ, mbështetur në RVB, dhe vizitën në institucion konstaton që KPT, garanton një numër të mjaftueshëm laboratorësh për kryerjen e aktiviteteve praktike dhe laboratorike. Krahas laboratorëve, institucioni ka në dispozicion edhe KPT HUB, zyren USIA, duke garantuar mjediset të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike, duke ndihmuar studentet për të zhvilluar testet në këto mjediset.</p> <p>Praktikat mësimore zhvillohen nëpër ambientet e kompanive apo institucione me të cilët universiteti ka marrëveshje paraprake. Praktikat profesionale zgjasin 6 jave. Praktika profesionale organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga Përgjegjësi i Departamentit përkatës, në bashkëpunim me Zyrën e Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve. Zhvillimi i praktikës drejtohet nga pedagoget që janë caktuar dhe nga një person mbikëqyrës nga ana e kompanisë dhe studentët edhe këtu ndihmohen për të kryer matjet apo testimet e duhura sipas fushës ku fokusohen.</p> <p>Monitorimi realizohet dhe nga tutoriatet që zhvillohen me studentët nga astafi akademik.</p> <p>(Evidenca 20: KPT HUB; Evidenca 11.4: Zyra USIA; Evidenca 22: Laboratorët; Evidence 5.1: Rregullorja e praktikave profesionale, Evidence 5.2: Raporti i praktikave)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ konstatoi se diplomimi bëhet me provim formimi, projekt formimi ose përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për një temë të caktuar studimi. Gjatë përgatitjes së procesit të zhvillimit të provimit përfundimtar Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, bazohet në rregulloren e programit të studimit "Database dhe Web Design", shqyrtojnë programin, planin mësimor dhe syllabuset më të përshtatshme sipas lendeve karakterizuese dhe baze të programit. Evidentohen kategoritë e lëndëve bazë që duhet të përmbajë provimi përfundimtar, të cilat i përshtatet më shumë dhe karakterizojnë profilin dhe fushën e programit të studimit. Në bashkëpunim me stafin akademik, i cili është përgjegjës për dhenien e ketyre lëndëve hartohet</p>



	<p>dhe miratohet përmbajtja e pyetjeve të provimit. Vumë re nga pyetjet gjate vizites ne institucion qe Provimi përfundimtar ndërtohej nga shtatë pjesë me grup pyetje, nga një grup për secilën nga shtatë lëndë të programit që zgjidhen. Gjatë hartimit të tezës së provimit pikët e caktuara të pyetjet përcaktojnë edhe peshën e secilës nga lëndet si përqindje krahasuar me totalin. Provimi zhvillohet me shkrim dhe korrigjohet nga komisioni i provimit i miratuar nga Rektori i KPT. Brenda pese diteve komisioni i provimit afishon në vend të dukshëm pikët dhe notat e kandidatëve. Provimi në këtë program vlerësohet me gjashtë kredite.</p> <p>(Evidence 4: Rregullorja KPT, kreu IX, kreu IV; Evidence 50: Programi dhe Model teze PPP; Evidenca 5: Rregullorja e programit të studimit; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studenti që ka shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit si dhe detyrimet financiare ndaj KPT, fiton të drejtën e marrjes së diplomes. Në përfundim të programit të studimeve studenti pajiset me diplomë profesionale, në fushën e DBËD brenda 6 muajsh nga përfundimi i studimeve, si dhe me certifikatën e notave. Emërtimi i fushës së arsimit të kryer përcaktohet në vendimet përkatëse të licencimit/akreditimit të programit të studimit. Elementet përberes, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin hartohen në përputhje me Udhezimin e Ministrisë përgjegjëse për arsimin. Forma e diplomës, elementet e sigurisë si dhe elemente të tjera të saj përcaktohen në një dokument të vecantë. Diploma plotësohet me shkrim të qartë e me boje teknike, nënshkruhet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Rektori dhe vuloset me vulën e KPT.</p> <p>Për secilin prej tyre që nënshkruan shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Diploma nuk mund të lëshohet publikatë, ajo jepet vetëm një herë. Diploma regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit dhe studentët pajisen përkatësisht me numër matrikulli. Për diplomat profesionale 2 vjeçare nuk parashikohet lëshimi i suplementit të diplomës por studentit ka të drejtë të marrë një kopje zyrtare të syllabuseve të programit të studimit të zhvilluar. Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari.</p> <p>(Evidence 4 Rregullorja e KPT, Neni 54-58; Pyetjet gjatë vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>GVJ konstatoi se Institucioni administron, ruan dhe arkivon të dhëna personale për studentet. Informacionet ruhen sipas legjislacionit në fuqi duke ruajtur sigurinë e tyre. Ato mund të merren nga persona të autorizuar me anë të kërkesës me shkrim në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPT mban në formë të shkruar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dokumentet: Regjistrin themeltar të studentëve, që vërteton regjistrimin e studenteve në KPT; Regjistrin e</p>




	<p>arritjeve akademike që vërteton rezultatet e arritura; Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, që vërteton emërtimin e tyre nga KPT. Regjistrat shpërndahen nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me originalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së KPT.</p> <p>Të dhënat personale të studentëve regjistrohen dhe ruhen në regjistrat përkatës dhe të gjitha informacionet e studentëve të disponueshme në dokumente janë të regjistruara edhe në formë elektronike në sistemin elektronik të menaxhimit të KPT. Kopje të dokumentacionit të regjistrimit të studenteve arkivohen dhe ruhet për një periudhë pa afat pas përfundimit të studimeve. Institucioni paraqet rast pas rasti informacione për studentit sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, ASCAL, etj.</p> <p>(Evidence 3: Statuti; Evidence 45: Regjistri baze themeltar; Pyetjet gjatë vizitës në institucion)</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstatoi se KPT ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Informacionet ruhen sipas legjislacionit në fuqi duke ruajtur sigurinë e tyre.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.6

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion që personeli akademik merr parasysh natyrën specifike të programit të studimit dhe ka përdorur metoda të larmishme të mësimdhënies. Nisur nga natyra e programit profesional të studimit, një rëndësi e veçantë i është kushtuar punës në laborator si dhe aspektit praktik duke ndërthurur në vlerësim projekte apo detyra kursi. Për zhvillimin e orëve laboratorike, vume re gjatë vizitës që universiteti ofron laboratorë me kushte bashkëkohore me programet përkatëse dhe pajisjet që ju duheshin atyre sipas lëndëve.</p> <p>NJSBC-ja harton pyetësorin përkatës për mendimin e studentit lidhur me zhvillimin e procesit mësimor rezultatet e të cilit kanë qenë objekt diskutimi dhe përmirësimi konkret në format e mësimdhënies.</p> <p>Gjatë pyetjeve vumë re që në periudhën e pandemisë, kishte rritje përdorimi i materialeve në formë elektronike. Për tu ardhur në ndihmë disa lëndëve specifike në kushtet e mësimdhënies online, janë shfrytëzuar maksimalisht përparësitë e teknologjisë për leksionet dhe</p>

	<p>fokus të veçantë iu kushtua zhvillimit dhe monitorimit të mësimit online. Nëse metodat e reja që propozohen nga pedagogët aprovohen si mjete inovative, nis trajnimi i personelit akademik për të përvetësuar këto metodologji në funksion të mësimit. Gjithashtu trajnimi konsiston edhe në zbulimin dhe veçimin e atyre njohurive që studentët mund të adaptojnë më së miri, psh. mesimi përmes platformës TEAMS, u bë i mundur duke bërë trajnimin e pedagogëve për shfrytëzimin sa më të mirë të saj, në përpjekje për të ruajtur cilësinë e zhvillimit të mësimit dhe angazhimin e studentëve.</p> <p>Platforma Microsoft Teams u përdor për zhvillimin e mësimit online dhe komunikim, takime /mbledhje etj. Platforma u bë e mundur nga Zyra IT e KPT. Për një pjesë të stafit dhe për studentët u ofrua asistencë dhe suport për aksesin në platformë përmes manualeve përkatës në shqip, video tutorial po dhe falë takimeve online. Manuali classter jep pershkrimin për Classter si një platformë e cila mundëson menaxhim të KPT në mënyrë të integruar plotësisht me office 365.</p> <p>(Evidenca 25: Mesimi online Zyra IT Video Tutorial Manual Komunikime; Evidenca 26: Trajnimi Polytech EU Masterclass; Evidenca 22: Labororet; Evidenca 28 Manuali Classter; Evidenca 28.1 Sistemi Classter)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimit dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>GVJ konstatoi se puna e personelit akademik mund të jetë subjekt i vlerësimit nga ana e KPT. Gjatë vitit akademik, pedagogu mund të nënshtrohet vlerësimit nga eprori direkt si dhe bën vetëvlerësimin e performancës së tij. Gjithashtu një vend të rëndësishëm në vlerësimin e punës së stafit ze edhe mendimi i studentëve i cili shprehet nëpërmjet plotësimit të formulareve përkatës që përgatiten në kuadrin e vlerësimit të performancës. Vlerësimi i performancës organizohet nga Zyra e Burimeve Njerezore si edhe nga NJSBC.</p> <p>Nga eprori direkt mund të behen kontrolle të herë pas herëshme gjatë procesit mësues si dhe vëzhgimit të raporteve të punës në përshtatshmëri me syllabuset. Mendimi dhe vlerësimi i studentëve shprehet nëpërmjet plotësimit të formularëve përkatës që përgatiten në kuadrin e vlerësimit të performancës. Zyra e Burimeve Njerezore dhe Kontratave mban dosjet e personelit. Ajo mundëson trajnime për stafin për kualifikimin profesional, veprimtaritë mbështetëse didaktike dhe trajnimeve në fushat përkatëse. NJSBC në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë vlerëson rëndësinë që ka mendimi i stafit, përmes një pyetësori, duke marrë informacion, qëndrimin e stafit për disa elementë të caktuar.</p> <p>(Evidence 6.4 Anketa e Stafit; Evidence 3: Statuti; Evidence 29: Manuali i Burimeve Njerezore; Evidence 6.2: Veprimtari të Stafit në kuadër të projekteve, trajnime; Evidence 11: Lista e projekteve, Evidence 13.2: Raporti NJSBC; Evidence 15: Formularët e vlerësimit Studente, Evidence 16: Fokus Grupe; Evidence 29/1 Dosja e personelit)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat përgjegjëse</p>	<p>GVJ konstatoi se Sigurimi i brendshëm i cilësisë është garantimi i</p>

<p>për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kulturore, shoqërore, të personelit akademik dhe studenteve, si dhe veprimtarive administrative dhe financiare të KPT. Njsbc midis të tjerave realizon monitorimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies dhe të vlerësimit të studenteve dhe ruajtja e cilësisë së tij.</p> <p>Ndjekjen e vazhdueshme të gjendjes së programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së mekanizmave zyrtare për miratimin, vlerësimin periodik dhe për monitorimin e programeve dhe diplomave. Vumë re që Njsbc ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Ajo vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, formuese e trajnuese.</p> <p>Rezultatet e Njsbc-së publikohen në një raport që i dërgohet Rektorit, Pergjegjësve të Departamenteve dhe Administratorit të KPT. Vumë re disa raporte: Raporti për kontrollin e syllabuseve; Raporti për kontrollin e tezave; Raporti për studentët; Relacioni mbi kontrollin gjatë provimeve, etj.</p> <p>(Evidence 13.1: Rregullorja Njsbc; Evidence 13.2: Raporti Njsbc; Evidenca 13.1 Rregullorja Njsbc)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstatoi se Sigurimi i brendshëm i cilësisë është garantimi i cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kulturore, shoqërore, të personelit akademik dhe studenteve, si dhe veprimtarive administrative dhe financiare të KPT. Njsbc midis të tjerave realizon monitorimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies dhe të vlerësimit të studenteve dhe ruajtja e cilësisë së tij.</p> <p>Ndjekjen e vazhdueshme të gjendjes së programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së mekanizmave zyrtare për miratimin, vlerësimin periodik dhe për monitorimin e programeve dhe diplomave. Vumë re që Njsbc ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Ajo vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, formuese e trajnuese.</p> <p>Rezultatet e Njsbc-së publikohen në një raport që i dërgohet Rektorit, Pergjegjësve të Departamenteve dhe Administratorit të KPT. Vumë re disa raporte: Raporti për kontrollin e syllabuseve; Raporti për kontrollin e tezave; Raporti për studentët; Relacioni mbi kontrollin gjatë provimeve, etj. Raportet diskutohen në të gjitha njesitë e institucionit me synim gjetje të praktikave të mira dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive të ardhmen. Kolegji Profesional i Tiranës suporton stafin akademik në rritjen e mëtejshme profesionale dhe synon inkurajimin e tyre për të ndjekur seminare, mbledhje apo forume të ndryshme që i aftësojnë ata në metoda të mësimdhënies si dhe formimit të tyre akademik. KPT nxit dhe zhvillon trajnime për stafin për përmirësimin e aftësive të tyre në procesin akademik.</p> <p>(Evidenca 13.1: Rregullorja e Njsbc, Evidenca 13.2 Raporti</p>




	NJSBC; Evidence 3: Statuti KPT, Evidence 4: Rregullore e Institucionit; Evidence 49: Prezantimet në Departament; Evidence 6.2: Veprimtari të Stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve; Evidence 19: Politika e kërkimit të aplikuar në KPT; Evidence 19/1: Kërkimi i aplikuar).			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstatoi KPT ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. NJSBC realizon monitorimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies, vlerësimin të studenteve dhe ruajtjen e cilësisë së tij.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA  
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Standardi IV.1**

**Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/ moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Nga vizita në Zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ konstatoi se, për zgjedhja e stafit bëhet pas një procesi të kujdesshëm, në përputhje me parashikimet e Manualit të Burimeve Njerëzore.</p> <p>Për shkak të strukturës ose formës që KPT në këtë institucion janë punësuar edhe pedagogë që nuk kanë tituj e grada, por që kanë një eksperiencë të gjatë e të suksesshme. Ne konstatojmë se në programin e studimit “DBWD” në KPT, zhvillojnë mësim një staf i përbërë nga 9 pedagogë, të angazhuar me kohë të plotë, nga të cilët 2 me gradën shkencore Prof. Dr, 1 me MND dhe 6 me titullin MSC. Nga takimi me Pedagoget dhe studentet, GVJ konstaton se ata përdornin metoda interaktive dhe inovative me studentët gjatë zhvillimit të lëndëve me qëllim arritjen e bashkëpunimit si dhe përmirësimin e njohurive duke futur edhe koncepte të reja nga fusha teknologjike dhe ajo e zbatimit të tyre për të nxitur interesin dhe vullnetin e studentëve.</p> <p>(Evidence 29, Manuali i Burimeve Njerëzore) (Evidence 29 Manuali i Burimeve Njerëzore) (Evidence 6.1 Të dhënat e stafit në vite)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa mësimore ishte e përcaktuar në kontratën individuale të punës në përputhje me aktet rregullatore të KPT.</p> <p>Ngarkesa mësimore e stafit akademik efektiv përcaktohet me vendim Rektorati. Nga takimi me pedagogët dhe studentët, GVJ konstaton se përveç ngarkesës mësimore në auditor, stafi akademik efektiv është i angazhuar edhe me veprimtari të tjera mbështetëse me natyrë akademike për institucionin si tutoriati, këshillim akademik, praktikat profesionale etj, të përcaktuara këto edhe në kontratën individuale të punës.</p> <p>(Evidence 29/1 Dosja e Personelit). (Evidence 29/3 Vendimi i Rektoratit për përcatimin e ngarkesës mësimore për stafin Efektiv). (Evidence 29/2 – Kontrata tip e punës).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit</p>	<p>Personeli i KPT përbëhet nga personeli akademik, ndihmës mësimor dhe personeli administrativ. Personeli i KPT është i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar dhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.</p> <p>Në çdo rast, GVJ, konstaton se KPT lidh kontratën përkatëse të punës e cila bazohet në legjislacionin në fuqi dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve.</p>


<p>dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>KPT paguan rregullisht detyrimet në lidhje me kontributet shëndetësore, shoqërore dhe tatimore në përputhje me aktet rregullatore në fuqi.</p> <p>Kontrata e punës kalon në kontratë pa afat për stafin akademik efektiv pas kalimit të kohës së provës prej 3 muaj dhe lidhet me kohë/ afat të caktuar për stafin akademik me kohë të pjesshme të cilët mund të angazhohen sipas nevojës së departamentit për një semester ose dy semestra. Kolegji Profesional i Tiranës gjatë periudhës midis dy akreditimeve ka mundësuar garantim të qëndrueshmërisë së stafit akademik të brendshëm dhe administratë duke e konsideruar këtë një faktor kyç të suksesit në plan afatgjatë. Ecuria lineare ndër vite të qëndrueshmërisë së stafit akademik mbështetet në disa kritere:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Selektimi dhe shpërndarja e stafit akademik sipas eksperiencës së tyre dhe nevojave të departamenteve;</li> <li>• Respektimi i dyanshëm i kontratës së punës të lidhur mes Palëve dhe legjislacionit në fuqi. KPT respekton dhe përmbush kërkesat dhe detyrimet kontraktuale (financiare, sigurimet shoqërore dhe kodin e punës) për personelin (Evidence 32 Detyrimet në kohë reale / Pagesa e kontributeve). Fusha e përgjithshme dhe specifike e studimeve të personelit akademik i angazhuar në njësinë bazë është në përputhje me drejtimin e kësaj njësie.</li> <li>• Institucioni siguron raporte midis kategorive të personelit akademik, moshës, eksperiencës etj., të tilla që të garantojnë vazhdimësi dhe shkëmbimin e eksperiencës midis brezave në ecurinë e njërive bazë. Institucioni garanton përmbushjen e kritereve ligjore për numrin, kualifikimin dhe raportin student /staf akademik.</li> <li>• Shkalla e ndryshueshmërisë së stafit akademik të brendshëm dhe administratë nga akreditimi i fundit deri në momentin e raportimit vlerësohet të jetë i qëndrueshëm.</li> </ul> <p>Përzgjedhja e stafit akademik i brendshëm dhe i jashtëm është bërë duke pasur parasysh fusha e përgjithshme dhe specifike të studimeve të personelit akademik i angazhuar në Departament</p> <p>(Evidence 3 – Statuti, neni 37 (1).  (Evidence 29/2 Kontrata tip e punës për stafin me kohë të pjesshme, Evidencea 29/3 Vendimi i Rektoratit për përcaktimin e ngarkesës mësimore për stafin Efektiv, Evidence 29/4 Vendim Rektorati për miratimin e stafit me kohë të pjesshme.).  (Evidence 32 Detyrimet në kohë reale / Pagesa e kontributeve).  (Evidence 6.1 Të dhënat e stafit në vite).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të</p>	<p>GVJ vëren se, në KPT, rekrutimi i personelit akademik kryhet në përputhje me nevojat për pedagogë duke iu referuar planeve mësimore të lëndëve që zhvillohen në kuadrin e çdo Departamenti, si dhe ngarkesat mësimore të miratuara.</p>

<p>shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>KPT pranon aplikime për personel akademik/administrativ gjatë të gjithë vitit, të cilat ruhen në një “<i>pool database</i>” duke respektuar parimin e mbrojtjes së të dhënave personale. Aplikimet mund të dorëzohen dorazi në Zyrën e Burimeve Njerëzore të KPT, me postë elektronike, ose të dërgohen nëpërmjet aplikimit në faqen e internetit të(<a href="http://ecce.kolegjiprofesional.edu.al">ecce.kolegjiprofesional.edu.al</a>) (<a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/punesimi-nc-kpt/">https://kolegjiprofesional.edu.al/punesimi-nc-kpt/</a>)</p> <p>Llojet e rekrutimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rekrutimi i brendshëm (transferim ose promovim);</li> <li>• Rekrutim i jashtëm (kërkim nëpërmjet database ekzistuese të kandidatëve, faqes së internetit të KPT-së, faqe interneti për punësime, rrjete sociale, fushata, “ëord of mouth”, nëpërmjet Zyrës së Punës etj.);</li> <li>• Rekrutim i brendshëm i kombinuar me të jashtëm;</li> <li>• Rekrutim i jashtëm nëpërmjet agjensive të specializuara të rekrutimit;</li> </ul> <p>Përzgjedhja bëhet me seleksionim paraprak dhe intervistë si dhe duke zhvilluar orë të hapura leksioni në praninë e komisionit të rekrutimit ku theksi vihet gjithmonë te një proces i paanshëm i rekrutimit, te aftësitë e kandidatit, përshtatshmëria me pozicionin e kërkuar si dhe mbi të gjitha meritokracia.</p> <p>Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidaturave, janë treguar ne pikën IV.1.1 të këtij raporti, gjithmone bazuar në Kodin e Punës, Statutin dhe dokumentet e tjera të KPT (Evidence 29 Manuali i Burimeve Njerëzore / Procesi i rekrutimit) (Evidence 29/2 - Kontrata tip e punës).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita ne Zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ vëren se personeli akademik/ laboratorik përzgjidhet me konkurs pas shqyrtimit nga një Komision Rekrutimi, i cili ngrihet me urdhër të Rektorit. Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të përmbushjes së kriterëve të shpallura dhe ekspertizës profesionale Synimi kryesor është zhvillimi i ngarkesës mësimore kryesisht me personel të brendshëm, të kualifikuar, profesionist e të qëndrueshëm, duke i dhënë përparësi universiteteve perëndimore. Staf i ndihmës akademik është i brendshëm/efektiv ose staf akademik i jashtëm me kontratë.</p> <p>Nisur nga natyra e KPT dhe programeve që ai ofron, një rëndësi të vecantë në procesin e rekrutimit të personelit ndihmës akademik I jepet atyre kandidatëve të cilët kanë një përvojë të gjatë e të suksesshme në profesionin dhe institucionin e tyre, janë unikë në fushën e tyre të specializimit. Kjo merr një vlerë të vecantë së bashku me laboratorët modernë të markave lider që ofron KPT.</p> <p>(Evidence 3 Statuti, neni 39, Evidence 29 - Manuali i Burimeve Njerëzore / Procesi i rekrutimit). (Evidenca 22 Laboratorët).</p>



<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p>	<p>Në KPT, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave është zyra përgjegjëse që mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit dosjet e personelit akademik dhe administrative të KPT.</p> <p>GVJ konstaton se, administrimi i dosjeve të personelit të KPT bëhet duke respektuar parimin e mbrojtjes së të dhënave personale. Personeli akademik i Kolegjit Profesional të Tiranës përbëhet nga Personel akademik me kohe të plotë dhe personel akademik me kohë të pjesshme.</p> <p>Dosja e personelit akademik të KPT përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• CV-në (sipas formatit të BE-së);</li> <li>• Dokument identifikimi;</li> <li>• Diplomë të arsimit të lartë të kryer, si dhe dokumente të tjera që vërtetojnë kualifikime, specializime, shoqëruar me listë notash, dhe marrje gradash apo titujsh akademikë e shkencorë, kopje të noterizuara. Nëse diploma e kualifikimit më të lartë është marrë në një institucion jashtë vendit, ajo duhet të shoqërohet me vendimin e njohjes nga MASH;</li> <li>• Raport i aftësisë për punë/Librezë shëndetësore;</li> <li>• Librezë Pune dhe Librezë Kontributesh për Sigurimin Shoqëror dhe Shëndetësor (nëse ka);</li> <li>• Leje nga Punëdhënësi kryesor (Vetëm në rastet kur personeli akademik është I angazhuar me kohë të pjesshme në KPT dhe full time në një IAL tjetër.</li> </ul> <p>Përveç angazhimit me mësimdhënie në auditor, stafi akademik zhvillon tutoriat me studentët si dhe të mbikqyrë studentët pranë subjekteve apo bizneseve gjatë zhvillimit të praktikës mësimore.</p> <p>Në fund të çdo semestri paraqitet ngarkesa e realizuar për çdo anëtar stafi.</p> <p>(Evidence 29 Manuali i Burimeve Njerëzore, Evidence 29/1 Dosja e personelit).</p> <p>(Evidence 5 Rregullorja e Programit të Studimit, neni 3 (6)).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>KPT, ka garantuar që, për pjesën e praktikës profesionale të vitit të dytë të sigurojë marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale me kompani e biznese private.</p> <p>GVJ konstaton se ka një dokumentacion të rregullt ku janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani të sektorit privat, Make ëith ICT, Albanian ICT Academy, Tech 360 Sh.p.k, Bashkia Tiranë, Zyra e Arkivave, Altelecom, Vatra Agency, Greenterprise dhe disa organizata jo fitimprurëse si Qendra për jetën. Këto marrëveshje bashkëpunimi bëjnë të mundur jo vetëm realizimin dhe plotësimin në kuadrin mësimor, por përafron gjithnjë e më shumë studentin me tregun e punës.</p> <p>Duke pasur parasysh punësimin e studentëve, Subjekti Pritës mund të vlerësojë dhe të marrë në konsideratë si kandidat të mundshëm që të punësojë Studentin në rast se ai përmbush kriteret e kërkuara.</p> <p>Praktika profesionale për programin “Database dhe Web Design”</p>

	<p>kryhet: Në agjensitë kreative, studio e imazhit dhe marketingut; Në kompani/ institute që furnizojnë shërbime të sondimit, ndërtimi të faqeve internet; Në organizata që merren me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave si AKSHI etj. Në momentin e kryerjes së praktikës profesionale të subjektin pritës, pedagogu mbikqyrës ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me personin mbikqyrës të studentit të caktuar nga subjekti pritës. Subjekti pritës cakton një person mbikëqyrës për çdo student që kryen praktikën. Ky person është pikë kontakti me KPT dhe në përfundim të zhvillimit të praktikës plotëson një formular vlerësimi për studentin praktikant Në fund të praktikës profesionale studenti përgatit një raport përfundimtar për punën e kryer dhe përvojë në subjektin pritës.</p> <p>Elementët përbërës të dosjes së vlerësimit të studentit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Raporti përfundimtar i studentit;</li> <li>Vlerësimi i pedagogut që ndjek zhvillimin e praktikës nga studenti;</li> <li>Vlerësimi i personit mbikqyrës të caktuar nga institucioni /subjekti pritës.</li> </ol> <p>Raporti mbrohet nga studentit përpara një komisioni të vecantë i cili ngrihet me vendim të Përgjegjësit të Departamentit. Vlerësimi bëhet me notë.</p> <p>(Evidenca 33 - Lista e partnerëve /marrëveshjeve të bashkëpunimit).</p> <p>(Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikës profesionale).</p>								
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Nga kontaktet me studentët dhe pedagoget, në KPT, GVJ konstaton se në KPT, bëhet e mundur që subjekti pritës të caktojë një person mbikëqyrës për çdo student që kryen praktikën. Ky person është pikë kontakti me KPT dhe në përfundim të zhvillimit të praktikës plotëson një formular vlerësimi për studentin praktikant. Pjesë e vlerësimit të dosjes së praktikës profesionale është edhe vlerësimi i personit mbikqyrës të caktuar nga institucioni /subjekti pritës. Një praktike e tillë është ndjekur përgjatë gjithë kohës në të gjitha programet e studimit dhe specifikisht në programin DBËD, ku të gjithë studentet në dosjen e plotësuar kanë dhe formularin e vlerësimit nga personeli mbikqyrës në praktiken profesionale.</p> <p>(Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikës profesionale, Neni 4).</p> <p>(Evidence 5.1 “Rregullorja e praktikës profesionale KPT”/ Evidence 5.4 Dosja e praktikës).</p>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se në KPT personeli akademik efektiv dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet në përputhje me fushën e programit, si të mësimdhënies, ashtu dhe të praktikave të programit të studimit profesional.</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="608 1823 826 1906">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="826 1823 1038 1906">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1038 1823 1219 1906">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1219 1823 1401 1906">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="608 1906 826 1953"></td> <td data-bbox="826 1906 1038 1953"></td> <td data-bbox="1038 1906 1219 1953"></td> <td data-bbox="1219 1906 1401 1953" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						




**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ vizitoi Kolegjin Profesional të Tiranës, nga ku pamë që ky kolegji, ka në dispozicion mjedise tejet të përshtatshme dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor teorik në sallat e leksioneve sipas numrit dhe grupeve mësimore të studentëve si dhe natyrës specifike të moduleve të vecanta të programit të studimit DËD. KPT shpk ndodhet me seli në adresën: Njësia Bashkiake numër 4, rruga “Xhanfize Keko”, Kompleksi “Xhura”, zonë Kadastrale 8130, me numër pasuri 5/200, Tiranë, në ambientet e marra me qira në bazë të kontratës së Qirasë numër Rep. 3758, No. Kol. 1044, datë 29/09/2015, të ndryshuar.</p> <p>Vendndodhja aktuale është lehtësisht e arritshme nëpërmjet mjeteve të transportit publik. Godinat e Kolegjit Profesional të Tiranës janë të vendosura brenda kompleksit të ndërtesave, të quajtur “Kompleksi Xhura”. Për sa i përket hapësirave akademike, ato janë të bollshme në aspektin e lartësisë, ndriçimit dhe ajrosjes. Çdo kat është 4 metra i lartë. Materialet e ndërtimit të përdorura janë cilësore dhe garantojnë gjithashtu një izolim të sigurt nga zhurmat duke siguruar kështu akustikën e duhur. Të gjitha objektet janë të pajisura me mjete mbrojtjes kundër shkarkimeve elektrike (4 rufepritëse) dhe paisje të mbrojtjes nga zjarri. Të gjitha fikset e zjarrit janë të vendosur në vende të dukshme dhe lehtësisht të arritshme në rast emergjence zjarri.</p> <p>GVJ organizoi vizite dhe në sallat e leksioneve dhe seminareve ku po zhvillohej mësim, nga ku konsatuam që mësimi organizohet në grupe mësimore në përputhje me parashikimet ligjore për këtë natyrë prprogrami studimi: grupe deri në 25 studentë në ushtrime, grupe me 10 -12 studentë në laborator. Në dispozicioni të këtij programi janë disa Laboratorë me natyre nderdisiplinore (Evidence 22 Laboratorë). (Evidenca 34 Infrastruktura)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ organizoi vizite në sallat e leksioneve dhe seminareve, nga ku konsatuam që Kolegji Profesional i Tiranës ka në dispozicion mjedise mësimore të ndara si klasa të leksioneve, ushtrimeve dhe laboratoreve të cilat janë të pajisura me pajisjet e nevojshme për zhvillimin sa më efikas dhe cilësor të procesit mësimor: klasat janë të pajisura me akses në internet Ëifi, kompiuter, projector.</p> <p>KPT gjithashtu ofron ambiente për personelin akademik, ambiente për personelin administrativ; salla mbledhjesh, salla kompjuterësh, multimediash etj. në përpjesëtim me numrin e stafit dhe studentëve</p> <p>Të gjitha ambientet e KPT janë të pajisura me internet dhe të mbuluara me sinjal ËiFi. Sallat mësimore janë të pajisura me mjete</p>

	<p>audio vizive si Smart Board, PC, projektorë, dhe foni; Të gjitha zyrat e personelit akademik dhe administrative janë të pajisur me kompiutera, si dhe ofrohet akses në infrastrukturë mbështetëse si printer, fotokopje dhe/ ose skaner. KPT disponon 4 laboratorë informatike, me 25 poste pune secili, të mirëpajisur me kompiutera, 2 rack të lëvizshëm me 15 laptop secili që përdoren në salla të ndryshme sipas nevojës, dhe një pool prej 10 laptop të financuar në kuadër të projekteve. Institucioni është i pajisur me softëare-ët përkatës. (Evidenca 34 Infrastruktura, Evidenca 34/1 Infrastruktura IT, (Evidenca 22 Laboratorët)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës zotëron hapësirat e nevojshme për zhvillimin e laboratoreve sipas programit të studimit DBËD. GVJ vizitoi 4 laboratorët, të cilët kanë 25 poste pune secili që realizojnë më së miri pjesën e laboratoreve të këtij programi studimi, 2 rack të lëvizshëm me 15 laptop secili që përdoren në salla të ndryshme sipas nevojës, dhe një pool tjetër prej 10 laptop. Lista e disa programeve qe perdor DBËD ne laboratore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Eclips</li> <li>• NotPad++</li> <li>• Visual Studio</li> <li>• Dev C++</li> <li>• Xampp</li> <li>• Java</li> <li>• Virtual Box</li> <li>• Raptor</li> <li>• Packet Tracer</li> <li>• Multisim</li> <li>• Android Studio</li> <li>• Inkscape</li> </ul> <p>Open Source Soft Graphic Design:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krita</li> <li>• Gimp</li> <li>• Blender</li> </ul> <p>(Evidence 34/1 - Infrastruktura IT).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Përveç laboratorëve te tjera, Kolegji Profesional i Tiranës ka në dispozicion të programit të studimit 4 laboratorë të teknologjisë së informacionit me 25 poste pune të pajisur me programe profesionale, 2 rack të lëvizshëm me 15 laptop secili që përdoren në salla të ndryshme sipas nevojës, dhe një pool prej 10 laptop. Sic theksuam edhe më lart, lista e disa programeve qe perdoren në kuadër të këtij programi ne laboratore janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Eclips</li> <li>• NotPad++</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Visual Studio</li> <li>• Dev C++</li> <li>• Xampp</li> <li>• Java</li> <li>• Virtual Box</li> <li>• Raptor</li> <li>• Packet Tracer</li> <li>• Multisim</li> <li>• Android Studio</li> </ul> <p>Open Source Soft grafic Design</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krita</li> <li>• Gimp</li> <li>• Blender</li> </ul> <p>Office 365 nga Microsoft (me Manualin përkatës Office 365)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Access</li> <li>• Word / Excel / Power Point Online</li> <li>• Sway (krijon prezantime dhe flyer interactive)</li> <li>• Forms</li> </ul>								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se në KPT, infrastruktura përmbush nevojat e programit të studimit profesional DBWD, për realizimin e procesit mësimdhënës dhe të formimit praktik të studentëve.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVB beri vizite ne bibliotekeën e KPT. Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës, rregullohen me rregullore e veçantë e cila është e shpallur në ambientet e saj Në bibliotekë gjenden literaturat bazë dhe ndihmëse, ne format hard copy si dhe ne formatin online, në gjuhën shqipe dhe angleze. KPT ka krijuar <a href="https://kolegijiprofesional.edu.al/online-library-oer/">https://kolegijiprofesional.edu.al/online-library-oer/</a> (Open Educational Resources (OER) me materiale mësimore dhe kërkimore të cilat dhe janë lëshuar nën një licencë të hapur që lejon aksesin, përdorimin, ripërdorimin dhe rishpërndarjen nga të tjerët pa kufizime ose të kufizuara. KPT ka marrëveshje bashkëpunimi, me UET, kështuqë ka akses në një portofol edhe më të gjerë titujsh dhe katalogësh. Pjesë e fondit të bibliotekës bëhen dhe botimet dhe publikimet në vite të stafit akademik. Ambientet e Bibliotekës mundësojnë gjithashtu dhe aksesin

	<p>online nëpërmjet posteve të punës të pajisur me kompiuter të vendosura në bibliotekë. Pedagogët, në përputhje me nevojat e tyre akademike, dorëzojnë kërkesat e tyre për literaturë tek Përgjegjësi i Departamentit përkatës. Në çdo syllabus të lëndës vendoset literatura përkatëse, e klasifikuar në literaturë të detyrueshme dhe e rekomanduar, në gjuhën shqipe dhe/ose Anglisht, në raste të caktuara. Në literaturën e detyrueshme bëjnë pjesë ciklet e leksioneve të shkruara nga pedagogët e lëndëve përkatëse, cikle të cilat janë në bibliotekë. Nga takimet GVJ me student dhe pedagogë, institucioni ndihmon dhe orienton studentin për mënyrën e sigurimit të literaturës nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Programit të lëndës dhe syllabusit; Pedagogu i lëndës jep sqarimet përkatëse se ku gjendet kjo literaturë dhe si mund të merret / akeshohet nga studenti.</li> <li>• Bibliotekës fizike dhe /ose online;</li> <li>• Pedagogëve – në tutoriat por edhe gjatë vitit në leksione/seminare;</li> </ul> <p>Silabusi i çdo lënde përditësohet për të reflektuar ndryshimet e tregut dhe përmirësimin e teknologjisë.</p> <p>1. (Evidence 34/2 – Rregullorja e Bibliotekës, Evidence 34/3 Karta e bibliotekës) së bashku me oraret e punës (Evidence 3, Statuti, neni 15, b), (Evidence 34/2 Rregullore e Bibliotekës – Evidence 34/3 Karta e Bibliotekës).</p> <p>2. (Evidence 5.5 Model syllabus)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se KPT garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë të bibliotekës nga të gjithë studentët e programit të studimit. Biblioteka i shërben zhvillimit të procesit mësimor–akademik në përputhje me programet e studimit që ofrohen. Fondi i Bibliotekës është mjaft i pasur , dhe gjithashtu pasurohet periodikisht nëpërmjet abonimeve në biblioteka dhe revista online, blerjeve të financuara nga KPT, donacioneve etj. dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me palë të treta. GVJ konstaton se një ndihmesë të madhe jep dhe biblioteka online: <a href="https://kolegjiiprofesional.edu.al/online-library-oer/">https://kolegjiiprofesional.edu.al/online-library-oer/</a> (Open Educational Resources (OER) me materiale mësimore dhe kërkimore të cilat dhe janë lëshuar nën një licencë të hapur që lejon aksesin, përdorimin, ripërdorimi dhe rishpërndarja nga të tjerët pa kufizime ose të kufizuara. (Evidence 34/4 – Biblioteka online)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të</p>	<p>Në vizitën e bërë nga GVJ në bibliotekën mësimore të Kolegjit Profesional të Tiranës konstatohet se kjo bibliotekë disponon gamë të madhe tekstesh në shqip dhe gjuhë të huaj. Biblioteka i shërben zhvillimit të procesit mësimor – akademik në përputhje me programet e studimit që ofrohen. Biblioteka e Kolegjit Profesional të Tiranës bazuar në syllabuset e lëndëve të parashikuara në këtë Program studimi dhe në literaturën e kërkuar ka aktualisht në fondin e saj një numër të konsiderueshëm librash mësimorë bazë dhe ndihmëse sipas profilit të</p>

<p>gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>lëndëve në programin e studimit DBWD. IAL në vazhdim e pasuron këtë bibliotekë me literature bashkëkohore dhe të përshtatshme për programin e studimit. Në bibliotekë ka mjaft libra, revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizites ne Bibliotekë, gjithashtu konstatim se për të siguruar cilësi sa më të lartë të procesit mësimor Kolegji Profesional i Tiranës, ka vënë në dispozicion falas dhe me kushte për akses të barabartë, bibliotekën mësimore si dhe bibliotekat online për të cilat institucioni ka bërë abonim. KPT ofron libraritë e sugjeruara on-line nga biblioteka ku institucioni është abonuar apo që janë me akses të lirë si openlibrary.org, link të mundësuar nga Biblioteka Kombëtare, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivës së Shtetit etj Studentët përveç materialeve të printuara në kopje fizike, mund të shfrytëzojnë edhe platformat online si Sharefolder, e cila aksesohet vetëm nga kompjuterat e lidhur në rrjetin e KPT. Në periudhën e Pandemisë Covid 19, për shkak të kufizimeve, dërgimi, ndarja dhe aksesit i materialeve mësimore është bërë e mundur nëpërmjet Platformës Teams duke siguruar kështu akses të pandërprerë në materialin akademik. Platforma Teams dhe Share point i japin akses studentëve edhe në literature sipas lëndëve përkatëse që zhvillojnë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka ofron të gjitha kushtet logjistike për një përdorim efikas të ambienteve. Biblioteka i shërben zhvillimit të procesit mësimor – akademik në përputhje me programet e studimit që ofrohen. Ajo ka një rregullore e cila është e shpallur në ambientet e saj së bashku me oraret e punës. Ambienti është i pajisur edhe me PC me qasje në internet dhe me mundësi për të përdorur bibliotekën virtuale nga të gjithë studentët dhe stafi. Biblioteka dhe koleksionet online round të aksesohen si nga studentët ashtu edhe nga stafi. (Evidence 34/2 – Rregullorja e Bibliotekës)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës, rregullohen me rregullore e veçantë e cila është e shpallur në ambientet e saj së bashku me oraret e punës .Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit: Hënë-Premte 9:00- 20:00 e Shtunë 9:00-17:00. Kurse gjatë sezonit të provimeve funksionon me orar të zgjatur.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. (Evidence 3, Statuti, neni 15, b),</li> <li>2. (Evidence 34/2 – Rregullorja e Bibliotekës, Evidence 34/3 Karta e bibliotekës)</li> </ol>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të</p>	<p>KPT bën investime për pasurimin e fondit të bibliotekës si një proces i vazhdueshëm dhe objektiv i rëndësishëm i institucionit. Përgjegjësit e programit hartojnë plane për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve. KPT bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer</p>

<p>programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.</p>	<p>studentëve dhe pedagogëve.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstatoi se biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit garantojnë literaturë të mjaftueshme për marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit si dhe mjedise të përshtatëshme për shfrytëzimin e kësaj literature. KPT bën investime për pasurimin e fondit të bibliotekës si një proces i vazhdueshëm dhe objektiv i rëndësishëm i institucionit</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi IV.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita në Institucion, konsatojme se menaxhimi i të gjithë informacionit të brendshëm që përfshin të gjithë anën administrative (zyra e burimeve njerëzore, sekretaria mësimore, etj) dhe anën akademike (stafi akademik, studentët) bëhen nëpërmjet platformës së sistemit të menaxhimit të informatizuar. Përdorimi i sistemit të informatizuar është në ndihmë edhe të sekretarisë mësimore, burimeve njerëzore dhe të gjitha instancave përkatëse të cilat ruajnë kopje fizike/ regjistra. Aplikacionet në nivel institucioni janë të vendosura në Classter i cili përfshin gjithë modulet e sistemit të manaxhimit të informacionit të Studentëve (Sistemi). Sistemi është mundësuar në bazë të kontratës përkatëse të lidhur me shoqërinë Tech360 shpk<sup>1</sup>, e cila është përgjegjëse për instalimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e aplikacioneve të Classter. Në Classter manaxhohet informacioni i cili lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit DBËD. Sistemi mundëson komunikimin e informacionit si: mësimin, orari i sezoneve të provimit, rezultatet e mbledhjet e punës.</p>

<sup>1</sup> Shoqëria Tech360 është shoqëri e së drejtës shqiptare. Faqja zyrtare e saj është <http://tech360.al/rrethnesh/>



	<p>Classter përmban:</p> <p>a. Kartelën e studentit;</p> <p>b. Portalin e pedagogëve, që përmban informacion mbi projekte, ndihmon pedagogët në hedhjen e notave në sistem, njoftime të nevojshme etj.</p> <p>c. Orarin Mësimor, me informacionin e nevojshëm mbi zhvillimin e lëndëve, kohën e zhvillimit të tyre, sallën, etj;</p> <p>d. Menaxhimin e-books ose librat e bibliotekës;</p> <p>e. Menaxhimin e pagesave të studenteve</p> <p>f. Integrimin me posten elektronike të stafit/studenteve (Microsoft Office365) si dhe me materialet akademike.</p> <p>Classter mundëson që të gjenerojë raporte të ndryshme të kërkuara nga sekretaria mësimore dhe zyra e financës.</p> <p>Gjithashtu Zyra e Financës përdor sisteme të veçanta që lidhen me kontabilitetin në përputhje me parashikimet ligjore, veçanërisht dhe atë në lidhje me fiskalizimin, falë të cilës mundëson gjenerimin e raporteve sipas nevojave.</p> <p>Përdorimi efikas i sistemit të menaxhimit lehtëson punën e cdo hallke në IAL. (Evidence 28/1 Sistemi Classter)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës ka në dispozicion një dispozicion një sistem i menaxhimit të brendshëm Classter nëpërmjet të cilit manaxhohet informacioni, dokumentacioni dhe aktivitetet të cilat lidhen me personelin akademik, personelin ndihmës akademik, personelin administrative. Përdorimi i platformës së informatizuar është komplementar me menaxhimin e dokumentacionit në kopje fizike konform akteve ligjore dhe akteve nën ligjore në fuqi. Ky informacion përpunohet dhe administrohet nga personeli përgjegjës i burimeve njerëzore dhe sekretaria mësimore sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren përkatëse.</p> <p>Dosjet fizike të Personelit mbahen në Zyrën e Burimeve Njerëzore. (Evidence 28 Manuali Classter, Evidence 28/1 Sistemi Classter). (Evidence 29/1 Dosja e personelit).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita GVJ në Kolegjin Professional të Tiranës, vërejmë se i gjithë sistemi informatik, është i ndarë në :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Share Folder (nivel lokal) i cili përdoret për të shkëmbyer materiale në rang Staf Pedagogjik , Pedagog – Student, materiale për studentet etj.</li> <li>• Share Point (One Drive) pjesë e Office365 ku aksesimi mund të lejohet ose jo brenda organizatës , për studentet dhe stafin. Gjithashtu integrimi me platforma të tjera si Forms, Teams, Stream për të mundësuar komunikim të sigurt dhe lehtësisht të aksesueshëm.</li> <li>• Nëpërmjet sistemit të menaxhimit Classter pedagogu mund të mundësojë studenteve materiale si literaturën, syllabuse, ushtrime etj.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit</p>	<p>GVJ konstaton se shkëmbimi i informacionit ndërmjet personelit dhe</p>

<p>ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>studentëve bëhet njëkohësisht nga Platforma Microsoft Teams dhe Classter e cila përdoret online dhe aksesohet nga studentët dhe stafi akademik për aksesimin e moduleve, mësim online dhe komunikim të brendshëm elektronik.</p> <p>Portali i Studentit Classter ofron akses dhe të mundëson:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Orarin mësimor për çdo semestër;</li> <li>2. Studenti mund të shikojë programet e lëndëve;</li> <li>3. Pikët për çdo lëndë (me gjithë komponentët e vlerësimit);</li> <li>4. Njoftime të ndryshme në lidhje me aktivitetet që zhvillohen.</li> </ol> <p>(Evidence 28 Manuali Classter, Evidence 28/1 Sistemi Classter).</p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sic u tha dhe me lart, Kolegji Profesional i Tiranës ka në dispozicion sistemin e menaxhimit, platformën Classter me anë të cilit garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Me anë të sistemit Classter mundësohet raportime individuale me të dhëna në kohë reale për çdo strukturë, organet drejtuese dhe titullarët (Evidence 28 Manuali Classter, Evidence 28/1 Sistemi Classter).</p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Përveç platformës Classter, Kolegji Profesional i Tiranës ka në funksion faqen zyrtare të internetit <a href="https://kolegji profesional.edu.al/">https://kolegji profesional.edu.al/</a>, në të cilën publikohet informacion mbi programet e studimit, strukturën organizative të institucionit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme në lidhje me jetën akademike, studentore, apo të zhvilluara në bashkëpunim me partnerë kombëtar e ndërkombëtar. Informacioni i faqes zyrtare të internetit azhurnohet në mënyrë të vazhdueshme nga personat përgjegjës në përputhje me Politikën e Mirëmbajtjes së faqes së internetit.</p> <p>(Evidence 35 Politika e Manaxhimit /Mirëmbajtjes së faqes së internetit).</p>		
<p><b>Konkuzione</b></p>	<p><i>Vume re qe KPT disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Kolegji Profesional i Tiranës ka në dispozicion sistemin e menaxhimit, platformën Classter me anë të cilit garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
------------------------	-------------------------

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga vizita e GVJ ne zyren financiare te KPT, konstatojme se mbajtja e llogarive, regjistrimeve dhe veprimeve financiare kryhen në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe duke respektuar Standartet Kombëtare të Kontabiliteti. Pasqyrat financiare të KPT miratohen nga mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të KPT shpk dhe depozitohen elektronikisht në Zyrën e Tatimeve brenda afateve ligjore dhe në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (<a href="http://ëëë.qkr.gov.al/">http://ëëë.qkr.gov.al/</a>), duke qenë kështu të aksesueshme në çdo kohë nga publiku i gjerë. Pasqyrat financiare japin një pasqyrim të drejtë të gjëndjes financiare të shoqërisë në datën e mbylljes së bilancit, të rezultatit financiar dhe fluksit të parasë në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe në pajtim me ligjin nr 9228/4 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Pasqyrat financiare auditohen cdo vit nga një palë e tretë e pavarur. KPT shqyrton dhe analizon në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standarteve. KPT llogarit koston per te gjithë institucionin, ashtu si dhe per programet e vecanta: metodologjia ka për bazë llogaritjen me bazën standarte të shpenzimeve në total / shpenzime të departamentit me numrin total të studenteve / numri i studenteve për departament. Ndonëse aktiviteti i shoqërisë KPT shpk është i gjerë, aktualisht i vetmi aktivitet që shoqëria zhvillon është ai i arsimit profesional të lartë në përputhje me licencën e marrë nga organet kompetente. KPT raporton çdo vit akademik pranë MAS lidhur me veprimtarinë e tij duke përfshirë ndër të tjera dhe administrimin e të ardhura financiare/bursave/fondeve kërkimore, etj Buxheti financiar hartohet në muajin tetor të çdo viti dhe për zbatimin e këtij buxheti, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku përcaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Veprimet e shoqërisë kryhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar duke siguruar transparencë të plotë. Raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë. (Evidenca 36 Raporti Vjetor).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin</p>	<p>KPT është institucion i arsimit të lartë privat me vetëfinancim. Burimet financiare, përfshijnë tarifën e shkollimit, projekte / grante ndërkombëtare të KPT, financimi nga ortakët e KPT shpk në cilësinë e pronarit, të ardhura nga shërbimet që KPT ofron për të tretë, burime të tjera të ligjshme. Tarifat janë të publikuara rregullisht në faqen zyrtare të internetit të KPT për çdo vit akademik Në raportet vjetore vihet re një analitikë e të ardhurave dhe shpenzimeve në nivel institucioni. Plani i financimit hartohet në nivel institucional, ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat. Nga GVJ vihet re një procedurë e konsoliduar e hartimit të nevojave të brendshme të institucionit të cilat më pas reflektohen edhe në</p>

<p>në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>planifikimin e buxhetit të vitit pasardhës. Të dhënat financiare dëshmojnë qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. (<a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/tarifatestudimitdhebursat/">https://kolegjiprofesional.edu.al/tarifatestudimitdhebursat/</a>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Te gjitha funksionet administrative, ekonomike dhe financiare realizohen nëpërmjet Zyrës së Financës dhe Administratorit të KPT i cili është një urë komunikimi dhe me Asambleshën e Ortakëve të KPT shpk. GVJ konstaton se mbajtja e llogarive, regjistrimeve dhe veprimeve financiare kryhet në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe duke respektuar Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Të gjitha veprimet në lidhje me kontabilitetin mbahen në programin financiar Alpha i cili gjeneron raporte financiare, për student, për vit, për buxhet, për shpenzime, të ardhura etj. Pasqyrat financiare japin një pasqyrim të drejtë të gjëndjes financiare të shoqërisë në datën e mbylljes së bilancit, të rezultatit financiar dhe fluksit të parasë në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe në pajtim me ligjin nr 9228/4 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Pasqyrat financiare auditohen cdo vit nga një palë e tretë e pavarur. Konsatojme se KPT ka një qëndrueshmëri të mirë financiare. (Evidenca 32 -Detyrimet ne kohe reale / Pagesa e kontributeve).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Në KPT, të dhënat financiare dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. Raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Vizita e GVJ ne institucion vërteton se pasqyrat financiare të KPT miratohen nga mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të KPT shpk dhe depozitohen elektronikisht në Zyrën e Tatimeve brenda afateve ligjore dhe në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (<a href="http://www.qkr.gov.al/">http://www.qkr.gov.al/</a>), duke qenë kështu të aksesueshme në çdo kohë nga publiku i gjerë. Pasqyrat financiare japin një pasqyrim të drejtë të gjëndjes financiare të shoqërisë në datën e mbylljes së bilancit, të rezultatit financiar dhe fluksit të parasë në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe në pajtim me ligjin nr 9228/4 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Pasqyrat financiare auditohen cdo vit nga një palë e tretë e pavarur. KPT shqyrton dhe analizon në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standarteve. KPT llogarit koston për te gjithë institucionin, ashtu si dhe për programet e vecanta: metodologjia ka për bazë llogaritjen me bazën standarte të shpenzimeve në total /</p>


	shpenzime të departamentit me numrin total të studenteve / numri i studenteve për departament. Ndonëse aktiviteti i shoqërisë KPT shpk është i gjerë, aktualisht i vetmi aktivitet që shoqëria zhvillon është ai i arsimit profesional të lartë në përputhje me licencën e marrë nga organet kompetente. KPT raporton çdo vit akademik pranë MAS lidhur me veprimtarinë e tij duke përfshirë ndër të tjera dhe administrimin e të ardhura financiare/bursave/fondeve kërkimore, etj (Evidenca 36 Raporti Vjetor).			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstatoi se KPT disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional për administrimin, informimin dhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar, administrativ. Te gjitha funksionet administrative, ekonomike dhe financiare realizohen nëpërmjet Zyrës së Financës dhe Administratorit të KPT.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Vizita ne Institucion bind GVJ se procesi nga pranimi deri në diplomim mbështetet në: legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloret përkatëse, burimet njerëzore dhe kapacitetet infrastrukturore. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese të KPT, fushatat informuese mediatike, si edhe gjatë këshillimit në institucion.</p> <p>Informacioni i nevojshëm publikohet në disa forma:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>format fizik, në formën e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, etj., të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve.</li> <li>Në format fizik të shpallura /të publikuara në mjediset e përcaktuara të Kolegjit Profesional të Tiranës si orari i mësimi, njoftime të ndryshme, pjesë të rëndësishme të rregullores, rezultatet e kontrolleve, etj.</li> <li>Në format elektronike në faqen zyrtare të Kolegjit Profesional të Tiranës në internet: <a href="http://kolegji-profesional.edu.al/">http://kolegji-profesional.edu.al/</a></li> </ol> <p>Gjithashtu informacioni i nevojshëm merret edhe përmes sistemit të informacionit Classter, i cili përfshin gjithë modulet e sistemit të manaxhimimit të informacionit të Studentëve, si orari i mësimi, rezultatet, etj. Vendimet e rëndësishme të marra nga Senati Akademik, Rektorati, Departamenti në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, të studentëve, rezultatet e analizave të bëra, etj., u bëhen me dije studentëve në forma të ndryshme si takime të drejtpërdrejta me studentët, shpalljeve në mjediset e caktuara të kolegjit, njoftimeve në faqen zyrtare të Internetit, me postë elektronike, etj. Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave përpilon në formë elektronike dhe të shkruar Regjistrin Bazë të Studenteve. Me regjistrimin përfundimtar në KPT, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Qendra e Shërbimeve Arsimore, pajis çdo student me numrin unik të matrikullit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Procedurat e pranimit të studentëve</li> </ul> <p>Procesi i pranimit të studentëve kryhet nëpërmjet aplikimit elektronik në faqen zyrtare të maturës shtetërore, në Portalin E-Albania, e më pas IAL shkarkon listat e aplikantëve në afatet e përcaktuara. Kolegji Profesional i Tiranës brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore, si dhe bazuar në kriteret e pranimit të aplikantëve, shpall fituesit duke i bën publike listat e kandidatëve fitues në faqen ëeb dhe rrejtet sociale..</p>

	<p>Kandidatët e shpalluer fitues, duhet të paraqiten me dokumentacion përkatës për të proceduar me regjistrim në programin e studimit që dëshiron. Procesi i aplikimit dhe regjistrimit kryhet në disa faza, sipas akteve ligjore në fuqi. Numri i pranimeve të studentëve në programin e studimit “Database dhe Web Design”, bazohet në mundësitë reale që KPT ka për zhvillimin e një mësimi normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në përputhje me Ligjin “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me Rregulloren dhe me Statutin e KPT. Kuotat e studentëve për cdo program studimi, miratohen cdo fillim viti akademik me vendim senati akademik. Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, në programin e studimit “Database dhe Web Design për vitin akademik 2022-2023 ” është 19 studentë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni garanton barazinë dhe të drejtat e njëjta për të gjithë kandidatët për student dhe studentët, duke bërë transparente kriteret dhe procedurat që nga momenti i hyrjes deri në dalje. Në bazë të akteve rregullatore të KPT, dhe procedurave për pranimin e regjistrimit të studentëve, në programin e studimit Database dhe Web Design” të ofruar në KPT, pranohen për t’u regjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këto kushte:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Vërtetojnë me dokument zyrtar zotërimin e dëftesës së pjekurisë ose të diplomës përkatëse të shoqëruar me certifikatën e notave që bën të mundur regjistrimin në programin e studimit, sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas rregullores së programit të studimit përkatës;</li> <li>b. Dorëzojnë dokumentet e nevojshme për lidhjen e kontratës me KPT;</li> <li>c. Plotësojnë të gjitha kriteret e pranimin të përcaktuara nga organet drejtuese të KPT;</li> <li>d. Shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, duhet të ndjekin procedurën e njohjes së diplomës në MASHR, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</li> <li>e. Kryejnë pagimin e tarifës së caktuar vjetore dhe/ose të plotë sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës përkatëse mes KPT dhe Studentit;</li> </ol> <p>Duke qenë se Kolegji Profesional i Tiranës është Institucion i arsimit të lartë profesional dhe programet e ofruara janë më natyre profesionale në momentin e aplikimit për kandidatët nuk është kusht plotësimi i notës mesatare. Pranë Kolegjit Profesional të Tiranës, kanë të drejtë të aplikojnë dhe regjistrohen të gjithë kandidatët të cilët kanë një notë mesatare nga matura shtetërore edhe poshtë notës 6.5.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen</p>	<p>Nga dokumentacioni i paraqitur GVJ-së në vendimet e Senatit përcaktohen kriteret e pranimin të studentëve për cdo program studimi, për cdo vit akademik.</p>




<p>e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Pranohen për të aplikuar dhe për t'u regjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këto kushte:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Vërtetojnë me dokument zyrtar zotërimin e dëftesës së pjekurisë ose të diplomës përkatëse të shoqëruar me certifikatën e notave që bën të mundur regjistrimin në programin e studimit, sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas rregullores së programit të studimit përkatës;</li> <li>Dorëzojnë dokumentet e nevojshme për lidhjen e kontratës me KPT;</li> <li>Plotësojnë të gjitha kriteret e pranimit të përcaktuara nga organet drejtuese të KPT;</li> <li>Shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, duhet të ndjekin procedurën e njohjes së diplomës në MASHR, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</li> <li>Kryejnë pagimin e tarifës së caktuar vjetore dhe/ose të plotë sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës përkatëse mes KPT dhe Studentit;</li> </ol> <p>KPT dorëzon pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, kuotat përkatëse për çdo program në përputhje me kapacitetet që disponon IAL dhe që i nënshtrohen verifikimit nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Për t'u regjistruar pranë Kolegjit Profesional të Tiranës, kandidatët dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm pranë Zyrës së Kontratave:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Fotokopje të noterizuar të të Diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë së bashku me certifikatën e notave ose të një deftese/ diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar nga MAS;</li> <li>Çertifikatë familjare;</li> <li>Dokumentin e identifikimit (fotokopje të kartës së identitetit ose pasaportës);</li> <li>Çdo dokument tjetër të përcaktuar si të nevojshëm nga legjislacioni në fuqi dhe KPT;</li> </ol> <p>Pas dorëzimit të dokumenteve të mësipërme lidhet kontrata e regjistrimit mes Kolegjit Profesional të Tiranës dhe studentit.</p> <p><b>(Evidenca 23 Vendimet SA).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga takimet me studentët, GVJ konstaton se ato janë të mirëinformuar për kriteret dhe procedurat e pranimit në KPT.</p> <p>Për të gjithë studentët e rinj realizohet Java e Orientimit. Gjatë kësaj jave realizohen takime, leksione, për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregullores dhe procedurave administrative të KPT; studentët njihen me ambientet ku do të zhvillohet mësimi etj</p> <p><b>(Evidenca 30 Java e Orientimit)</b></p> <p>Gjithashtu, gjatë javëve të regjistrimit, studentët marrin informacion, nga pedagogët e programeve të studimit. Në fillim të vitit akademik, studentëve u vihet në dispozicion silabusi për çdo lëndë e programit të</p>



	<p>studimit. Pjesë e silabusit është edhe mënyra e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> <p>Informimi dhe ndërgjegjësimi për t'u regjistruar në Kolegjin Profesional të Tiranës (KPT) realizohet në përputhje me "Politikën e procedurat e Komunikimit në KPT" nëpërmjet këtyre formave:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Organizim i takimeve informuese, sqaruese dhe ndërgjegjësuere të përfaqësuesve të KPT me nxënësit e shkollave të mesme të Tiranës dhe të qyteteve të tjera të vendit në mjediset e tyre;</li> <li>2. Organizimi i ushtrimeve, i tryezave të rrumbullakëta, dhe i veprimtarive të tjera me karakter mësimor-informues-argëtues me nxënësit e shkollave të mesme të vendit në mjediset e Kolegjit Profesional të Tiranës;</li> <li>3. Përgatitje e shpërndarje e materialeve informuese, sqaruese, ndërgjegjësuere (si fletëpalosje, postera, broshura etj.), dhe të materialeve audio vizive ne media te ndryshme si: spote promocionale, mesazhe promocionale etj;</li> <li>4. Dalje publike të përfaqësuesve të KPT në media dhe /ose evente të ndryshme;</li> <li>5. Organizim logjistik, orientues, me mbështetje brenda burimeve njerëzore të Kolegjit Profesional të Tiranës për të interesuarit të cilët informohen, sqarohen, këshillohen mbi sistemin e studimeve, procedurat e aplikimit dhe të pranimit dhe gjithashtu pajisen me dokumentacionin përkatës.</li> <li>6. Pjesëmarrje në panairë dhe/ose evente të tjera të ngjashme;</li> <li>7. Komunikim nëpërmjet faqes zyrtare të KPT dhe / ose llogarive në rrjetet sociale;</li> </ol> <p>Gjithashtu Kolegji Profesional i Tiranës organizon veprimtari/aktiviteteve staf-student të tilla si turet nëpër shkollat e mesme për të informuar çdo maturant mbi programet e studimit që KPT ofron, kushtet dhe kriteret e pranimit etj.</p> <p><b>(Evidence 5.5 Syllabus) (Aneksi 24.1 – Turet)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ konstaton se KPT ka kriteret të veçanta, për kandidatët me aftësi ndryshe:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- KPT ka miratuar Rregulloren për Studentët me Paaftësi të kufizuara.</li> <li>- KPT ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për këtë kategori studentësh përse i përket zhvillimit të procesit akademik dhe nevojave personale si dhe ka në planet e tij përmirësimin e vazhdueshëm të këtij shërbimi.</li> <li>- Hyrja në KPT është në nivel toke, çka e bën lehtësisht të aksesueshme;</li> <li>- Tualete për personat me aftësi ndryshe</li> <li>-Në lidhje me studentët e pakicave rome dhe ballkano-egjiptiane, KPT ka bërë parashikime në kuota por nuk ka pasur raste të tilla.</li> </ul> <p>Në këtë mënyrë e KPT është një institucion me përgjegjëshmëri të</p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>lartë sociale. (Evidence 3 – Statuti, neni 6 (2) (b).</p> <p>Nga takimet që GVJ bëri me studentët konstatijmë se në Kolegjin Profesional të Tiranës vlerësohet puna dhe meritat e çdo studenti dhe në të njëjtën kohë ka mekanizma që studenti të aftësohet në dije, aftësi dhe kompetenca mësimore dhe profesionale për një treg pune ndërkombëtar. KPT ofron bursa në varësi të mesatares së notave në maturën shtetërore dhe/ose në vitet e studimit në KPT.</p> <p>Gjithashtu KPT është pjesë e disa projekteve ndërkombëtare (<a href="https://kolegji-profesional.edu.al/portofoli-i-projekteve/">https://kolegji-profesional.edu.al/portofoli-i-projekteve/</a>) të cilat mundësojnë internship pranë kompanive europiane me të gjitha kostot e mbuluara nga projekti: MOVET EAC/S54/2019. Gjithashtu janë zhvilluar praktikat 1 dhe 3 mujore pranë kompanive në Budapest, Hungari, dhe ato 1 mujore në Leptokarya, Greqi.</p> <p>Procesi i thirrjes ishte transparent dhe u bë publik në rrjetet sociale dhe me anë të postës elektronike, u zhvillua procesi i intervistës, si dhe u bë trajnimi paraprak i studentëve të përzgjedhur për t'u përgatitur me mobilitetin jashtë . KPT parashikon në vijim thirrje te tjera për këtë projekt në shtete si Polonia etj si dhe për projektin MOVET.</p> <p>Gjithashtu Zyra ndan informacione të ndryshme në lidhje me mundësitë për bursa apo financime për studentët, (si psh Connect IT është një projekt i GIZ dhe Bashkimit Europian, që vepron në Tiranë prej rreth nje viti, sipas një modeli të njëjtë, të implementuar në Hollandë. Qëllimi kryesor i projektit është të lidhë së bashku ekipe studentësh të profilit IT dhe kompani shqiptare duke i ndihmuar këto të fundit në dixhitalizimin e ofrimit të produkteve apo shërbimeve të tyre).</p> <p>(Evidence 39 Connect IT etj).</p> <p>(Evidence 38 Praktika Connected through Mobility).</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se KPT harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, për njohjen dhe vlerësimin e dijeve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore..</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në</p>	<p>Komunikimi jashtë dhe brenda institucionit bëhet në bazë të Politikës</p>

dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.

së Komunikimit, Politikës së Përdorimit të Internetit, Postës Elektronike dhe Infrastrukturës IT.

Pranë KPT funksionon Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit, e cila në kuadër të politikave të pranimit jep informacion për KPT dhe programet e studimit që ofron si dhe orienton të interesuarit të zyrat përkatëse), Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, Sekretaria Mësimore dhe Koordinatorët të cilët luajnë një rol thelbësor në informimin dhe koordinimin e punës me studentët dhe stafin akademik. Kompetencat e tyre janë të përcaktuara në Statut.

Në faqen e internetit publikohet dhe përditësohet informacion i plotë, i saktë dhe i detajuar në lidhje me portofolin dhe ofertën akademike të KPT (<https://kolegjiprofesional.edu.al/programet-e-studimit-ne-kpt/>) Gjithashtu për çdo lëndë, studentit i vihen në dispozicion Syllabus i Lëndës, si dhe organizohen Tutoriatet.

Komunikimi në KPT është verbal, shkresor dhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit që mundëson teknologjia. Elementët e këtij sistemi komunikimi dhe informimi janë si më poshtë:

- Faqja Zyrtare [www.kolegjiprofesional.edu.al](http://www.kolegjiprofesional.edu.al) Njoftimet në faqen zyrtare e KPT
- Në adresat e postës elektronike në domain [kpt.edu.al](mailto:kpt.edu.al)
- Njoftimet dhe publikimet e ndryshme në llogaritë zyrtare në rrjetet sociale të KPT;
- Njoftimet e afishuara në këndet e informimit/zyra/ekran njoftimi përkatësisht;
- Nëpërmjet Platformës Teams
- Tutoriati dhe këshillimi akademik;
- Takimet në zyrat e stafit sipas çështjes së ngritur;
- Numrat e telefonit;

KPT disponon një databazë të saktë me të dhënat e studentëve e cila përfshin: adresën, adresën e postës elektronike dhe numrin e telefonit të çdo studenti, si dhe numrin e një familari në çdo rast.

Në qendër të këtij komunikimi është Sistemi Classter.


Sistemi është mundësuar në bazë të kontratës përkatëse të lidhur me shoqërinë Tech360 shpk<sup>2</sup>, e cila është përgjegjëse për instalimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e aplikacioneve të Classter. Sistemi mundëson komunikimin e informacionit si: mësimin, orari i sezoneve të provimit, rezultatet e mbledhjet e punës.

Classter përmban:

- a. Kartelën e studentit;
- b. Portalin e pedagogëve, që përmban informacion mbi projekte, ndihmon pedagogët në hedhjen e notave në sistem, njoftime të nevojshme etj.
- c. Orarin Mësimor, me informacionin e nevojshëm mbi zhvillimin e lëndëve, kohën e zhvillimit të tyre, sallën, etj;

<sup>2</sup> Shoqëria Tech360 është shoqëri e së drejtës shqiptare. Faqja zyrtare e saj është <http://tech360.al/retshesh/>

	<p>d. Menaxhimin e-books ose librat e bibliotekës;</p> <p>e. Menaxhimin e pagesave të studenteve</p> <p>f. Integrimin me posten elektronike të stafit/studenteve (Microsoft Office365) si dhe me materialet akademike.</p> <p>Faqja zyrtare <a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/">https://kolegjiprofesional.edu.al/</a> përmban informacion të detajuar në lidhje me: strukturën dhe organizimin e KPT, programet mësimore, personelin, shërbimet, oferta akademike, pranimet dhe kriteret e pranimit, silabusët për lëndë, aktet rregullatore të Institucionit, Statutin, mundësi aplikimi për punë dhe kontakte, informacione të cilat përditësohen me kujdes në përputhje me Politikën e Menaxhimit të faqes së Internetit .</p> <p>Gjithashtu, KPT është pjesëmarrës në panairë të organizuara nga organizata dhe institucione të ndryshme ku promovohet IAL dhe arrijtet në fushën e ndërkombëtarizimit etj që luajnë një rol të rëndësishëm në cilësinë e programeve të studimit.</p> <p>(Evidence 24 – Politika e Komunikimit)</p> <p>(Evidence 37 – Politika e Internetit).</p> <p>(Evidence 3 – Statuti shih neni 15, pika (4),</p> <p>(Evidence 3 – Statuti) dhe në Rregulloren KPT (Evidence 4 – Rregullorja KPT).</p> <p>(Evidence 5.5 -Syllabus )</p> <p>(Evidence 17 – Tutoriatet këshillim akademik).</p> <p>(Evidence 28/1 - Sistemi Classter).</p> <p>(Evidence 35 - Politika e Menaxhimit të faqes së Internetit).</p> <p>(Evidence 24/4 Panairët Eork and Study ndër vite/ Panairi House of Europe).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Nga takimet me student GVJ konsatton se ata kanë një informacion të plotë mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit i cili i vihet në dispozicion studentëve, kriteret e procedurat e njohjeve nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Këshillimit me stafin akademik në momentin që interesohen për programet e studimit;</li> <li>-Kontakteve me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit;</li> <li>-Rregullores KPT / rregullores mësimore të programit të studimit (neni 12);</li> <li>-Kontratës që nënshkruhet me KPT në momentin e regjistrimit</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Ka një rregullore të detajuar për Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të cilat pasqyrohen në Rregulloren KPT, rregulloren mësimore të programit të studimit si dhe në syllabus-in e çdo lende, syllabus i cili vihet në dispozicion të studentëve.</p> <p>Nga evidencat, GVJ vëren që vlerësimi, shprehet në notë dhe gërmë, përcaktuar në rregulloren e programit të studimit e cila ka të përcaktuar qartë mënyrën, modalitetet, rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e dijeve dhe vecanërisht të provimeve e riprovimeve që stafi akademik dhe student duhet të ndjekin.</p>




	<p>Këtu përfshihen gjithashtu, procedurat që duhen ndjekur, rregullat e hartimit të tezave, monitroimi dhe sekretimi i provimeve, e drejta e studentit për të hyrë në provim ose jo, vlerësimi i studentëve. (Evidence Syllabus 5.5).</p> <p>(Rregullorja e KPT (Evidence 4 -Rregullorja e KPT, KREU V, KONTROLLI DHE VLERËSIMI I DIJES)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi dokumentacioneve, gjate vizites së GVJ ne KPT, konstatohet se zbatohen me regorozitet rregullorja, baza ligjore, kriteret dhe procedurat e diplomimit. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentit. GVJ pa disa punime diplome. Mbrojtja bëhet përmes paraqitjes së një punimi diplome ose dhënies së një Provimi të Përgjithshëm Përfundimtar, sipas vendimit të Rektorit për cdo vit akademik.</p> <p>Studentët ishin ne dijeni për rregulloren dhe procedurat e lidhura me provimet dhe diplomimet nëpërmjet tutoriatit, komunikimeve para provimeve me anë të postës elektronike emaileve, secretarisë akademike, titullari i lëndës dhe publikimi në ambientet e KPT.</p> <p>Formati i diplomës së programit është i miratuar përkatësisht nga QSHA. Për diplomat profesionale 2 vjecare nuk parashikohet lëshimi i suplementit të diplomës. Studentët pajisen përkatësisht me numër matrikullimi nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.</p> <p>(Evidence 4 -Rregullorja e KPT, Neni 56 Mbrojtja e diplomës). (Evidence 40 Miratimi i modelit të Diplomës).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, KPT publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit, organizon aktivitete dhe evente të ndryshme në përputhje dhe me udhëzimet e strukturave përgjegjës për arsimin, në bashkëpunim me ZVA dhe DPAP. Gjithashtu, organizohen vizita në ambientet e KPT për të parë dhe për t'u njohur nga afër me institucionin ku ftohen të marrin pjesë maturantë, mësues dhe prindër, si dhe vizita dhe takime online. Nga vizita dhe takime ne KPT, GVJ konstaton se KPT është rregullisht pjesëmarrës në panairt e organizuar nga Dhoma e Tregtisë, "Work and Study", ku ndër vite promovon ofertën e tij akademike. Gjithashtu, KPT është pjesëmarrës në panairt të organizuara nga organizata dhe institucione të ndryshme ku promovohet IAL dhe arrijtjet në fushën e ndërkombëtarizimit etj që luajnë një rol të rëndësishëm në cilësinë e programeve të studimit.</p> <p>Organizohen ture nëpër gjimnaze/shkolla të mesme sipas udhëzimeve përkatëse të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe organizohen eventeve/ konkurse me pjesëmarrjen e gjimnazistëve, shpërndarje broshurash dhe fletëpalosjesh informuese të cilat pajisen dhe QR Code, i cili duke u skanuar të drejton në faqet zyrtare të KPT; KPT, mban dhe përditëson rrjetet sociale në mënyrë të vazhdueshme duke e furnizuar me informacion sa më të saktë dhe të plotë.</p>




	<p>Studentet ne KPT ishin të mirëinformuar , për programin e studimit si dhe për vdo veprimtari tjetër, në Javën e Orientimit të Studentëve, që KPT organizon, si dhe i ka vënë dispozicion Studentit, Manualin e Studentit, një përmbledhje me informacion thelbësor për jetën e studentit në KPT. Në vijim studentët marrin informacion për përdorimin e platformave, llogarive etj në KPT nëpërmjet komunikimeve me zyrën IT dhe materialeve të përgatitura përkatësisht (manuale, video tutoriale etj). Gjatë procesit dhe vitit akademik, KPT, për çështje të ndryshme që mund të kenë, GVJ konstaton se studentit i jepet mundësia të paraqesë kërkesë me shkrim e cila sipas natyrës së kërkesës, i adresohet strukturave përkatëse në KPT.</p> <p>(Evidence 24/2 Open days në KPT).  (Evidence 24/4 Panairët Evropë and Study/Panairi House of Europe).  (Panairët Evropë and Study /Panairi House of Europe).  (Evidence 24.1 Turet).  (Evidence 24/5 NASA Hackathon / konkurse).  (Evidence 30 Java e Orientimit).  (Evidence 27 Manuali i Studentit).  (Evidence 42 Formular kërkesë).</p>								
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se KPT, vë në dispozicion informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit . KPT i ka vënë dispozicion Studentit, Manualin e Studentit, një përmbledhje me informacion thelbësor për jetën e studentit në KPT.</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Faqja zyrtare e KPT përmban informacion të detajuar në lidhje me: strukturën dhe organizimin e KPT, programet mësimore, personelin, shërbimet, oferta akademike, pranimet dhe kriteret e pranimit, silabusët për lëndë, aktet rregullatore të Institucionit, Statutin, mundësi aplikimi për punë dhe kontakte, informacione të cilat përditësohen me kujdes në përputhje me Politikën e Manaxhimit të faqes së Internetit.</p> <p>GVJ u njoh me Strategjinë në KPT për vitin 2022 – 2027e cila, rritet parimet e pranimit të studentëve të rinj, bazuar në kriteret e detyrueshme ligjore, kapacitetet e KPT në infrastrukturë, burime</p>

	<p>njerëzore, analizave të tregut, ecurisë së programeve dhe punësimit të studentëve si dhe prirjet dinamike të zhvillimit të tregut të punës duke synuar për të qenë sa më realiste dhe të orientuar drejt tregut.</p> <p>Çdo vit, kuotat e pranimit dhe kriteret e pranimit shqyrtohen dhe miratohen nga Senati Akademik, dërgohen pranë organeve përkatëse, vendosen në portalin E-Albania si dhe bëhen publike e përditësohen në faqen e internetit të KPT: (<a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/regjistrimi/">https://kolegjiprofesional.edu.al/regjistrimi/</a>). Pranoen për t'u regjistruar pranë KPT të gjithë ata kandidatë të cilët përmbushin kriteret e pranimit si dhe kriteret e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë (MAS). Në programet e studimit pranoen për t'u regjistruar shtetas shqiptarë ose të huaj.</p> <p>(Evidence 35 - Politika e Manaxhimit të faqes së Internetit). (Evidence 7 Strategjia 2021 – 2025). (Evidence 23 – Vendimet SA).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Ne vizitën që GVJ bëri në Institucion, Konstaton se KPT disponon sistemin Classter që shërben si qender e komunikimit ndëraktiv mes njësive të KPT, si dhe studentëve. Studentët kanë një <i>account</i> në sistemin elektronik Classter i cili aksesohet dhe nga faqja e internetit të KPT, me anën e së cilës ata marrin gjithë informacionin e nevojshëm si: syllabuset, orari mësimor, orari i sezoneve të provimit, rezultatet e mbledhjet e punës.</p> <p>Sistemi informacinit Classter përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Kartelën e studentit;</li> <li>b. Portalin e pedagogëve, që përmban informacion mbi projekte, ndihmon pedagogët në hedhjen e notave në sistem, njoftime të nevojshme etj.</li> <li>c. Orarin Mësimor, me informacionin e nevojshëm mbi zhvillimin e lëndëve, kohën e zhvillimit të tyre, sallën, etj;</li> <li>d. Menaxhimin e-books ose librat e bibliotekës;</li> <li>e. Menaxhimin e pagesave të studenteve</li> <li>f. Integrimin me posten elektronike të stafit/studenteve (Microsoft Office365) si dhe me materialet akademike.</li> </ul> <p>Përgjegjëse për funksionimin e sistemit është shoqëria Tech360 shpk, e cila mirëmban dhe përmirëson aplikacionet në Classter.</p> <p>(Evidence 28/1 Sistemi i Informacionit / Classter)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ mori kontakt me Zyrën e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve e cila krahas detyrave të tjera në bashkëpunim me departamentet, punon për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave mësimore, si dhe për të krijuar ura të forta lidhjeje dhe lehtësimin e integritimit në tregun e punës për studentët si dhe për realizimin e këshillimit të duhur për sa i përket karrierës. Detyrat e mësipërme funksionale, si dhe detyra të tjera të përgjegjëses së Zyrës janë të parashikuara edhe në Shtojcën e Kontratës së Punës, të lidhur mes IAL dhe punëmarrësit. Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve mban një database me të dhënat e çdo studenti të</p>




diplomuar në lidhje me punësimin e karrierën e tij.

KPT nëpërmjet Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, edhe pas përfundimit të studimeve për të ndjekur ecurinë e tyre të punësimin, për ata që janë të punësuar dhe për të ofruar mundësi punësimi, këshillim karriere për ata që nuk janë punësuar ende si dhe për t'i asistuar në hyrjen dhe përshtatjen me tregun e punës.

Nga takimi GVJ-s me studentët vërejmë se ndjehen të mbështetur nga Institucioni në zhvillimin e praktikave profesionale, të cilat sigurohen nga vetë KPT. KPT mbështet studentët në punësimin e tyre, si rezultat i kontakteve të vazhdueshme të Institucionit me biznese apo industri të ndryshme, në lidhje me mundësitë e punësimin që disponojnë. Njoftimet për punësim publikohen në:

- faqen e internetit të KPT, në seksionin Jeta Studentore’.
- në rrjetet sociale të KPT.
- shfaqen në ekranin e madh në hollin e katit të parë të KPT.
- me anë të postës elektronike.

KPT organizon takime të hapura me biznese, industri e organizata në grupe dhe individuale të cilët promovojnë mundësitë e karrierës pranë tyre për studentët e KPT, jo vetëm në vend, (*Ujësjellës Kanalizime Tirana etj.*) si dhe jashtë,(*në Gjermani etj.*) Gjithashtu për të përgatitur edhe më mirë studentët për tregun e punës dhe atë të huaj, KPT organizon trajnime me palë të treta (si Bashkia Tiranë, Zyra e Këshillimit të Karrierës etj), në lidhje me dosjen e karrierës, si përgatitjen e CV, letrës së motivimit etj, si dhe një rol të rëndësishëm luajnë dhe mobilitetet pranë kompanive të huaja në vende të ndryshme të BE-së falë projekteve ndërkombëtare ku KPT është pjesë (si praktika 1 dhe 3 mujore në Budapest, Hungari në projektin Connected through Mobility. Nga takimi GVJ me studentet ne Institucion, studentët janë të përgatitur për t'u integruar ne tregun e punës.

Në kuadër të projektit “University to Society Innomediaries in Albania: Co-Production of knowledge and research that matters” / U-SIA që financohet nga Bashkimi Europian përmes Programit Erasmus+ CBHE, janë organizuar evente (fokus grup) me stafin, student të KPT, dhe me disa nga partnerët në sektorët e tjerë me të cilët KPT punon për të evidentuar marrëdhënien IAL – biznes dhe problematikat në lidhje me të, përfshirë punësimin.

Gjithashtu, konstatojmë se KPT organizon vizita në terren të studentëve në shoqërimin dhe mbikqyrjen e pedagogëve të ndryshme në biznese, industri, organizata sipas fushës së veprimtarisë për të parë nga afër, njohur dhe familiarizuar me procese pune, procedura etj si dhe me vetë ambientin dhe kulturën e punës.

(Evidence 12 Sondazhi Alumni).

(Evidencea 33 – Lista e Partnerëve, marrëveshje)

(Evidence 44 Thirrje / Njoftime Punësimi),

(Evidence 31 Takime me biznese).

(Evidence 21 Trajnime student).



	(Evidence 38 Praktika Connected through Mobility). (Evidence 11.3 USIA RoundTable).		
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Nga takimet e GVJ me studentet, ata janë të informuar plotësisht për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, kriteret e procedurat e njohjeve nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Këshillimit me stafin akademik në momentin që interesohen për programet e studimit;</li> <li>-Kontakteve me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit;</li> <li>-Rregullores KPT / rregullores mësimore të programit të studimit (neni 12);</li> <li>-Kontratës që nënshkruhet me KPT në momentin e regjistrimit.</li> <li>-Javën e Orientimit.</li> </ul> <p>Koordinatorja e departamentit mban kontakte të rregullta, njoftime elektronike dhe me telefon me studentët që ndjekin programe studimi të Departamentit, për azhurnimin e tyre mbi infrastrukturën, aktivitete të ndryshme, informacione që lidhen me oraret etj. Çdo ndryshim në orar, ose ndryshim gjatë zbatimit të tij, u njoftohet studentëve përmes njoftimeve të koordinatorëve të departamenteve dhe shpallet në këndin e njoftimeve. Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në KPT, dërgohen përmes postës elektronike dhe sistemit Classter /Teams.</p> <p>(Evidence 30 Java e Orientimit).</p>		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	<p>Duke shërytur listën e partnerëve, GVJ u informua se KPT bashkëpunon me emra të njohur të biznesit e industrisë, me institucione shtetërore dhe ente të pavarura, ku realizohet praktikë aftësuese në terren dhe ofrohen mundësi punësimi. KPT ka aktualisht marrëveshje për zhvillimin e praktikave profesionale me organizata në vend, ku studentët krahas praktikës, të mund të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes /familiarizimit për t'u integruar lehtësisht në tregun e punës</p> <p>(Evidence 33 - Lista e Partnerëve Marrëveshjeve me subjektet pritëse - Marrëveshjet).</p>		
<b>Konkluzione</b>	GVJ konstaton se KPT vë në dispozicion informacion të plotë në lidhje me strukturën, organizimin, syllabuset, përmbajtjen e programit të studimit "DBWD" si dhe për hapat drejt punësimit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim,**

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 89

si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>GVJ vizitoi Zyrën e Protokollit dhe Arkivës, Sekretarinë Mësimore, Zyrën e Burimeve Njerëzore e Kontratave si dhe Zyren e Financës, Zyrën IT ku ka nje koordinim të të dhënave duke bërë të mundur që Institucioni të disponojë statistika vjetore të sakta për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Dokumentacioni ruhet dhe mirëmbahet në version elektronik nga Zyra e IT-së përmes sistemit Classter dhe infrastrukturës tjetër në dispozicion (dosjet elektronike të përbashkëta që krijohen përkatësisht sipas nevojës dhe kërkesës). Ne takim me Koordinatorën e departamentit, GVJ vërev se ajo mbledh, përpunon dhe administron dokumentacionin e punës së përditshme si: Punët e laboratorit të studentëve, silabuset e lëndëve, procesverbalet e mbledhjeve, regjistrat e lëndëve, provimet, procesverbalet e notave etj. Zyra e Protokollit dhe Arkivës në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore, dhe Zyrën e Financës është përgjegjëse për nxjerrjen e statistikave, raporteve vjetore, sipas nevojave të institucionit, kërkesave të autoriteteve përgjegjëse për arsimin etj. Nga vizita ne Sekretarinë mësimorë, GVJ konsaton se Kolegji mban rekorde të detajuara për studentët e regjistruar, studentët me bursë, të çregjistruarit dhe të pezulluarit me numrin përkatës të matrikullimit për çdo program studimi ne Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave nëpërmjet Sistemit Classter dosjes së studentit dhe regjistrat themeltar. Të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin themeltar (regjistri bazë). Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve (vlerësimet e marra nga studenti) gjatë gjithë ciklit të studimit që nga regjistrimi. Të dhënat mbahen dhe përditësohen elektronikisht në sistemin Classter, si dhe në kopje fizike në regjistrat e notave që mbahet në Sekretarinë Mësimore (GVJ kontrolloi regjistrat) si dhe të dhënat për diplomimet të cilat mbahen nga koordinoret. Sipas udhëzimit nr. 11, datë 2.4.2020, “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës”<sup>3</sup>, pika 1, Suplementi nuk lëshohet për Diplomën Profesionale. (Evidence 28/1 Sistemi i Informacionit / Classter). (Evidence 45 Regjistri baze). (Evidence 45/1 - Regjistri i arritjeve akademike). (Evidence 45/2 Regjistri i diplomave).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të</p>	<p>Në KPT të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit Classter. Konsatojme se ky sistem funksionon për të gjitha Aplikacionet në nivel institucioni dhe përfshin gjithë modulet e sistemit të manaxhimimit të informacionit të Studentëve. Sistemi është</p>

<sup>3</sup> Gjetet në: [http://qsha.gov.al/infos/regjistrim\\_diplome/udhezim\\_11\\_02042020.pdf](http://qsha.gov.al/infos/regjistrim_diplome/udhezim_11_02042020.pdf)

<p>sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>mundësuar në bazë të kontratës përkatëse të lidhur me shoqërinë Tech360 shpk<sup>4</sup>, e cila është përgjegjëse për instalimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e aplikacioneve të Classter. Sistemi mundëson komunikimin e informacionit si: mësimin, orari i sezoneve të provimit, rezultatet e mbledhjet e punës. Vizita GVJ në zyrën e IT na informon se në Classter përmbahen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Kartelën e studentit;</li> <li>b. Portalin e pedagogëve, që përmban informacion mbi projekte, ndihmon pedagogët në hedhjen e notave në sistem, njoftime të nevojshme etj.</li> <li>c. Orarin Mësimor, me informacionin e nevojshëm mbi zhvillimin e lëndëve, kohën e zhvillimit të tyre, sallën, etj;</li> <li>d. Menaxhimin e-books ose librat e bibliotekës;</li> <li>e. Menaxhimin e pagesave të studenteve;</li> <li>f. Integrimin me posten elektronike të stafit/studenteve (Microsoft Office365) si dhe me materialet akademike.</li> </ul> <p>Classter mundëson që të gjenerojë raporte të ndryshme të kërkuara nga sekretaria mësimore dhe zyra e financës.</p> <p>Gjithashtu Zyra e Financës përdor sisteme të veçanta që lidhen me kontabilitetin në përputhje me parashikimet ligjore, veçanërisht dhe atë në lidhje me fiskalizimin, falë të cilës mundëson gjenerimin e raporteve sipas nevojave.</p> <p>Faqja zyrtare e KPT përmban informacion të detajuar në lidhje me: strukturën dhe organizimin e KPT, programet mësimore, personelin, shërbimet, oferta akademike, pranimet dhe kriteret e pranimit, silabusët për lëndë, aktet rregullatore të Institucionit, Statutin, mundësi aplikimi për punë dhe kontakte, informacione të cilat përditësohen me kujdes në përputhje me Politikën e Manaxhimit të faqes së Internetit.</p> <p>(Evidence 28/1 - "Sistemi i Institucionit/Classter). (Evidence 35 - Politika e Manaxhimit të faqes së Internetit).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Konsatojmë se një rol të rëndësishëm luan Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë që është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të institucionit Ajo ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Ajo punon në formën e një ekipi të përbërë nga pedagogë që përfaqësojnë Departamentet e KPT-së, një përfaqësues nga njësitë ndihmës, një anëtar - ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues nga studentët. GVJ bëri vizitë në zyrën NJSBC nga ku garantohej cilësia akademike, administrative dhe financiare të institucionit. KPT harton politika dhe ngre strukturat përkatëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe krijon kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së jashtme të vlerësimit dhe garantimin e cilësisë. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet drejtuese) të KPT, të cilat planifikojnë,</li> </ul>

<sup>4</sup> Shoqëria Tech360 është shoqëri e së drejtës shqiptare. Faqja zyrtare e saj është <http://tech360.al/rrethnesh/>

	<p>organizojnë dhe garantojnë zbatimin e Akteve Rregullatore, të politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij.</p> <p>b. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike, administrative dhe financiare të institucionit dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Raportet diskutohet në të gjitha njësitë e institucionit, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.</p> <p>GVJ konfirmon se NjSBC realizon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Vlerësimin, rishikimin dhe përmirësimin programeve dhe syllabuseve mësimore;</li> <li>- Mbarëvajtjen e zhvillimit të procesit akademik;</li> <li>-Realizimin e orarit të zhvillimit të orëve të mësimit, leksione, ushtrime, laboratore dhe praktika mësimore;</li> <li>-Zhvillimin e procesit të vlerësimit të pedagogëve për çdo lëndë nga ana e studentëve;</li> <li>-Mbarëvajtjen e zhvillimit të provimeve përfundimtare dhe cilësia e korigjimit të tyre;</li> <li>-Vlerësimin e procesit të organizimit të praktikave profesionale dhe cilësisë së realizimit të tyre;</li> <li>-Monitorimin e sekretarisë mësimore për proceson e hedhjes së notave;</li> <li>-Monitorimin e vlerësimit të pedagogëve më të rinj nga ana e pedagogëve më me përvojë etj.</li> </ul> <p>KPT përfshin dhe ekspertë të jashtëm në vlerësim të aspekteve të ndryshme të aktivitetit të tij, si për shembull në kurrikula / programe studimi etj. Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, KPT i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit Institucional dhe të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>(Evidence 3 Statuti, Neni 16).  (Evidence 13 Vendim i ngritjes së NjSBC).  (Evidence 13.2 - Raporti NjSBC).  Evidence 6.6 Raporti i cilësisë së studentëve).  (Evidence 3 Statuti, neni 11).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Në kuadër të përditësimit të kurrikulave, është Njësia përgjegjëse për programin e studimit që harton raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve duke marrë në konsideratë listën e profesioneve dhe kërkesat e tregut të punës në përputhje dhe me zhvillimin e teknologjisë. Nga shqyrtimi dokumentacionit nga GVJ në department, janë bërë ndryshime të nevojshme në përditësimin e syllabusve, literaturës, infrastrukturës në dispozicion apo kurrikulës sipas rregullores së brendshme dhe aktet nënligore në</p>

	<p>fuqi. Gjithashtu KPT shqyrton kërkesat dhe nevojat e tregut dhe për hapjen e programeve të studimit të reja si psh Administrim Zyre.</p> <p>KPT ka hartuar një pyetësor për studentet, për të parë se si ata vlerësojnë punën e pedagogut përkatës në mësimdhënie, në të tre komponentet, leksione, ushtrime dhe laboratore. GVJ shëyrtoi në mënyrë të rasrësishme disa pyetsorë i cili konsiston:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- në mënyrën se si pedagogu e zhvillon orën e mësimit.</li> <li>- sa i qartë është ai gjatë shpjegimit.</li> <li>- se si ai e respekton etikën e komunikimit në raport me studentin.</li> <li>- në mënyrën se si është organizuar lënda dhe se si janë ndërthurur temat</li> <li>- si menaxhohet nga pedagogu koha që i është vendosur në dispozicion etj.</li> </ul> <p>Rezultatet e vlerësimeve u bëhen me dije anëtarëve të personelit akademik, që të korrigojnë problemet e konstatuara, ose evidentojnë praktikat e mira si shembull për t'u ndjekur.</p> <p>Përfundimet e nxjerra e vlerësimet ndihmojnë në përmirësimin e mësimdhënies.</p> <p>Tregues i cilësisë së programeve të studimit është edhe shkalla e punësimit të të diplomuarve Disa studentetë janë të punësuar “<i>part time</i>” në orare të cilat nuk pengojne ne vazhdimin dhe realizimin e procesit mesimor per ta. Praktika e KPT ka evidentuar faktin se përmirësimi i programeve të studimit i bazuar në vlerësimin dhe mendimin e avancuar pedagogjik duke përfshirë edhe atë të studentëve, është një risi në punën e institucionit. KPT ndjek punësimin e studentëve si një tregues i performancës së programit të studimit në treg.</p> <p>KPT përgatit raportin e cilësisë në hyrje dhe dalje të studentëve në programin e studimit.</p> <p>(Evidence 7 - Strategjia e Zhvillimit 2021 -2025). (Evidence 6.6 Raporti i cilësisë së studentëve)</p>								
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstatoi se në KPT të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit Classter. Konsatojme se ky sistem funksionon për të gjitha Aplikacionet në nivel institucioni dhe përfshin gjithë modulet e sistemit të manaxhimimit të informacionit të Studentëve.</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="608 1603 823 1693">Përmbushet</th> <th data-bbox="823 1603 1018 1693">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1018 1603 1211 1693">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1211 1603 1410 1693">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="608 1693 823 1744"></td> <td data-bbox="823 1693 1018 1744"></td> <td data-bbox="1018 1693 1211 1744"></td> <td data-bbox="1211 1693 1410 1744" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit,**

**metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ bëri një takim me studentët, nga ku ata ndjehen të përfshirë në vendimmarrjen e organeve drejtuese të këtij institucioni, organizimin e lirë, dhe shprehjen e organizuar të mendimit të tyre. Gjithashtu një student është anëtar Grupit të Vlerësimit të Brendshëm. KPT e vlerëson cilësinë e jetës studentore si një element të rëndësishëm të cilësisë dhe aktivitetit të KPT-së. Në KPT funksionon Këshilli I studentëve, i miratuar edhe në satut. Këshilli i studentëve është organizëm i pavarur i studentëve të KPT, i zgjedhur në mënyrë demokratike nga vetë studentët dhe përfaqëson interesat e tyre. Ai realizon dhe mundëson pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të KPT, në strukturat mësimore dhe të shërbimeve. Këshilli i studentëve shpreh mendime dhe propozime për probleme me interes të përgjithshëm të Kolegjit, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. Bazuar në parashikimet e Statutit, neni 46, Këshilli i studentëve zgjidhet çdo 2 (dy) vjet nga votat e studentëve, një përfaqësues për çdo program studimi dhe vit studimi. Përbërja e Këshillit të Studentëve publikohet në faqen e internetit të KPT (<a href="https://kolegjiprofesional.edu.al/keshilli-i-studenteve/">https://kolegjiprofesional.edu.al/keshilli-i-studenteve/</a>)</p> <p>Studentët informohen, inkurajohen dhe garantojnë për përfshirjen e tyre në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësim mbi procesin akademik. Studentët kanë përfaqësinë e tyre në Njësinë e Sigurimit të cilësisë, Senatit akademik etj. (Evidence 2 Statuti KPT).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në KPT, studentët përfaqësohen në organet drejtuese të KPT, në strukturat mësimore dhe të shërbimeve. Këshilli Studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të KPT, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. Kolegji Profesional i Tiranës mbështet Këshillin Studentor. Gjithashtu në KPT studentët bëjnë vlerësimin anonim të pedagogëve me të cilët kanë zhvilluar mësim.</p> <p>Një mënyrë tjetër janë dhe "Focus Group"- et, me grupe studentësh të programeve përkatëse, për të trajtuar shqetësimet dhe pritshmëritë. Gjithashtu, vetë Departamenti kryen mbledhje të hapura me pedagogë e studentë për të kontrolluar mbarëvajtjen e studimeve dhe për të shprehur të gjithë mendimet apo problematikat nga studentët.</p> <p>Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente, janë pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm. Një student i programit është pjesë e GVB të ngritur në kuadër të hartimit të këtij</p>

	<p>raporti. (Evidence 15 Formularet e vlerësimit Studente, Evidence 16 Fokus Grupe).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Ne si grup GVJ konsatojme se KPT në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programeve përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, si dhe të atyre të diplomuar.</p> <p>KPT organizon veprimtari periodike me studentët si tutoriatet dhe fokus grupet ku krahas çështjeve të ndryshme, trajtohen dhe informimi dhe ndërgjegjësimin për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit.</p> <p>(Evidence 15 Formularet e vlerësimit Studente). (Evidence 16 Fokus Grupe). (Evidence 6.4 Anketa e Stafit). (Evidence Mbledhje e Asamblesë së Personelit), të bashkëpunëtorëve dhe partnerëve). (Evidence 11.3 USIA roundtable). (Evidence 16 Fokus Grupe, Evidence 17 Tutoriatet/Këshillim akademik).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësies/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Grupi GVJ kontrollon teza të rastesishme, dhe vëren se mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces korrekt, transparent dhe në përputhje me vlerësimet në silabusin e lëndës.</p> <p>Edhe nga vizitat në Sekretarinë Mësimore, konsatojme se Sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashtrajnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës.</p> <p>Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (kolokium, detyrë kursi/detyra praktike/punë laborator, ushtrime, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ose Rektori, kur pedagogu lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, ku bën pjesë dhe pedagogu i lëndës, Për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar.</p> <p>(Evidence 42 Formular kërkesë). (Evidence 5 Rregullorja e Programit të Studimit, neni 8, pika 6).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Konstatohet se në KPT funksionon Këshilli i studentëve, si një organizëm i pavarur i studentëve të KPT, i zgjedhur në mënyrë demokratike nga vetë studentët dhe përfaqëson interesat e tyre. Ai realizon dhe mundëson pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të KPT, në strukturat mësimore dhe të shërbimeve.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në KPT ka struktura të vecanta për orientimin dhe këshillimin e studentëve. Strukturat në funksion të këtij procesi janë kryesisht: Zyra e Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve – për informimin për kolegjin; organizimin e jetës studentore etj. dhe Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, Koordinatorët mësimorë dhe varësisht natyrës së çështjes, edhe struktura dhe anëtare të stafit.</p> <p>GVJ organizoi takime në Këto zyra si dhe me studentët. Studentët konfirmojnë se janë të orientuar për programet, syllabuset, planin mësimor, kreditet, etj. Për të qenë sa më pranë studentëve, për Studentët e rinj, KPT organizon çdo vit, Javën e Orientimit të Studentëve si dhe i vë në dispozicion Studentit, Manualin e Studentit, një përmbledhje me informacion thelbësor për jetën e studentit në KPT. Në vijim studentët marrin informacion për përdorimin e platformave, llogarive etj në KPT nëpërmjet komunikimeve me zyrën IT dhe materialeve të përgatitura përkatësisht (manuale, video tutoriale etj) nga sekretaria në lidhje me çështje të ndryshme (kalendari akademik, orar mësimor, seanca sqaruese, konsulta etj).</p> <p>(Evidence 30 Java e Orientimit).  (Evidence 27 Manuali i Studentit).  (Evidence 41 Emaillet njoftuese nga koordinatorët, Evidenca 41/1 Kalendari akademik).  (Evidenca 25 - Mësimi Online - ZYRA IT video tutorial / manual).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Institucioni iu ofron studentëve shërbimin e tutoriatit dhe këshillimit akademik, që synon të njohë studentët me detyrimet akademike të programit, të evidentojë në kohë vështirësitë dhe problemet e mundshme ose të evidentuara si dhe marrjen e masave për zgjidhjen e tyre. GVJ organizoi njëkohësisht takim me pedagogët dhe studentët, ku ka një bashkëpunim frytdhënës mes tyre.</p> <p>Pedagogët ju ofrojnë studenteve seanca konsultuese për çdo lëndë para provimit përfundimtar. Brenda javës nga momenti i daljes së rezultateve të provimit për çdo provim caktohet një orar për seancë sqaruese ku studenti, në rast se ka kontestim në lidhje me rezultatin e provimit, sqarohet nga pedagogu i lëndës në lidhje me vlerësimin. Gjatë procesit dhe vitit akademik, KPT, për çështje të ndryshme që mund të kenë, studentit i jep mundësi të paraqesë kërkesë me shkrim e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 96



	<p>cila sipas natyrës së kërkesës, i adresohet strukturave përkatëse në KPT. Për studentët që hasin vështirësi KPT ofron orë/ seanca shtesë sipas kërkesës së studentëve ose kur KPT e gjykon të arsyeshme.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, Sekretaria Mësimore dhe Koordinatorët të cilët luajnë një rol thelbësor në informimin dhe koordinimin e punës me studentët dhe stafin akademik. Kompetencat e tyre janë të përcaktuara në Statut.</p> <p>(Evidence 3 – Statuti).  (Evidence 4 – Rregullorja KPT).  (Evidence 17/1 Rregullorja Tutoriati).  (Evidence 41 Emaillet njoftuese nga koordinatore).  (Evidence 42 Formular kërkesë).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sic u theksua dhe më lart, Strukturat në funksion të këtij procesi janë kryesisht: Zyra e Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve – për informimin për kolegjin; organizimin e jetës studentore etj. dhe Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, Koordinatorët mësimore dhe varësisht natyrës së çështjes, edhe struktura dhe anëtare të stafit. KPT organizon takime të hapura me biznese, industri e organizata në grupe dhe individuale të cilët promovojnë mundësitë e karrierës pranë tyre për studentët e KPT, jo vetëm në vend dhe jashtë, dhe zhvillimet e fundit në vend (<i>si në Gjermani etj si ReMany, Ujësjetës Kanalizime Tirana etj</i>). Gjithashtu për të përgatitur edhe më mirë studentët për tregun e punës dhe atë të huaj, KPT organizon trajnime me palë të treta (si Bashkia Tiranë, Zyra e Këshillimit të Karrierës etj), në lidhje me dosjen e karrierës, si përgatitjen e CV, letrës së motivimit etj, si dhe një rol të rëndësishëm luajnë dhe mobilitetet pranë kompanive të huaja në vende të ndryshme të BE-së falë projekteve ndërkombëtare ku KPT është pjesë (si praktika 1 dhe 3 mujore në Budapest, Hungari në projektin Connected through Mobility. Klubi më i ri i Inovacionit pranë KPT është KPT HUB, i cili bashkon studentët që të bëjnë zbatimin në praktikë të dijeve, ndërtimin dhe zbatimin e projekteve të ndryshme në grup ose individualisht, me mbështetjen dhe orientimin nga mentorët përkatës në elektronikë, robotikë, programim etj KPT ofron kurse të ndryshme për studentët pa pagese si kurse te gjuhes se huaj.</p> <p>(Evidence 21 Trajnime student),  (Evidence 38 Praktika Connected through Mobility).  (Evidence 20 KPT HUB).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese</p>	<p>GVJ konstaton se Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, krahas detyrave të tjera, punon për të krijuar ura të forta lidhjeje dhe lehtësimin e integritimit në tregun e punës për studentët si dhe për realizimin e këshillimit të duhur për sa i përket karrierës.</p> <p>KPT nëpërmjet Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, edhe pas përfundimit të studimeve për të ndjekur ecurinë e tyre të punësimit, për ata që janë të punësuar dhe për të ofruar mundësi</p>

përkatëse	<p>punësimi, këshillim karriere për ata që nuk janë punësuar ende si dhe për t'i asistuar në hyrjen dhe përshtatjen me tregun e punës.</p> <p>Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve mban një database me të dhënat e çdo studenti të diplomuar në lidhje me punësimin e karrierën e tij dhe mban statistikën përkatëse Detyrat e mësipërme funksionale, si dhe detyra të tjera të përgjegjëses së Zyrës janë të parashikuara edhe në Shtojcën e Kontratës së Punës, të lidhur mes IAL dhe punëmarrësit. GVJ në takim, me studentët vëren se ata shkojnë drejt përballjes me tregun e punës që në stadin e zhvillimit të praktikave profesionale, të cilat sigurohen nga vetë KPT. Nga ana tjetër, KPT është në kontakt të vazhdueshëm me biznese apo industri të ndryshme, në lidhje me mundësitë e punësimit që disponojnë për t'ia ofruar më pas studentëve të diplomuar të KPT.</p> <p>Praktika profesionale shërben jo vetëm për aftësimin praktik dhe profesional në terren dhe në vendin e punës të studentit, po që ai të njihet dhe me kulturën e punës dhe kulturën e korporatës në terren, si dhe të gjejë te subjekti pritës një punëdhënëse të mundshme. Statistikat Alumni përdoren dhe në faqen e internetit të Shoqërisë, seksioni KPT Alumni (<a href="http://kolegji-profesional.edu.al/web/jeta-studentore/alumni/">http://kolegji-profesional.edu.al/web/jeta-studentore/alumni/</a>) si dhe për hartimin e raportit vjetor të veprimtarisë së institucionit.</p> <p>Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve:</p> <p>Mban një database të saktë dhe të detajuar me të dhënat e çdo studenti të diplomuar në lidhje me punësimin e karrierën e tij dhe mban statistikën përkatëse; përpunon statistikën përkatësisht dhe gjeneron raporte në lidhje me to;</p> <p>Mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar për të ndjekur ecurinë e tyre të punësimit, për ata që janë të punësuar dhe për të ofruar mundësi punësimi dhe këshillim karriere për ata që nuk janë punësuar ende;</p> <p>Mban kontakte dhe marrëdhënie të vazhdueshme me institucione të ndryshme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe më pas për krijimin e mundësive të punësimit për studentët e Kolegjit Profesional të Tiranës duke mundësuar lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike, organizata, kompani, ndërmarrje profesionale të tregut të punës.</p> <p>(Evidence 12 Sondazhi Alumni).</p> <p>(Evidenca 12.1 -Njoftime mbi mundësitë e punësimit të Studentëve). ( Evidence 12.2 Punësimi i Studentëve).</p> <p>(Evidenca 33 – Lista e Marrëveshjeve me subjektet pritëse – Marrëveshjet).</p>
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstatoi që në KPT ka struktura të vecanta për orientimin dhe këshillimin e studentëve. Strukturat në funksion të këtij procesi janë kryesisht: Zyra e Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve – për informimin për kolegjin; organizimin e jetës studentore etj. dhe Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, Koordinatorët mësimorë dhe varësisht natyrës së çështjes, edhe struktura dhe anëtarë të stafit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 99




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional ne “Database dhe Web Design” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi ka një vizion të mirë përcaktuar, mision dhe plan të zhvillimit strategjik të qartë, të plotë, bashkëkohor.
2. Programi është ndërtuar në përputhje me nevojat e tregut.
3. Infrastruktura është e mirëpajisur dhe i përgjigjet kërkesave të programit të studimit në përputhje me dinamikat e mësimdhënies.
4. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe strukturat përkatëse, garantojnë cilësinë në veprimtarinë akademike, administrative, financiare të institucionit.
5. Bashkëpunimi me biznesin si një bashkëpunëtor i rëndësishëm në ofrimin e praktikave profesionale dhe në punësimin e studentëve.
6. Veprimtaria akademike dhe administrative kontrollohet me rregulla të qarta, të shprehura në rregulloret e institucionit të bazuara në ligjin e arsimit të lartë dhe aktet rregullatore.
7. Përfshirja në projekte si partner në programe të ndryshme si Erasmus + CBHE, Moduli Jean Monnet dhe projekte pilot të mobilitetit në arsimin profesional të mbështetur nga BE.
8. Shkëmbimi i studentëve, personelit akademik dhe administrativ në kuadër të projekteve ndërkombëtare.
9. Programi i studimit ka mbështetje të plotë infrastrukturore, në teknologji dhe IT.
10. Laboratorët dhe maketet e KPT janë të teknologjisë së lartë dhe mundësojnë zbatimin në praktikë të njohurive teorike.
11. Politikat e burimeve njerëzore synojnë tërheqjen e një stafi sa më profesionist dhe të kualifikuar. Personeli është i kualifikuar, me karrierë të spikatur akademike dhe profesionale.




## **Pika të dobta**

1. Numri i ulët i studentëve.

## **Rekomandime**

1. Rritje e vazhdueshme e fondit të bibliotekës në shqip dhe anglisht.
2. Rritja në vazhdimësi e ndërgjegjësimit dhe informimit për arsimin e lartë profesional përmes rritjes së marketingut dhe promovimit të programit të studimit.
3. Rritja e vizibilitetit të kolegjit që të ndikojë në një shtim të numrit të studentëve




**Evaluation's conclusions for the professional study program "Database and Web Design" provided by the Higher Education Institution "Kolegji Profesional i Tiranës"**

**Strengths and affirmations**

1. The program has a well-defined vision, mission, and complete, contemporary strategic development plan.
2. The program is built in accordance with the needs of the market.
3. The infrastructure is well equipped and responds to the requirements of the study program in accordance with the teaching dynamics.
4. The internal quality assurance unit and the relevant structures guarantee quality in the academic, administrative and financial activity of the institution.
5. Cooperation with business as an important collaborator in providing professional practices and employing students.
6. Academic and administrative activity is controlled by clear rules, expressed in the institution's regulations based on the law of higher education and regulatory acts.
7. Involvement in projects as a partner in various programs such as Erasmus + CBHE, the Jean Monnet Module and pilot projects of mobility in professional education supported by the EU.
8. Exchange of students, academic and administrative personnel within international projects.
9. The study program has full infrastructural support, in technology and IT.
10. KPT's laboratories are of high technology and enable the practical application of theoretical knowledge.
11. Human resources policies aim at attracting the most professional and qualified staff. The personnel is qualified, with distinguished academic and professional career.

**Weaknesses**

1. Low number of students.



### **Recommendation**

1. Continuous increase of the library fund in Albanian and English.
2. Continuous increase in awareness and information about higher professional education through increased marketing and promotion of the study program.
3. Increasing the visibility of the college to influence an increase in the number of students



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Plotësisht	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X